

SHTOJCË II bashkëngjitur në

REFERIM

**i Rregullave të Rishikuara të Rregullores së Procedurës dhe të Provave, Dhomës së
Specializuar të Gjykatës Kushtetuese**

KONFIDENCIALE

DRAFT - LIMITE

RREGULLORJA E PROCEDURËS DHE E PROVAVE
E DHOMAVE TË SPECIALIZUARA TË KOSOVËS

KAPITULLI 1 DISPOZITA TË PËRGJITHSHME.....	1
Rregulla 1 Fushëveprimi dhe hyrja në fuqi	1
Rregulla 2 Përkufizimi i termave	1
Rregulla 3 Teksti autentik.....	5
Rregulla 4 Interpretimi i Rregullores	5
Rregulla 5 Procedura në rast të zbrazëtive ligjore në Rregullore	6
Rregulla 6 Mosrespektimi i Rregullores.....	6
Rregulla 7 Ndryshimi i Rregullores	6
Rregulla 8 Gjuhët e punës	7
Rregulla 9 Llogaritja dhe ndryshimi i afateve	7
KAPITULLI 2 ORGANIZIMI DHE ADMINISTRIMI I DHOMAVE TË SPECIALIZUARA	9
<i>Pjesa I: Funksionimi i brendshëm i Dhomave të Specializuara.....</i>	<i>9</i>
Rregulla 10 Seanca plenare.....	9
Rregulla 11 Kuorumi dhe votimi	9
Rregulla 12 Këshillimet e Kryetarit me Administratorin dhe Prokurorin e Specializuar.....	10
<i>Pjesa II: Dhomat.....</i>	<i>10</i>
<i>Nënpjesa 1: Kryetari.....</i>	<i>10</i>
Rregulla 13 Funksionet e Kryetarit.....	10
Rregulla 14 Zëvendësimi i Kryetarit.....	11
<i>Nënpjesa 2: Gjykatësit.....</i>	<i>11</i>
Rregulla 15 Kryetari i një paneli gjykatësish	11
Rregulla 16 Përparësia e gjykatësve	11
Rregulla 17 Gjykatësi raportues.....	11
Rregulla 18 Gjykatësi rezervë	12
Rregulla 19 Mungesa e një gjykatësi	12
Rregulla 20 Vetëtërheqja ose përjashtimi i gjykatësve	12
Rregulla 21 Dorëheqja ose vdekja e një gjykatësi	14
Rregulla 22 Përjashtimi nga Regjistri dhe masat disiplinore.....	14
<i>Pjesa III: Zyra Administrative.....</i>	<i>14</i>
<i>Nënpjesa 1: Dispozita të Përgjithshme.....</i>	<i>14</i>
Rregulla 23 Shërbimet Mbështetëse Gjyqësore të Administratorit.....	14
Rregulla 24 Dokumentimi i procedurave dhe ruajtja e provave.....	15
<i>Nënpjesa 2: Mbrojtësi.....</i>	<i>16</i>
Rregulla 25 Listat e Mbrojtësve.....	16
Rregulla 26 Emërimi dhe caktimi i Mbrojtësve.....	16
<i>Nënpjesa 3: Mbrojtja dhe mbështetja e dëshmitarëve</i>	<i>17</i>
Rregulla 27 Përgjegjësitë e Administratorit në lidhje me mbrojtjen dhe mbështetjen e dëshmitarëve	17
<i>Nënpjesa 4: Zyra e Avokatit të Popullit.....</i>	<i>18</i>
Rregulla 28 Dispozita të Përgjithshme	18
Rregulla 29 Roli dhe funksionet e Avokatit të Popullit të Dhomave të Specializuara	18
KAPITULLI 3 TË DREJTAT E PERSONAVE GJATË HETIMIT.....	20
<i>Pjesa I: Masat hetimore.....</i>	<i>20</i>
<i>Nënpjesa 1: Të përgjithshme.....</i>	<i>20</i>
Rregulla 30 Dispozitë e përgjithshme	20
Rregulla 31 Garanci minimale të përgjithshme	20
Rregulla 32 Mbajtja, ruajtja dhe mbrojtja e materialit të mbledhur apo të sekuestruar sipas rregullës 34 deri në rregullën 41.....	21
Rregulla 33 Kthimi ose asgjësimi i materialit të mbledhur apo të sekuestruar sipas rregullës 34 deri në rregullën 41	21
<i>Nënpjesa 2: Masa hetimore të posaçme.....</i>	<i>22</i>

Rregulla 34	Kushtet për marrjen e masave hetimore të posaçme	22
Rregulla 35	Masa hetimore të posaçme të autorizuar prej një paneli.....	23
Rregulla 36	Masa hetimore të posaçme të urdhëruara prej Prokurorit të Specializuar	23
<i>Nënpjesa 3: Kontrollimi dhe sekuestrimi.....</i>		
Rregulla 37	Kontrollimi dhe sekuestrimi i autorizuar prej një paneli.....	24
Rregulla 38	Kontrollimi dhe sekuestrimi prej Prokurorit të Specializuar.....	25
Rregulla 39	Kryerja e kontrollimit dhe sekuestrimit	25
<i>Nënpjesa 4: Masa të tjera</i>		
Rregulla 40	Zhvarrosja dhe ekzaminimi <i>post-mortem</i>	26
Rregulla 41	Mbledhja e materialeve trupore për ekspertizë mjeko-ligjore.....	27
<i>Pjesa II: Të drejtat e personave gjatë hetimit</i>		
Rregulla 42	Dispozitë e përgjithshme.....	28
Rregulla 43	Të drejtat e të dyshuarve gjatë hetimit.....	28
Rregulla 44	Regjistrimi i marrjes në pyetje të të dyshuarve	29
Rregulla 45	Pranimet.....	29
Rregulla 46	Ruajtja e informacionit	30
Rregulla 47	Pushimi i hetimit	30
KAPITULLI 4 FLETËTHIRRJA, ARRESTIMI DHE PARABURGIMI.....		
<i>Pjesa I: Dispozita të përgjithshme.....</i>		
Rregulla 48	Parime themelore.....	31
Rregulla 49	Fletëthirrjet dhe urdhrat e tjerë.....	31
Rregulla 50	Transferimi në Dhomat e Specializuara.....	31
Rregulla 51	Zhdëmtimi për arrestim ose paraburgim të paligjshëm.....	32
<i>Pjesa II: Arrestimi.....</i>		
Rregulla 52	Urdhërarresti prej Prokurorit të Specializuar.....	32
Rregulla 53	Fletarrestimi i lëshuar prej Dhomave të Specializuara.....	33
Rregulla 54	Fletarrestimet ndërkombëtare të lëshuara prej Dhomave të Specializuara	33
Rregulla 55	Zbatimi i fletarrestimeve	33
<i>Pjesa III: Paraburgimi.....</i>		
Rregulla 56	Mbajtja në paraburgim	34
Rregulla 57	Rishikimi dhe rivlerësimi i mbajtjes në paraburgim.....	35
Rregulla 58	Apelimi i ndërmjetëm i mbajtjes në paraburgim.....	35
Rregulla 59	Mbrojtja e parimit të ligjshmërisë kundrejt vendimeve të formës së prerë mbi mbajtjen në paraburgim.....	36
Rregulla 60	Vdekja e një personi të paraburgosur.....	36
KAPITULLI 5 DISPOZITA LIDHUR ME FAZAT E NDRYSHME TË PROCEDURËS		
<i>Pjesa I: Dispozita të përgjithshme.....</i>		
Rregulla 61	Mbikëqyrja e procedurës në sallën e gjyqit.....	37
Rregulla 62	Detyrat e Prokurorit të Specializuar.....	37
Rregulla 63	Shpërdorimi i procedurave	37
Rregulla 64	Ndihma joefektive e Mbrojtësit.....	38
Rregulla 65	Mospërmbushja e urdhrit të një trupi gjykues	38
Rregulla 66	Mjetet shtrënguese	39
Rregulla 67	<i>Amicus Curiae</i>	39
Rregulla 68	Mungesa e të akuzuarit	39
Rregulla 69	Ekzaminimi mjekësor i të dyshuarit ose i të akuzuarit.....	40
Rregulla 70	Vdekja e të akuzuarit.....	40
Rregulla 71	Masat e përkohshme për ruajtjen e kapitalit	41
Rregulla 72	Procedura e përsheptuar	41
<i>Pjesa II: Vendi i zhvillimit të procedurës.....</i>		
Rregulla 73	Veprimtaria gjyqësore jashtë selisë së Dhomave të Specializuara	42
Rregulla 74	Vizitat në terren dhe paraqitja e dëshmitarëve në gjyq jashtë selisë së Dhomave të Specializuara.....	42
<i>Pjesa III: Parashtrimet dhe vendimet.....</i>		
Rregulla 75	Mocionet dhe parashtrimet e tjera.....	43
Rregulla 76	Afatet për dorëzimin e parashtrimeve	43
Rregulla 77	Apelimet e ndërmjetme me leje të trupit gjykues.....	43
Rregulla 78	Kuvendimet për marrjen e vendimit	44
Rregulla 79	Kompetenca për rishqyrtimin e vendimeve.....	44

<i>Pjesa IV: Mbrojtja e dëshmitarëve dhe viktimave</i>	45
Rregulla 80 Masat mbrojtëse.....	45
Rregulla 81 Ndryshimi i masave mbrojtëse.....	46
<i>Pjesa V: Klasifikimi</i>	48
Rregulla 82 Klasifikimi i parashtrimeve të dorëzuara.....	48
Rregulla 83 Klasifikimi i dokumentacionit të procesit gjyqësor dhe të provave.....	48
Rregulla 84 Riklasifikimi i dokumentacionit të procesit gjyqësor dhe të provave.....	49
KAPITULLI 6 AKTAKUZA DHE PROCEDURA PARAPRAKE	50
<i>Pjesa I: Aktakuza</i>	50
Rregulla 85 Funksionet e gjykatësit të procedurës paraprake para konfirmimit të aktakuzës.....	50
Rregulla 86 Paraqitja, shqyrtimi dhe konfirmimi i aktakuzës.....	50
Rregulla 87 Dorëzimi i aktakuzës.....	51
Rregulla 88 Statusi publik i aktakuzës.....	52
Rregulla 89 Bashkimi ose veçimi i akuzave.....	52
Rregulla 90 Ndryshimi i aktakuzës.....	53
Rregulla 91 Tërheqja e aktakuzës ose e akuzave.....	53
<i>Pjesa II: Paraqitja e parë dhe deklarimi i fajësisë ose pafajësisë</i>	54
Rregulla 92 Paraqitja e parë e të akuzuarit.....	54
Rregulla 93 Pranimi i fajësisë.....	55
Rregulla 94 Marrëveshja për pranimin e fajësisë.....	55
<i>Pjesa III: Procedura paraprake</i>	57
Rregulla 95 Funksionet e gjykatësit të procedurës paraprake pas konfirmimit të aktakuzës.....	57
Rregulla 96 Konferencat mbi ecurinë e çështjes.....	59
Rregulla 97 Mocionet paraprake.....	59
Rregulla 98 Kalimi i dosjes së çështjes trupit gjykues.....	60
<i>Pjesa IV: Mundësi hetimore e vetme</i>	61
Rregulla 99 Dispozita të përgjithshme.....	61
Rregulla 100 Marrja e deponimeve pas vendimit të gjykatësit të procedurës paraprake.....	61
Rregulla 101 Provat e mbledhura nga autoritetet gjyqësore të një shteti të tretë.....	62
KAPITULLI 7 NXJERRJA E MATERIALIT	63
Rregulla 102 Nxjerrja e materialit nga Prokurori i Specializuar.....	63
Rregulla 103 Nxjerrja e provave shfajësuese.....	63
Rregulla 104 Nxjerrja e materialit nga Mbrojtja.....	64
Rregulla 105 Moszbulimi i përkohshëm i identitetit.....	65
Rregulla 106 Mosnxjerrja e raporteve, memorandumeve dhe dokumenteve të tjera të brendshme.....	65
Rregulla 107 Informacion i mbrojtur që nuk është objekt i nxjerrjes së materialit.....	65
Rregulla 108 Informacion tjetër që nuk është objekt i nxjerrjes së materialit.....	66
Rregulla 109 Procedura e nxjerrjes së materialeve.....	67
Rregulla 110 Mospërbushja e detyrimit të nxjerrjes së materialit.....	67
Rregulla 111 Komunikimet dhe informacionet e privileguara.....	67
Rregulla 112 Mbetja në fuqi e detyrimit të nxjerrjes së materialit.....	69
KAPITULLI 8 PJESËMARRJA E VIKTIMAVE NË PROCEDURË	70
Rregulla 113 Pranimi si viktimë pjesëmarrëse në procedurë.....	70
Rregulla 114 Modalitetet e pjesëmarrjes në procedurën gjyqësore.....	71
KAPITULLI 9 PROCEDURA E GJYKIMIT	72
<i>Pjesa I: Përgatitja dhe administrimi i procedurës së gjyqimit</i>	72
Rregulla 115 Caktimi i trupit gjykues.....	72
Rregulla 116 Administrimi i procedurës dhe konferencat për ecurinë e çështjes.....	72
Rregulla 117 Konferenca përgatitore për gjykimin.....	73
Rregulla 118 Konferencë përgatitore për Prokurorin e Specializuar.....	73
Rregulla 119 Paraqitja e provave prej Mbrojtjes dhe konferenca përgatitore për Mbrojtjen.....	74
Rregulla 120 Seancat e hapura, private dhe me dyer të mbyllura.....	75
Rregulla 121 Dëshmitarët e thirrur ose që marrin fletëthirrje për paraqitje në gjyq.....	76
Rregulla 122 Mosbindja e dëshmitarit ndaj fletëthirrjes për paraqitje.....	76
Rregulla 123 Shtyrja e procedurës.....	76
<i>Pjesa II: Procedimi i çështjes gjyqësore</i>	77
Rregulla 124 Hapja e çështjes gjyqësore.....	77

Rregulla 125	Informacioni fillestar për të akuzuarin.....	77
Rregulla 126	Deklaratat hyrëse	77
Rregulla 127	Paraqitja e provave	78
Rregulla 128	Transferimi i dëshmitarëve të paraburgosur për të dëshmuar në Dhomat e Specializuara	79
Rregulla 129	Mbyllja e paraqitjes së provave prej Prokurorit të Specializuar.....	79
Rregulla 130	Rrëzimi i akuzave	79
Rregulla 131	Mbyllja e paraqitjes së provave prej Mbrojtjes.....	80
Rregulla 132	Prova të kërkuara nga trupi gjykues	80
Rregulla 133	Mocione për plotësimin e seancave të paraqitjes së provave	80
Rregulla 134	Mbyllja e procedurës së paraqitjes së provave.....	80
Rregulla 135	Deklaratat përmbyllëse	80
Rregulla 136	Mbyllja e çështjes.....	81
Pjesa III: Provat.....		81
<i>Nënpjesa 1: Pranueshmëria dhe vlerësimi i provave</i>		<i>81</i>
Rregulla 137	Dispozita të përgjithshme.....	81
Rregulla 138	Pranueshmëria e provave	81
Rregulla 139	Vlerësimi i provave në kuadër të vendimit të gjykimi.....	82
Rregulla 140	Standardi i vërtetimit	82
<i>Nënpjesa 2: Dëshmitë gojore, deklaratat dhe prova të tjera.....</i>		<i>83</i>
Rregulla 141	Dispozita të përgjithshme në lidhje me dëshmitë gojore të dëshmitarëve.....	83
Rregulla 142	Deklaratat, marrja në pyetje dhe dhënia e dëshmisë prej të akuzuarit.....	84
Rregulla 143	Marrja në pyetje e dëshmitarëve.....	84
Rregulla 144	Marrja në pyetje me videokonferencë.....	85
Rregulla 145	Marrja në pyetje e dëshmitarëve jashtë vendit ku mbahet gjykimi.....	85
Rregulla 146	Marrja në pyetje e dëshmitarëve me aftësi të kufizuara të posaçme	86
Rregulla 147	Marrja në pyetje e dëshmitarëve anonimë	86
Rregulla 148	Provat në çështjet e dhunës seksuale të pretenduar	86
Rregulla 149	Dëshmitë e dëshmitarëve ekspertë.....	87
Rregulla 150	Dhënia e dëshmisë nga të bashkakuqarit.....	88
Rregulla 151	Vetëfajësimi prej një dëshmitari	88
Rregulla 152	Fajësimi nga anëtarët e familjes	89
Rregulla 153	Pranimi i deklaratave dhe transkripteve me shkrim në vend të dëshmive gojore	89
Rregulla 154	Pranimi i deklaratave dhe transkripteve me shkrim në vend të pyetjeve të drejtpërdrejta ..	90
Rregulla 155	Pranimi i deklaratave me shkrim të personave të padisponueshëm dhe personave ndaj të cilëve ka ndërhyrje.....	91
Rregulla 156	Fakte të pranura nga palët.....	92
Rregulla 157	Konstatimi gjyqësor	92
Pjesa IV: Vendimi i gjykimit		92
Rregulla 158	Kuvendimet në lidhje me vendimin e gjykimit	92
Rregulla 159	Shqiptimi i vendimit të gjykimit.....	93
Rregulla 160	Statusi i personit të shpallur fajtor.....	93
Rregulla 161	Statusi i personit të shpallur të pafajshëm.....	93
Pjesa V: Përcaktimi i dënimit.....		94
Rregulla 162	Procedura e përcaktimit të dënimit.....	94
Rregulla 163	Përcaktimi i dënimit	94
Rregulla 164	Shqiptimi i vendimit të dënimit prej trupit gjykues	95
Rregulla 165	Gjobat.....	95
Rregulla 166	Vendi i burgimit	96
Pjesa VI: Zhdëmtimi.....		96
Rregulla 167	Referim në padi civile.....	96
Rregulla 168	Urdhër për zhdëmtim kundër personit të shpallur fajtor.....	97
KAPITULLI 10 PROCEDURA E APELIT		97
Pjesa I: Procedura e apelit të shkallës së dytë.....		97
<i>Nënpjesa 1: Apelet e ndërmjetme.....</i>		<i>97</i>
Rregulla 169	Caktimi i panelit të Gjykatës së Apelit për apelet e ndërmjetme	97
Rregulla 170	Dorëzimi i apeleve të ndërmjetme.....	97
Rregulla 171	Efekti pezullues i apelit të ndërmjetëm.....	98
<i>Nënpjesa 2: Apelet kundër aktgjyqimeve.....</i>		<i>98</i>
Rregulla 172	Caktimi i panelit të Gjykatës së Apelit për apelet kundër aktgjyqimeve.....	98

Rregulla 173	Dispozita të përgjithshme.....	98
Rregulla 174	Statusi i personave në pritje të apelit	98
Rregulla 175	Dokumentacioni i apelit.....	98
Rregulla 176	Njoftimi për apel.....	99
Rregulla 177	Gjykatësi raportues në procedurën e apelit	99
Rregulla 178	Konferenca para apelit	99
Rregulla 179	Dosjet apeluere.....	99
Rregulla 180	Data e seancës së apelit.....	100
Rregulla 181	Provat shtesë.....	100
Rregulla 182	Kuvendimet për vendimin mbi apelet	101
Rregulla 183	Shqiptimi i aktgjykimit të apelit.....	101
Rregulla 184	Procedura e përcaktimit të dënimit.....	102
Rregulla 185	Statusi i personave të shpallur të pafajshëm, ose fajtorë pas aktgjykimit të apelit.....	102
<i>Pjesa II: Procedura e apelit të shkallës së tretë.....</i>		102
Rregulla 186	Dispozitë e përgjithshme	102
KAPITULLI 11 MJETET JURIDIKE TË JASHTËZAKONSHME		104
<i>Pjesa I: Rihapja e procedurës penale.....</i>		104
Rregulla 187	Kërkesa për rihapjen e procedurës.....	104
Rregulla 188	Shqyrtimi paraprak i kërkesës për rihapjen e procedurës	104
Rregulla 189	Vendim mbi kërkesën për rihapjen e procedurës.....	104
Rregulla 190	Apelimi i aktgjykimit pas rihapjes së procedurës.....	104
<i>Pjesa II: Zbutja e jashtëzakonshme e dënimit.....</i>		105
Rregulla 191	Kërkesa për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit.....	105
Rregulla 192	Aktgjykim në lidhje me kërkesën për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit	105
<i>Pjesa III: Mbrojtja e ligjshmërisë.....</i>		105
Rregulla 193	Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë.....	105
Rregulla 194	Vendimi mbi kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë	106
KAPITULLI 12 ULJA E DËNIMIT.....		107
Rregulla 195	Njoftimi nga shtetet.....	107
Rregulla 196	Kriteret e përgjithshme për uljen e dënimit.....	107
Rregulla 197	Procedura e uljes së dënimit.....	108
KAPITULLI 13 PARËSIA, BASHKËPUNIMI DHE NDIHMA GJYQËSORE.....		109
<i>Pjesa I: Dispozita të përgjithshme të bashkëpunimit.....</i>		109
Rregulla 198	Dërgimi dhe marrja e komunikimeve lidhur me bashkëpunimin dhe ndihmën gjyqësore	109
Rregulla 199	Kërkesa për dëshminë e një personi në paraburgim të Dhomave të Specializuara.....	109
<i>Pjesa II: Bashkëpunimi dhe ndihma gjyqësore me Kosovën.....</i>		110
Rregulla 200	Dispozita të përgjithshme	110
Rregulla 201	Kërkesa për urdhër për informacion, bashkëpunim dhe ndihmë	110
Rregulla 202	Urdhri për informacion, bashkëpunim dhe ndihmë	111
Rregulla 203	Urdhri për transferimin e çështjeve gjyqësore nga gjykata të tjera të Kosovës	111
Rregulla 204	Mospërbushja e urdhrorit për informacion, bashkëpunim dhe ndihmë, ose për transferim të një çështjeje gjyqësore	111
Rregulla 205	<i>Non Bis In Idem</i>	112
Rregulla 206	Kërkesat nga autoritetet e Kosovës për ndihmë dhe bashkëpunim.....	112
Rregulla 207	Efektet jodetyrues të vendimeve të gjykatave të tjera	112
<i>Pjesa III: Bashkëpunimi ndërkombëtar</i>		112
Rregulla 208	Marrëveshje me shtete të treta, organizata ndërkombëtare dhe subjekte të tjera	112
Rregulla 209	Mosrespektimi i marrëveshjeve	113
Rregulla 210	Kërkesa për ndihmë e shteteve të treta, organizatave ndërkombëtare dhe subjekteve të tjera..	113
Rregulla 211	Kërkesa për mbrojtjen e përfaqësuesve dhe informacionit	114

DRAFT**RREGULLORJA E PROCEDURËS DHE E PROVAVE E
DHOMAVE TË SPECIALIZUARA TË KOSOVËS****Kapitulli 1****Dispozita të përgjithshme****Rregulla 1****Fushëveprimi dhe hyrja në fuqi**

- (1) Rregullorja e Procedurës dhe e Provave për kryerjen e procedurave para Dhomave të Specializuara, përveç Kapitullit 14 të Rregullores, u miratua në përputhje me nenin 162(6) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 19(1) të Ligjit, më 17 mars 2017, me shumicë absolute të gjykatësve të Dhomave të Specializuara të mbledhur në seancë plenare, me përjashtim të gjykatësve të Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese.
- (2) Më **datë, muaj, vit**, në përputhje me nenin 49(6) të Ligjit, gjykatësit e Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese miratuan Kapitullin 14 të Rregullores i cili rregullon organizimin e brendshëm, procesin e vendimmarrjes dhe çështje të tjera në lidhje me organizimin e Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese.
- (3) Rregullorja hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas marrjes së vendimit nga Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese, bazuar në nenin 19(5) të Ligjit, se Rregullorja është në pajtim me Kapitullin II të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Rregulla 2**Përkufizimi i termave**

- (1) Në këtë Rregullore, përveç nëse konteksti e kërkon ndryshe, termat e mëposhtme kanë këto kuptime:

Administratori

Administratori i emëruar në bazë të nenit 34(4) të Ligjit, apo cildo punonjës i Zyrës Administrative i autorizuar të përfaqësojë Administratorin në ushtrimin e detyrave të Administratorit;

Autoriteti Emërues

Shefi i Misionit të Bashkimit Evropian për Politikë të Përbashkët të Sigurisë dhe Mbrojtjes;

Dhomat e Specializuara

Dhomat e Specializuara të Kosovës të formuara në bazë të nenit 162(1) të Kushtetutës dhe Ligjit;

Fletarrestim	Urdhër i lëshuar prej Dhomave të Specializuara kundër një të dyshuari, të akuzuari ose dëshmitari, në përputhje me nenin 41(6), ose nenin 42(8) të Ligjit;
Gjykata Kushtetuese e Kosovës	Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës;
Gjykatës	Gjykatësit ndërkombëtarë të pavarur të Dhomave të Specializuara, të emëruar në përputhje me nenin 28 të Ligjit;
Hetim	Të gjitha veprimtaritë e ndërmarra prej Zyrës së Prokurorit të Specializuar bazuar në Ligjin dhe Rregulloren, ose prej TFHS-së bazuar në Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale të Kosovës, për mbledhjen e informacionit dhe të provave;
I akuzuar	Personi fizik kundër të cilit janë konfirmuar një apo më shumë akuza në përputhje me nenin 39(2) të Ligjit dhe rregullën 86;
I dyshuar	Personi për të cilin Prokurori i Specializuar ka arsye të dyshojë se ka kryer apo ka marrë pjesë në kryerjen e një vepre penale brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara;
KMDNJ	Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, miratuar më 4 nëntor 1950;
KNDCP	Konventa Ndërkombëtare për Të Drejtat Civile dhe Politike, miratuar më 16 dhjetor 1966;
KNKK	Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq;
Kodi i Etikës Gjyqësore	Kodi i Etikës Gjyqësore për gjykatësit e emëruar në Regjistrin e Gjykatësve Ndërkombëtarë të Dhomave të Specializuara të Kosovës;
Kodi i Etikës Profesionale	Kodi i Etikës Profesionale për mbrojtës me të drejtë të ushtrimit të profesionit para Dhomave të Specializuara, miratuar në bazë të rregullës 23(3);

Kodi i Procedurës Penale i Kosovës	Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, nr. 04/L-123, miratuar më 13 dhjetor 2012;
Kodi Penal i Kosovës	Kodi Penal i Republikës së Kosovës, nr. 04/L-082, miratuar më 20 prill 2012;
Kryetari	Kryetari i Dhomave të Specializuara, i emëruar ose i zgjedhur në përputhje me nenin 32 të Ligjit;
Kryetari i panelit/trupit gjykues	Gjykatësi i zgjedhur në përputhje me rregullën 15, apo i emëruar në përputhje me nenin 32(1) të Ligjit;
Kushtetuta	Kushtetuta e Republikës së Kosovës;
Ligji	Ligji për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, Ligji nr. 05/L-053, miratuar më 3 gusht 2015;
Marrëveshja me Shtetin Pranues	Marrëveshje midis Mbretërisë së Holandës dhe Republikës së Kosovës në lidhje me vendosjen e selisë së Institucionit Gjyqësor të Specializuar të Zhvendosur të Kosovës në Holandë, nënshkruar më 15 shkurt 2016 dhe hyrë në fuqi më 1 janar 2017;
Masa Hetimore të Posaçme	Masat e përcaktuara në nenin 87(1)(1.1 deri në 1.7), (1.11 dhe 1.12), (2), (3), (4), (5), (6), (7), (11) dhe (12) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës;
Mbrojtës	Një ndër personat në Listën e Mbrojtësve të Specializuar, ose në Listën e Mbrojtësve të Viktimave;
Mbrojtës i Specializuar	Një ndër personat në Listën e Mbrojtësve të Specializuar, i caktuar apo i emëruar, siç përcaktohet prej rrethanave, sipas rregullës 26(1);
Mbrojtës i Viktimave	Një ndër personat në Listën e Mbrojtësve të Viktimave, i caktuar, siç përcaktohet prej rrethanave, sipas rregullës 26(2).
Mbrojtja	I dyshuari/i akuzuari/dhe/ose Mbrojtësi i Specializuar;

Organi Përfaqësues i Pavarur i Mbrojtësve të Specializuar	Organi Përfaqësues i Pavarur i Mbrojtësve të Specializuar, i ngritur në përputhje me nenin 19(4) të Ligjit, për të përfaqësuar interesat e Mbrojtësve të Specializuar dhe të Mbrojtësve të Viktimave para Dhomave të Specializuara;
Palë	Prokurori i Specializuar ose Mbrojtja;
Panel	Cilido panel ose trup gjykues, ose një gjykatës i vetëm, të caktuar në një çështje në përputhje me nenin 25(1) dhe nenin 33 të Ligjit, përveç nëse është përcaktuar ndryshe;
Plenare	Kuvend i gjykatësve të Regjistrit të Gjykatësve Ndërkombëtarë, të thirrur në mbledhje në selinë e Dhomave të Specializuara, apo të cilët këshillohen me njëri-tjetrin pa qenë të pranishëm në selinë e Dhomave të Specializuara, sipas vendimit të Kryetarit bazuar në rregullën 10(5) të Rregullores;
Prokurori i Specializuar	Prokurori i emëruar në bazë të nenit 35(6) ose (7) të Ligjit, apo cilido punonjës i Zyrës së Prokurorit të Specializuar, i autorizuar të përfaqësojë Prokurorin e Specializuar në ushtrimin e detyrave të Prokurorit të Specializuar;
Regjistri	Regjistri i Gjykatësve Ndërkombëtarë të Pavarur, përcaktuar në nenin 26 të Ligjit;
Rregullat e Brendshme, Udhëzimet Praktike, Direktivat	Cilido akt normativ i brendshëm i miratuar prej Dhomave të Specializuara në përputhje me nenin 19(6) të Ligjit;
Rregullorja	Rregullorja e Procedurës dhe e Provave në fuqi;
Rregullorja e Caktimit	Rregullorja e Caktimit në një çështje të gjykatësve të Dhomave të Specializuara nga Regjistri i Gjykatësve Ndërkombëtarë, në përputhje me nenin 25(3) të Ligjit;
Shtet i Tretë	Shtet ose subjekt shtetëror i ndryshëm nga Republika e Kosovës;
Shteti Pranues	Mbretëria e Holandës;

TFHS	Task Forca Hetimore Speciale;
Urdhërarrest	Urdhër i lëshuar prej Prokurorit të Specializuar kundër një të dyshuari ose të akuzuari gjatë fazës hetimore, në përputhje me nenet 35(2)(h) dhe 41(6) të Ligjit;
Viktimë	Personi fizik që ka pësuar dëm fizik, material apo mendor si pasojë e drejtpërdrejtë e një vepre penale të pretenduar në një aktakuzë të konfirmuar nga gjykatësi i procedurës paraprake;
Viktimë Pjesëmarrëse në Procedura	Viktima të cilës i është miratuar statusi i viktimës pjesëmarrëse në procedura bazuar në Rregulloren;
Zyra e Mbrojtjes	Zyrë në kuadër të Zyrës Administrative, e paraparë sipas nenit 34(7) të Ligjit;

- (2) Në këtë Rregullore njëjësi përfshin shumësin dhe anasjelltas¹.

Rregulla 3

Teksti autentik

Versioni në anglisht i Rregullores ka përparësi.

Rregulla 4

Interpretimi i Rregullores

- (1) Rregullorja interpretohet në pajtueshmëri me kornizën e përcaktuar në nenin 3 të Ligjit, dhe nëse është e përshtatshme, me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës.
- (2) Në rast mospërputhjeje midis Ligjit dhe Rregullores, përparësi ka Ligji.
- (3) Çdo paqartësi që nuk mund të zgjidhet në përputhje me paragrafin (1), zgjidhet duke u bazuar në interpretimin më të favorshëm për të dyshuarin ose të akuzuarin në rrethanat konkrete.

¹ Në tekstin shqip gjinia mashkullore përfshin dhe nënkupton edhe gjininë femërore.

Rregulla 5

Procedura në rast të zbrazëtive ligjore në Rregullore

Në qoftë se gjatë procedurave gjyqësore ngrihet një çështje që nuk trajtohet në Rregullore, vendimin në lidhje me të, paneli e merr në pajtim me nenin 19(2) dhe (3) të Ligjit dhe me parimet e përcaktuara në rregullën 4.

Rregulla 6

Mosrespektimi i Rregullores

¹Çdo mosrespektim i Rregullores që shkakton padrejtësi ligjore thelbësore, raportohet menjëherë, dhe jo më vonë se dhjetë (10) ditë pasi të jetë bërë i ditur. ²Gjithashtu, trupi gjykues mund ta shqyrtojë një mosrespektim të tillë *proprio motu*, si edhe të marrë masat e duhura për garantimin e ndershmërisë së procedurave gjyqësore dhe kryerjes së tyre në mënyrë të paanshme dhe të drejtë.

Rregulla 7

Ndryshimi i Rregullores

- (1) ¹Komisioni për Rregulloren, i përbërë prej Kryetarit dhe dy gjykatësve të tjerë të caktuar nga Kryetari, formohet pas hyrjes në fuqi të Rregullores, për të shqyrtuar propozimet për ndryshimin e Rregullores. ²Komisionin për Rregulloren e mbledh dhe e kryeson Kryetari.
- (2) Gjykatësit e Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese nuk propozojnë ndryshime të Rregullores, as nuk marrin pjesë në ndryshimin e Rregullores, përveç se në lidhje me Kapitullin 14 të Rregullores.
- (3) Cilido gjykatës nga Regjistri, duke mbajtur parasysh paragrafin (2), Prokurori i Specializuar, Organi Përfaqësues i Pavarur i Mbrojtësve të Specializuar dhe Administratori mund t'i paraqesin Komisionit për Rregulloren propozime për ndryshimin e Rregullores.
- (4) ¹Pas këshillimeve me Prokurorin e Specializuar, me Organin Përfaqësues të Pavarur të Mbrojtësve të Specializuar dhe me Administratorin, Komisioni për Rregulloren u raporton gjykatësve ndryshimet e propozuara të Rregullores, të paktën tridhjetë (30) ditë para datës së mbajtjes së seancës plenare. ²Gjykatësve u jepet një përmbledhje e këshillimeve dhe e pikëpamjeve të palëve të këshilluara. ³Administratori paraqet pikëpamjet e veta vetëm në lidhje me ndryshimet të cilat ka të ngjarë të shkaktojnë pasoja financiare për Dhomat e Specializuara.
- (5) Propozimet për ndryshime miratohen në seancë plenare, me shumicë absolute të gjykatësve pjesëmarrës, në përputhje me rregullën 11.
- (6) ¹Pas miratimit të një ndryshimi, rregullën e ndryshuar Kryetari ia referon Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese e cila, në përputhje me nenin 19(5) të Ligjit dhe brenda tridhjetë (30) ditësh, merr vendimin nëse ndryshimi i miratuar është në përputhshmëri me Kapitullin II të Kushtetutës. ²Kryetari mund t'i paraqesë Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese edhe arsyet për ndryshimet e miratuara.
- (7) ¹Ndryshimet e miratuara hyjnë në fuqi shtatë (7) ditë pas vendimit të Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese, marrë në përputhje me nenin 19(5) të Ligjit, se ndryshimet e miratuara

janë në përputhshmëri me Kapitullin II të Kushtetutës. ²Me hyrjen në fuqi, ndryshimet e miratuara dhe arsyetimi bëhen publike prej Kryetarit.

- (8) Një ndryshim i Rregullores që ende nuk ka hyrë në fuqi, nuk ndikon në vlefshmërinë e cilitdo veprimi procedural të Dhomave të Specializuara, palëve, Mbrojtësit të Viktimave, ose Administratorit. Gjithsesi, ndryshimet e Rregullores nuk kanë fuqi prapavepruese dhe nuk ndikojnë në dëm të drejtave të një personi të dyshuar, të akuzuar, të shpallur fajtor ose të pafajshëm, në çfarëdo çështje në shqyrtim e sipër prej një paneli.

Rregulla 8

Gjuhët e punës

- (1) Gjuhë zyrtare janë gjuhët e përcaktuara në nenin 20 të Ligjit.
- (2) Para Dhomave të Specializuara, i dyshuari ose i akuzuari ka të drejtë të përdorë një gjuhë që kupton dhe flet.
- (3) Duke mbajtur parasysh nenin 20 të Ligjit:
 - (a) në fazën më të hershme të mundshme të procedurave, dhe pasi t'i ketë dëgjuar palët dhe, kur është e zbatueshme, Mbrojtësin e Viktimave, trupi gjykues merr vendimin se cila ose cilat gjuhë të punës do të përdoren gjatë procedurave; dhe
 - (b) personat e tjerë që paraqiten para Dhomave të Specializuara, të cilët nuk kanë njohuri të mjaftueshme të këtyre gjuhëve të punës, mund të përdorin një gjuhë që kuptojnë, vetëm me autorizim të trupit gjykues.
- (4) Administratori bën organizimin e duhur të përkthimit me gojë dhe me shkrim në gjuhët e punës dhe gjuhën që përdor i akuzuari ose i dyshuari, dhe prej këtyre gjuhëve, në përputhje me Rregulloren apo urdhrin e trupit gjykues.
- (5) Afatet llogariten vetëm nga momenti kur njëra nga palët, ose një pjesëmarrës tjetër në procedura që duhet të ndërmerret veprim, ka marrë nga Administratori përkthimin e dokumentit në një të punës, në qoftë se dokumenti është dorëzuar në një gjuhë të ndryshme prej ndonjëres nga gjuhët e punës.

Rregulla 9

Llogaritja dhe ndryshimi i afateve

- (1) Afatet e përcaktuara prej kësaj Rregulloreje llogariten në ditë kalendarike.
- (2) ¹Afatet llogariten prej ditës së parë të punës pas njoftimit për dorëzimin e parashtrimit përkatës në gjuhën ose gjuhët e punës që ka përcaktuar trupi gjykues. ²Në qoftë se afati për kryerjen e një veprimi i përcaktuar prej kësaj Rregulloreje, apo prej trupit gjykues, llogaritet nga koha kur ka ndodhur një ngjarje, ky afat llogaritet prej ditës së parë të punës nga data e ngjarjes.
- (3) ¹Afatet llogariten prej ditës së parë të punës pas daljes së një urdhri gojor, vendimi apo aktgjykimi. ²Në qoftë se trupi gjykues bën të ditur se urdhri gojor, vendimi apo aktgjykimi do të

pasohet prej një arsytimi me shkrim, afatet llogariten prej ditës së parë të punës pas njoftimit për arsyetimin me shkrim.

- (4) Në qoftë se dita e fundit e një afati të përcaktuar prej kësaj Rregulloreje apo prej trupit gjykues bie në fundjavë ose në një pushim zyrtar të Dhomave të Specializuara, si ditë e fundit e këtij afati konsiderohet dita vijuese e punës.
- (5) Nëse i tregohen arsye të vlefshme, ose *proprio motu*, trupi gjykues mund:
 - (a) të zgjasë ose shkurtojë afatet e përcaktuara prej kësaj Rregulloreje apo prej trupit gjykues; ose
 - (b) të gjykojë të vlefshëm çfarëdo veprimi të ndërmarrë pas përfundimit të afatit përkatës.
- (6) Përveç nëse trupi gjykues ka urdhëruar ndryshe, dhe kur nuk i shkaktohet padrejtësi palës kundërshtare ose kur është e zbatueshme, Mbrojtësit të Viktimave, vendimi në lidhje me një mocion për ndryshimin e afateve mund të merret edhe pa i dhënë palës kundërshtare ose, kur është e zbatueshme, Mbrojtësit të Viktimave, mundësinë e paraqitjes së parashtrimeve.

Kapitulli 2

Organizimi dhe administrimi i Dhomave të Specializuara

Pjesa I: Funksionimi i brendshëm i Dhomave të Specializuara

Rregulla 10

Seanca plenare

- (1) Gjykatësit mblidhen në seancë plenare për sa vijon:
 - (a) miratimin dhe ndryshimin e Rregullores, në varësi të nenit 19(1) dhe (5) të Ligjit dhe rregullës 7(2);
 - (b) miratimin dhe ndryshimin e Rregullores për Caktimin e Gjykatësve;
 - (c) miratimin dhe ndryshimin e Kodit të Etikës Gjyqësore;
 - (d) zgjedhjen e Kryetarit dhe nënkryetarit bazuar në nenin 32(2) dhe (4) të Ligjit; dhe
 - (e) kryerjen e detyrave të tjera të parapara në Ligj, në Rregullore ose në Kodin e Etikës Gjyqësore.
- (2) Seancat plenare thirren dhe kryesohen prej Kryetarit.
- (3) ¹Datat e mbajtjes së seancave plenare i cakton Kryetari, pas këshillimit me të gjithë gjykatësit. ²Seancat plenare mbahen të paktën një herë në vit kalendarik. ³Seancat e tjera plenare mund të thirren me kërkesë të së paku shtatë gjykatësve, ose kurdoherë që diktohet prej ushtrimit të detyrave të Kryetarit të parapara në Ligj.
- (4) ¹Seancat plenare nuk janë publike dhe në to mund të marrin pjesë vetëm personat e ftuar prej Kryetarit, ose prej gjykatësve të mblodhur në seancë plenare. ²Për procedurat dhe vendimet e marra përpilohet procesverbal me shkrim në anglisht, nëse është e nevojshme.
- (5) ¹Seancat plenare mund të mbahen jashtë selisë së Dhomave të Specializuara, nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik. ²Kryetari mund të autorizojë pjesëmarrje nëpërmjet videokonferencës.

Rregulla 11

Kuorumi dhe votimi

- (1) ¹Kuorumin për seancë plenare e përbën shumica absolute e gjykatësve. ²Në rastet kur gjykatësit e Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese nuk lejohen të jenë të pranishëm në bazë të rregullës 7(2), kuorumin e përbën shumica absolute e gjykatësve të tjerë pjesëmarrës.
- (2) ¹Vendimet në seancë plenare merren me shumicë absolute të gjykatësve pjesëmarrës. ²Votën vendimtare e ka Kryetari.
- (3) ¹Gjykatësit mund t'ia delegojnë votën një gjykatësi tjetër përmes një autorizimi paraprak me shkrim dorëzuar Kryetarit para fillimit të seancës plenare. ²Një gjykatës nuk mund të votojë më

shumë se në emër të një gjykatësi tjetër. ³Ky paragraf nuk është i zbatueshëm kur në seancë plenare votohet në lidhje me rastet e përcaktuara në Kapitullin 4 të Kodit të Etikës Gjyqësore.

Rregulla 12

Këshillimet e Kryetarit me Administratorin dhe Prokurorin e Specializuar

¹Pa ndërhyrë në pavarësinë e njëri-tjetrit në kryerjen e detyrave të tyre, në rast se gjykohet e nevojshme, Kryetari dhe Administratori këshillohen me shoshoqin dhe bashkërendojnë punën në lidhje me administrimin e veprimtarisë gjyqësore të Dhomave të Specializuara. ²Nëse është e nevojshme, për të njëjtën çështje Kryetari mund të këshillohet edhe me Prokurorin e Specializuar.

Pjesa II: Dhomat

Nënpjesa 1: Kryetari

Rregulla 13

Funksionet e Kryetarit

- (1) Në ushtrimin e detyrave në përputhje me nenin 32(3) të Ligjit, Kryetari kryen funksionet vijuese:
 - (a) bashkërendon punën e Dhomave;
 - (b) është përgjegjës për veprimtarinë gjyqësore efektive të Dhomave të Specializuara dhe administrimin e duhur të drejtësisë;
 - (c) cakton gjykatësit në panele, në përputhje me Ligjin dhe Rregulloren për Caktimin e Gjykatësve;
 - (d) cakton periudhën e pushimit vjetor të gjykatës, pas këshillimeve me Administratorin;
 - (e) përfaqëson Dhomat e Specializuara para Kosovës, shteteve të treta, organizatave ndërkombëtare dhe subjekteve të tjera, kur kjo diktohet prej veprimtarisë së Dhomave të Specializuara;
 - (f) këshillohet dhe bashkërendon punën me Administratorin për çështje lidhur me funksionet gjyqësore mbështetëse të Administratorit; dhe
 - (g) ushtron të gjitha funksionet e tjera që i janë besuar në bazë të Ligjit, Rregullores, Kodit të Etikës Gjyqësore dhe cilitdo akti nënligjor të miratuar në përputhje me nenin 19(6) të Ligjit.
- (2) Në këshillim me Administratorin, Prokurorin e Specializuar dhe, sipas rastit, me gjykatësit, Kryetari mund të nxjerrë udhëzime praktike, në përputhje me Ligjin dhe Rregulloren, që rregullojnë në hollësi kryerjen e procedurave para Dhomave të Specializuara.

Rregulla 14**Zëvendësimi i Kryetarit**

Në qoftë se as Kryetari, as nënkryetari, nuk kanë mundësi t'i kryejnë funksionet e tyre, duke mbajtur parasysh nenin 32(4) të Ligjit, këto funksione i merr gjykatësi që ka përparësi në bazë të datës së emërimit ose të moshës, në përputhje me rregullën 16(2).

Nënpjesa 2: Gjykatësit**Rregulla 15****Kryetari i një paneli gjykatësish**

- (1) ¹Kryetari shërben si kryetar i çdo paneli të Gjykatës Supreme ku është anëtar. ²Kryetari i çdo paneli tjetër zgjidhet me shumicë të gjykatësve të panelit përkatës.
- (2) ¹Kryetari i një trupi gjykues shërben si i tillë gjatë gjithë gjykimit. ²Gjykatësit në përbërje të një trupi gjykues mund të marrin vendim për zëvendësimin e kryetarit të trupit gjykues. ³Kryetari i një paneli të Gjykatës së Apelit zgjidhet veç për çdo apel.
- (3) Kryetari i panelit bashkërendon punën e panelit, komunikon me Administratorin për çështje në lidhje me administrimin dhe shërbimet për kryerjen e procedurave gjyqësore përkatëse, në pajtim me nenin 34(1) të Ligjit dhe ushtron të gjitha funksionet e tjera që i besohen prej Ligjit dhe Rregullores.
- (4) ¹Në përputhje me Rregulloren, ose me vendim të panelit, dhe pasi t'i ketë informuar gjykatësit e tjerë në përbërje të atij paneli për hapat që synon të ndër marrë, kryetari i panelit mund të nxjerrë vendime për çështje në lidhje me administrimin e procedurave gjyqësore. ²Paneli mund të marrë në rishqyrtim vendime të tilla.

Rregulla 16**Përparësia e gjykatësve**

- (1) Përveç se kur përcaktohet ndryshe në Rregullore, të gjithë gjykatësit janë të barabartë në ushtrimin e funksioneve të tyre si gjykatës.
- (2) ¹Pas Kryetarit, nënkryetarit dhe kryetarëve të zgjedhur të paneleve, përparësia e gjykatësve përcaktohet në bazë të datës së emërimit. ²Përparësia e gjykatësve të emëruar më të njëjtën datë, përcaktohet në bazë të moshës së tyre.

Rregulla 17**Gjykatësi raportues**

¹Në këshillim me gjykatësit e tjerë të panelit, kryetari i atij paneli mund të caktojë një gjykatës raportues. ²Gjykatësit raportues mund t'i caktohet për detyrë përpilimi i një projektvendimi të panelit, ose përgjegjësi për ndonjë çështje tjetër për të cilën vendos paneli.

Rregulla 18**Gjykatësi rezervë**

- (1) ¹Pas hapjes së një çështjeje gjyqësore bazuar në rregullën 124, një gjykatës rezervë është i pranishëm në çdo fazë të gjykimit. ²Gjykatësi rezervë mund të parashtrijë pyetje gjatë seancave gjyqësore dhe është i pranishëm në kuvendimet e gjykatësve. ³Gjykatësi rezervë mund të kryejë edhe funksione të tjera në trupin gjykues, të cilat kryetari i trupit gjykues, në këshillim me gjykatësit e tjerë në përbërje të atij trupi gjykues, i gjykon të nevojshme.
- (2) Gjykatësi rezervë nuk mund të caktohet si gjykatës raportues, e as të votojë apo të japë mendimin e vet në lidhje me cilindo vendim, përveç nëse dhe pasi caktohet në bazë të rregullës 19(5), ose rregullës 20 (4).

Rregulla 19**Mungesa e një gjykatësi**

- (1) Gjykatësit janë të pranishëm në çdo fazë të gjykimit të çështjes në të cilën janë caktuar dhe gjatë të gjitha kuvendimeve.
- (2) ¹Një gjykatës mund të mungojë me autorizimin e Kryetarit. ²Nëse lejojnë rrethanat, Kryetari njoftohet paraprakisht për mungesën e një gjykatësi të caktuar në një çështje dhe për këtë informon Administratorin.
- (3) Kur një gjykatës përgjithnjë nuk mund të vijojë të marrë pjesë në një çështje gjyqësore, Kryetari cakton gjykatësin rezervë, ose, sipas rrethanave, një gjykatës tjetër për të vijuar me gjykimin e çështjes.
- (4) ¹Në qoftë se një gjykatës mungon në seancat e një çështjeje në gjykim e sipër, trupi gjykues apo gjykatësit e tjerë në përbërje të atij trupi gjykues, varësisht prej rrethanave, shtyjnë procedimin e çështjes për një periudhë me jo më shumë se tridhjetë (30) ditë pune të njëpasnjëshme. ²Në rast se gjykatësi nuk ka mundësi të marrë pjesë në çështjen gjyqësore edhe pas përfundimit të periudhës së shtyrjes së procedimit të çështjes gjyqësore, zbatohet paragrafi (3). ³Në përputhje me nenin 33(4) të Ligjit, gjykatësi i zëvendësuar nuk mund të caktohet në një panel tjetër të së njëjtës çështje gjyqësore, në një fazë të ndryshme të procedurës.
- (5) Në qoftë se për çfarëdo arsye, një gjykatës i vetëm nuk ka mundësi të vijojë të marrë pjesë në një çështje në gjykim e sipër për një periudhë që ka të ngjarë të zgjasë më shumë, në çështjen në fjalë Kryetari mund të caktojë një gjykatës të vetëm tjetër, dhe pasi t'i ketë dëgjuar palët, të urdhërojë rigjykimin ose vijimin e procesit gjyqësor nga ajo pikë.

Rregulla 20**Vetëtërheqja ose përjashtimi i gjykatësve**

- (1) ¹Një gjykatës nuk mund të marrë pjesë në një çështje gjyqësore në të cilën gjykatësi ka interes personal ose me të cilën ka apo ka pasur lidhje që mund të ndikojë ose perceptohet se ndikon në paanshmërinë e gjykatësit, në pavarësinë gjyqësore ose në ndershmërinë e procedurës gjyqësore. ²Si arsye për vetëtërheqje ose përjashtim mund të shërbejnë:

- (a) interesi personal i gjykatësit në çështjen gjyqësore, ndër të tjerë interesi bashkëshortor, prindëror ose një lidhje tjetër familjare e ngushtë, një lidhje personale, profesionale apo vartësie me cilëndo nga palët ose Mbrojtësin e Viktimave, si edhe situata që logjikisht mund të perceptohen se shkaktojnë konflikt interesash;
- (b) përfshirja e gjykatësit, jo si gjykatës i Dhomave të Specializuara, në çfarëdo procedure ligjore në të cilën i dyshuari ose i akuzuari ka qenë ose ende është palë;
- (c) pikëpamja e mundshme e gjykatësit për çështjen në fjalë e krijuar gjatë kryerjes së funksioneve para caktimit të gjykatësit në atë çështje, e cila mund të ndikojë për keq në paanshmërinë e gjykatësit përkatës; dhe
- (d) çfarëdo arsye tjetër që logjikisht mund të perceptohet se ndikon në paanshmërinë e gjykatësit.
- (2) ¹Në qoftë se sipas një gjykatësi ekzistojnë arsye për vetëtërheqje, gjykatësi në fjalë menjëherë i paraqet Kryetarit kërkesë rreptësisht konfidenciale për vetëtërheqje, dhe, kur është e zbatueshme, informon kryetarin e panelit ku është caktuar. ²Kryetari merr vendimin në pajtim me rregullën 5 të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve. ³Arsyetimi për një vendim të tillë bëhet publik vetëm pas këshillimit me gjykatësin përkatës.
- (3) ¹Një palë mund t'i paraqesë Kryetarit kërkesë për përjashtimin e menjëhershëm të një gjykatësi, por jo më vonë se dhjetë (10) ditë pasi pala në fjalë të ketë marrë dënimin për arsyet mbi të cilat mbështet kërkesën për përjashtimin e atij gjykatësi. ²Gjykatësi në lidhje me të cilin është paraqitur kërkesë për përjashtim, mund të vetërhiqet, pasi të jetë informuar për kërkesën e lartpërmendur. ³Në qoftë se gjykon se një kërkesë e tillë është qëllimkeqe, e gabuar, e pavlerë apo e pabazë, Kryetari e hedh poshtë me procedurë të shkurtuar, sa më shpejt që të jetë e mundshme. ⁴Në çdo rrethanë tjetër, Kryetari cakton një panel prej tre gjykatësish për marrjen e vendimit në lidhje me përjashtimin. ⁵Gjykatësi përjashtimi i të cilit kërkohet, ka mundësinë e përgjigjes ndaj kërkesës për përjashtim. ⁶Përgjigja e gjykatësit u jepet palëve dhe në lidhje me të palët mund të paraqesin parashtrime, me lejen e panelit. ⁷Gjykatësi përjashtimi i të cilit kërkohet, ka të drejtë t'u përgjigjet parashtrimeve të palëve. ⁸Paneli merr vendim të arsyetuar sa më shpejt që të jetë e mundshme. ⁹Ky vendim është publik dhe në rrethana të posaçme redaktohet.
- (4) ¹Paneli vendos për secilin rast veçazi nëse rrethanat lejojnë që gjykatësi në fjalë të vijojë pjesëmarrjen në një çështje gjyqësore gjatë kohës që rasti i tij është në shqyrtim e sipër. ²Para se të marrë vendimin, paneli dëgjon parashtrimet e palëve në lidhje me rastin. ³Pas vetëtërheqjes së një gjykatësi, ose vendimit për përjashtimin e një gjykatësi, në vend të atij gjykatësi Kryetari cakton një tjetër.
- (5) Vendimi bazuar në paragrafët (2) dhe (3) nuk është i rishikueshëm.
- (6) Në qoftë se kërkesa për përjashtim është në lidhje me Kryetarin, kompetencat e Kryetarit të përcaktuara në këtë rregull i merr nënkryetari.

Rregulla 21**Dorëheqja ose vdekja e një gjykatësi**

- (1) ¹Gjykatësi që vendos të japë dorëheqje, njofton me shkrim Kryetarin në lidhje me këtë vendim. ²Gjykatësi bën të gjitha përpjekjet që dorëheqjen ta dorëzojë brenda nëntëdhjetë (90) ditësh para hyrjes së saj në fuqi. ³Gjykatësi përmbush të gjitha përgjegjësitë e papërfunduara, në qoftë se është e mundur, para hyrjes në fuqi të dorëheqjes.
- (2) Pas dorëheqjes ose vdekjes së një gjykatësi, ose njoftimit për rrethana shëndetësore që nuk i mundësojnë gjykatësit të paraqesë vetë dorëheqjen, Kryetari njofton Autoritetin Emërues në rast se numri i Gjykatësve në Regjistrë është nën nivelin që mundëson funksionimin e duhur të Dhomave të Specializuara.

Rregulla 22**Përfundimi nga Regjistri dhe masat disiplinore**

Përfundimi nga Regjistri në përputhje me nenin 31(4) të Ligjit, masat disiplinore, si edhe procedura përkatëse, rregullohen prej Kodit të Etikës Gjyqësore.

Pjesa III: Zyra Administrative***Nënpjesa 1: Dispozita të Përgjithshme*****Rregulla 23****Shërbimet Mbështetëse Gjyqësore të Administratorit**

- (1) ¹Bazuar në nenin 34(1) të Ligjit, Administratori është përgjegjës për administrimin dhe shërbimet për Dhomat e Specializuara, si edhe për kryerjen e të gjitha funksioneve të tjera të nevojshme dhe të bashkëngjitura. ²Në këtë drejtim, Administratori mund të nxjerrë çfarëdo rregulloreje dhe udhëzimi të brendshëm të nevojshëm, dhe nëse lipset mund të këshillohet me Kryetarin për këtë qëllim.
- (2) Në kryerjen e funksioneve të përcaktuara në Ligj, në Rregullore ose në udhëzimet praktike përkatëse, Administratori mund:
 - (a) t'i parashtrijë argumente Kryetarit ose cilitdo paneli për probleme që dalin në kuadër të një çështjeje gjyqësore konkrete, të cilat ndikojnë në kryerjen e funksioneve të Administratorit;
 - (b) t'i paraqesë rekomandime dhe argumente Plenares, në lidhje me funksionet e Zyrës Administrative të cilat ndikojnë në veprimtarinë gjyqësore të Dhomave të Specializuara; dhe
 - (c) të raportojë para gjykatësve të mbledhur në seancë plenare për veprimtarinë e vet e cila ndikon në funksionet gjyqësore të Dhomave të Specializuara.

- (3) ¹Me miratimin e Kryetarit, Administratori miraton Direktivën për Mbrojtësit dhe Kodin e Etikës Profesionale, si edhe çdo ndryshim dhe plotësim të tyre. ²Varësisht prej rrethanave, Kryetari mund të këshillohet me të gjithë gjykatësit në Regjistër, me Organin e Pavarur Përfaqësues të Mbrojtësve të Specializuar, ose me çdo subjekt tjetër përkatës të jashtëm.
- (4) ¹Në varësi të Rregullores dhe në përputhje me urdhrat e një paneli, Administratori merr dhe shpërndan parashtrime. ²Për këtë qëllim, Administratori miraton Udhëzim Praktik.
- (5) ¹Zyra e Pjesëmarrjes së Viktimave, e cila është pjesë e Zyrës Administrative, administron sistemin e pjesëmarrjes së viktimave përcaktuar në nenin 22 të Ligjit dhe në Rregullore, listën e Mbrojtësve të Viktimave, si edhe sistemin e pagesës për përfaqësimin e viktimave. ²Zyra e Pjesëmarrjes së Viktimave mbështet dhe këshillon viktimat pjesëmarrëse në procedurat në Dhomat e Specializuara.
- (6) Zyra e Mbrojtjes, e cila është pjesë e Zyrës Administrative, administron listën e Mbrojtësve të Specializuar që kanë të drejtën e ushtrimit të profesionit para Dhomave të Specializuara, si edhe një sistem të ndihmës për përfaqësimin juridik para Dhomave të Specializuara të të dyshuarve ose të akuzuarve, të cilët nuk zotërojnë, ose zotërojnë pjesërisht, mjete financiare të mjaftueshme.
- (7) ¹Në pajtim me nenin 34(12) dhe nenin 41 të Ligjit, dhe pa cenuar mbikëqyrjen gjyqësore aty ku është e nevojshme, Administratori është përgjegjës për drejtimin dhe administrimin e paraburgimit dhe objekteve të paraburgimit në emër të Dhomave të Specializuara, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe Ligjin. ²Në pajtim me nenin 41(8) dhe (9) të Ligjit, Administratori miraton Rregulloren e Paraburgimit, Ankesave dhe Procedurës Disiplinore për Objektin e Paraburgimit dhe siguron që objekti i paraburgimit të përmbushë standardet ndërkombëtare, si edhe mundëson inspektimin dhe monitorimin e tij prej cilitdo autoriteti të njohur monitorues ndërkombëtar.
- (8) Administratori merr të gjitha masat brenda kompetencave të veta, për të garantuar zbatimin e vendimeve të Dhomave të Specializuara.
- (9) Administratori shërben si kanal komunikimi i Dhomave të Specializuara me publikun.

Rregulla 24

Dokumentimi i procedurave dhe ruajtja e provave

- (1) Administratori bën dokumentimin e plotë dhe të saktë të procedurave gjyqësore.
- (2) Administratori ruan të gjitha provat dhe materialet e tjera të paraqitura gjatë procedurave gjyqësore, në përputhje me cilindo urdhër gjyqësor.
- (3) ¹Administratori administron një arkiv të dhënash gjyqësore ku ruhen dosjet e të gjitha çështjeve që procedohen prej Dhomave të Specializuara. ²Dokumentacioni publik i arkivit të të dhënave gjyqësore është i disponueshëm për publikun.
- (4) Administratori regjistron ose mban procesverbal të seancës plenare, sipas rrethanave.

Nënpjesa 2: Mbrojtësi

Rregulla 25

Listat e Mbrojtësve

- (1) Përmbushja e kritereve, përgatitja profesionale dhe përvoja, si edhe modalitetet e vetëtërheqjes dhe përjashtimit të Mbrojtësve rregullohen në Direktivën për Mbrojtësit.
- (2) Një mbrojtës përfshihet në Listën e Mbrojtësve të Specializuar ose në Listën e Mbrojtësve të Viktimave prej Administratorit, në qoftë se i plotëson kriteret e përcaktuara në Direktivën për Mbrojtësit.
- (3) Mbrojtësit e përfshirë në Listat e Mbrojtësve u nënshtrohen procedurave disiplinore të përcaktuara në Kodin e Etikës Profesionale për Mbrojtësit.

Rregulla 26

Emërimi dhe caktimi i Mbrojtësve

- (1) ¹Administratori emëron ose cakton Mbrojtës nga Lista e Mbrojtësve të Specializuar për një të dyshuar apo të akuzuar, në përputhje me Direktivën për Mbrojtësit. ²Në përputhje me procedurën e paraparë në këtë Direktivë, i dyshuari apo i akuzuari mund t'i paraqesë panelit përgjegjës kërkesë për rishikimin e vendimit të Administratorit për emërimin ose caktimin e Mbrojtësit të Specializuar.
- (2) Në përputhje me Direktivën për Mbrojtësit dhe pas këshillimeve me viktimat pjesëmarrëse në procedurat gjyqësore, duke mbajtur parasysh pikëpamjet dhe interesat e tyre, nga Lista e Mbrojtësve të Viktimave Administratori cakton një Mbrojtës të përbashkët të viktimave pjesëmarrëse në procedura, në pajtim me nenin 22(5) të Ligjit dhe rregullën 113(7).
- (3) Në përputhje me nenet 21(4)(e), 21(5), 38(3)(c) dhe nenin 41(4)(b) të Ligjit, në rast se një i dyshuar ose i akuzuar nuk zgjedh një mbrojtës, apo zgjedh mbrojtës që nuk i plotëson kriteret e përfshirjes në Listën e Mbrojtësve të Specializuar, Administratori ose paneli, në qoftë se është angazhuar me çështjen, i cakton të dyshuarit ose të akuzuarit një Mbrojtës të Specializuar.

Nënpjesa 3: Mbrojtja dhe mbështetja e dëshmitarëve**Rregulla 27****Përgjegjësitë e Administratorit në lidhje me mbrojtjen dhe mbështetjen e dëshmitarëve**

- (1) Zyra për Mbrojtjen dhe Mbështetjen e Dëshmitarëve si pjesë e Zyrës Administrative është përgjegjëse për mbrojtjen e dëshmitarëve, viktimave pjesëmarrëse në procedurat gjyqësore, dhe, sipas rrethanave, e personave të tjerë të rrezikuar për shkak të dëshmisë së një dëshmitari.
- (2) Zyra për Mbrojtjen dhe Mbështetjen e Dëshmitarëve, konkretisht kryen funksionet vijuese:
 - (a) harton strategji dhe siguron masat e duhura për sigurinë dhe mbrojtjen e dëshmitarëve, viktimave pjesëmarrëse në procedurat gjyqësore dhe të personave të tjerë të rrezikuar për shkak të dëshmisë së një dëshmitari, nëse është e nevojshme, në këshillim me palën që thërret dëshmitarin, ndër të tjera përmes marrjes së masave të përcaktuara në nenin 23(1) të Ligjit;
 - (b) mundëson ndihmën e nevojshme administrative dhe logjistike për dëshmitarët që paraqiten para Dhomave të Specializuara, si edhe i informon dëshmitarët për sa vijon:
 - (i) çfarëdo çështje që ka të bëjë me sigurinë dhe mbrojtjen e tyre;
 - (ii) mënyrën e zhvillimit të procedurave në sallën e gjyqit;
 - (iii) sallën e gjyqit dhe pjesëmarrësit e procesit gjyqësor; dhe
 - (iv) rolin, të drejtat dhe detyrimet e dëshmitarëve gjatë procedurave gjyqësore;
 - (c) u mundëson dëshmitarëve dhe viktimave pjesëmarrëse në procedura gjyqësore mbështetjen e duhur mjekësore, psikologjike dhe çfarëdo mbështetje tjetër të nevojshme për mundësimin e dhënies së dëshmisë para Dhomave të Specializuara;
 - (d) siguron që dëshmitarët e thirrur ose të urdhëruar për paraqitje, të mbahen veçazi në një vend ose dhomë të caktuar ku ata presin derisa të thirren për të dhënë dëshmi; dhe
 - (e) mundëson çdo lloj ndihme të mëtejshme në përputhje me vendimet e Administratorit ose të një paneli, që është në përputhje me mandatin dhe kompetencat e Zyrës për Mbrojtjen dhe Mbështetjen e Dëshmitarëve.
- (3) Me urdhrin e një paneli ose *proprio motu*, para daljes në gjyq të një personi, Zyra për Mbrojtjen dhe Mbështetjen e Dëshmitarëve mund të kryejë vlerësim psikologjik të personit, për të përcaktuar nëse është në gjendje të dalë në gjyq, dhe nëse janë të nevojshme masa mbrojtëse.
- (4) Gjatë ushtrimit të funksioneve të veta, Zyra për Mbrojtjen dhe Mbështetjen e Dëshmitarëve respekton interesat e dëshmitarëve dhe viktimave pjesëmarrëse në procedura gjyqësore, ruan konfidencialitetin dhe vepron me paanësi gjatë gjithë kohës.
- (5) Duke mbajtur parasysh paragrafin 4, me qëllim përmbushjen e këtij mandati, Administratori mund të lidhë marrëveshje, protokolle apo ujdj me njërën ose më shumë prej palëve.

Nënpjesa 4: Zyra e Avokatit të Popullit**Rregulla 28****Dispozita të Përgjithshme**

- (1) ¹Zyra Administrative përfshin zyrën e pavarur të Avokatit të Popullit të Dhomave të Specializuara. ²Pavarësia e Avokatit të Popullit në kryerjen e cilësdo detyrë zyrtare respektohet gjatë gjithë kohës.
- (2) Avokati i Popullit i Dhomave të Specializuara është i pavarur në monitorimin, mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të mishëruara në Kapitullin II të Kushtetutës së Kosovës, të personave që kanë punë me Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, në përputhje me Ligjin dhe Rregulloren.
- (3) Avokati i Popullit emërohet për një periudhë prej katër (4) vjetësh.
- (4) Pas emërimit, Avokati i Popullit i Dhomave të Specializuara bën betimin solemn para Administratorit.
- (5) Në rast vdekjeje, invaliditeti të përhershëm apo të përkohshëm, dorëheqjeje, ose shkarkimi nga detyra prej Autoritetit Emërues për sjellje të rëndë kundërvajtëse, Autoriteti Emërues emëron një Avokat Populli tjetër.

Rregulla 29**Roli dhe funksionet e Avokatit të Popullit të Dhomave të Specializuara**

- (1) ¹Avokati i Popullit nuk ndërhyt në çështje gjyqësore ose procedura të tjera ligjore para Dhomave të Specializuara, me përjashtim të rasteve në lidhje me vonesa të paarsyeshme. ²Përveç nëse është i ftuar si *amicus curiae* bazuar në rregullën 67, Avokati i Popullit nuk ka kurrfarë të drejte paraqitjeje para një paneli, me përjashtim para Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese.
- (2) Përveç se kur përcaktohet ndryshe në Rregullore, Avokati i Popullit mund:
 - (a) të kryejë hetime në lidhje me ankesa të paraqitura prej cilitdo personi që pretendon shkelje të të drejtave nga Dhomat e Specializuara apo Zyra e Prokurorit të Specializuar. Në qoftë se ankesa bëhet në emër të një personi të drejtat e të cilit pretendohet se janë shkelur, personi në fjalë duhet të japë autorizimin e vet përpara fillimit të një hetimi.
 - (b) të shkojë dhe inspektojë në çdo kohë dhe pa paralajmërim objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara për vlerësimin e kushteve të paraburgimit;
 - (c) të propozojë ose mundësojë ndërmjetësim dhe pajtim për zgjidhjen e një ankese; dhe
 - (d) t'i paraqesë rekomandime Kryetarit ose Prokurorit të Specializuar për çështje që janë pjesë e funksioneve të tyre.
- (3) Kërkesa drejtuar Avokatit të Popullit mund të refuzohet nëse:
 - (a) kërkesa është në lidhje me një çështje gjyqësore ose procedura të tjera ligjore para Dhomave të Specializuara, dhe jo në lidhje me pretendime për vonesa të paarsyeshme;

- (b) kërkesa nuk tregon shkelje të të drejtave të njeriut prej Dhomave të Specializuara;
- (c) kërkesa është e paplotë, ose nuk është plotësuar në përputhje me shkresën përkujtuese të Avokatit të Popullit; ose
- (d) nuk janë përdorur të gjitha mjetet juridike të mundshme, përveç se në rast mosveprimi apo rrethanave më të ngutshme për të parandaluar dëm të rëndë dhe padrejtësi të pandreqshme.

Avokati i Popullit paraqet arsyet e refuzimit të kërkesës.

- (4) ¹Avokati i Popullit njofton ankuesin, si edhe Dhomat e Specializuara ose Zyren e Prokurorit të Specializuar për veprimet që janë objekt i hetimit. ²Dhomat e Specializuara, Zyra e Prokurorit të Specializuar apo personi, veprimi i të cilit është objekt i hetimit, përgjigjen brenda tridhjetë (30) ditësh pas marrjes së njoftimit prej Avokatit të Popullit.
- (5) Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar ndihmojnë Avokatin e Popullit në ushtrimin e funksioneve të veta, duke vepruar në përputhshmëri me Rregulloren ose urdhrat e Dhomave të Specializuara, veçanërisht ato në lidhje me konfidencialitetin.
- (6) Avokati i Popullit ruan konfidencialitetin e të gjithë informacionit të klasifikuar që i është dhënë, ose që Zyra e Avokatit të Popullit lejohet të shikojë.
- (7) ¹Pas përfundimit të hetimit, Avokati i Popullit nxjerr raportin përfundimtar, i cili i dorëzohet ankuesit, subjektit ose personit ndaj të cilit është bërë ankesa, dhe Kryetarit. ²Raporti i Avokatit të Popullit bëhet publik, me redaktimet e mundshme të nevojshme.

Kapitulli 3

Të drejtat e personave gjatë hetimit

Pjesa I: Masat hetimore

Nënpjesa 1: Të përgjithshme

Rregulla 30

Dispozitë e përgjithshme

- (1) Gjatë hetimit të një vepre penale brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara, Prokurori i Specializuar mund:
 - (a) të marrë në pyetje viktime, dëshmitarë dhe të dyshuar dhe të regjistrojë deklaratat e tyre;
 - (b) të kryejë hetime në vendngjarje, të mbledhë prova, të kryejë ekspertimin e provave të mbledhura, dhe sipas nevojës, të kryejë veprimtari të tjera hetimore;
 - (c) të kërkojë ndihmën e shteteve të treta dhe të organizatave ndërkombëtare, apo subjekteve të tjera;
 - (d) të marrë masa hetimore të përcaktuara në rregullën 34 deri në rregullën 41.
- (2) Gjatë hetimit, Prokurori i Specializuar vepron çdo herë në përputhje me të drejtat themelore të njeriut, të parapara në Kapitullin II të Kushtetutës dhe garanton:
 - (a) sigurinë dhe mbrojtjen e viktimave, dëshmitarëve dhe personave të tjerë të rrezikuar për shkak të dhënies së informacionit Zyrës së Prokurorit të Specializuar apo bashkëpunimit me Zyrën e Prokurorit të Specializuar; dhe
 - (b) mbrojtjen e privatësisë së cilitdo personi.

Rregulla 31

Garanci minimale të përgjithshme

- (1) ¹Një panel autorizon ose, kur është e zbatueshme, Prokurori i Specializuar ndërmerr masa hetimore të cilat mund të cenojnë të drejtat themelore të njeriut të parapara në Kapitullin II të Kushtetutës. ²Masa të tilla mund të autorizohen ose ndërmerren, sipas rastit, në qoftë se duke mbajtur parasysh të gjitha rrethanat përkatëse, përmbushen garancitë minimale të mëposhtme:
 - (a) plotësohen kushtet përkatëse, të përcaktuara në rregullën 34 deri në rregullën 41;
 - (b) masat hetimore janë të domosdoshme për hetimin; dhe
 - (c) ndërhyrja e shkaktuar në të drejtën e cilitdo personi për integritet personal, privatësi apo pronë, është proporcionale me qëllimin legjitim të hetimit dhe nuk mohon thelbin e të drejtës së garantuar.

- (2) Në rast se autorizon masa hetimore sipas paragrafit (1), paneli mund të urdhërojë Prokurorin e Specializuar që të dorëzojë informacion në lidhje me zbatimin e këtyre masave, si edhe në lidhje me materialin e mbledhur në bazë të rregullës 34 deri në rregullën 41, në mënyrën dhe brenda afatit që përcakton paneli.
- (3) ¹Informacioni i siguruar në kontekstin e marrëdhënieve profesionale apo marrëdhënieve të tjera konfidenciale përcaktuar në rregullën 111, konsiderohet i privilegjuar dhe nuk u nënshtrohet masave hetimore, përveç nëse statusi i privilegjuar keqpërdoret për të kryer një veprë penale brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara dhe provat që kërkohen, kanë kontribuar në kryerjen e asaj veprë penale. ²Në një rast të tillë, rregulla 33 (1)(a)(ii) zbatohet *mutatis mutandis*.
- (4) Sipas nevojës, paneli mund të përcaktojë edhe garanci të tjera mbrojtëse.

Rregulla 32

Mbajtja, ruajtja dhe mbrojtja e materialit të mbledhur apo të sekuestruar sipas rregullës 34 deri në rregullën 41

- (1) ¹Materiali i mbledhur apo i sekuestruar si rezultat i zbatimit të një mase të paraparë në rregullën 34 deri në rregullën 41, mbahet, ruhet dhe mbrohet në mënyrën e duhur. ²Çdo vendim i një paneli për autorizimin e një mase të tillë përmban:
- (a) procedurën dhe masat paraprake për ruajtjen, mbrojtjen, dhe kur është e zbatueshme transferimin e materialit të mbledhur apo të sekuestruar;
 - (b) kohëzgjatjen e mbajtjes së materialit të mbledhur apo të sekuestruar, dhe kur është e zbatueshme procedurën për ruajtjen e tij sipas rregullës 71; dhe
 - (c) udhëzime dhe afate për kthimin ose, kur është e zbatueshme, asgjësimin e materialit të mbledhur apo të sekuestruar.
- (2) ¹Rregulla 206 zbatohet *mutatis mutandis*. ²Kërkesat e autoriteteve të Kosovës mund të miratohen në varësi të masave mbrojtëse, nëse është e nevojshme.

Rregulla 33

Kthimi ose asgjësimi i materialit të mbledhur apo të sekuestruar sipas rregullës 34 deri në rregullën 41

- (1) Materiali i mbledhur apo i sekuestruar sipas rregullës 34 deri në rregullën 41, kthehet ose asgjësohet:
- (a) menjëherë,
 - (i) në qoftë se një material i tillë nuk lidhet me qëllimin e hetimit për të cilin është mbledhur, veçse kur është i rëndësishëm për hetimin e një veprë penale tjetër brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara; ose
 - (ii) në qoftë se një material i tillë është mbledhur në mënyrë të paligjshme, veçanërisht nëse paneli nuk miraton, ose nuk nxjerr vendim në lidhje me një urdhër të Prokurorit të Specializuar sipas rregullës 36 ose rregullës 38;

- (b) kur një material i tillë pushon së qeni i rëndësishëm në lidhje me qëllimin për të cilin është mbledhur, duke mbajtur parasysh:
- (i) llojin dhe peshën e veprës penale;
 - (ii) nevojat e hetimeve në kryerje e sipër; dhe
 - (iii) nëse personi përkatës është një i dyshuar, i shpallur fajtor, i shpallur i pafajshëm ose një person i tretë; ose
- (c) nëse kanë kaluar afatet e parashkrimit të ndjekjes penale të përcaktuara në nenin 106 të Kodit Penal të Kosovës.
- (2) ¹Në varësi të paragrafit (1), materiali i mbledhur apo i sekuestruar sipas rregullës 34 deri në rregullën 41:
- (a) kthehet prej Prokurorit të Specializuar *proprio motu*, ose me vendim të panelit; ose
 - (b) asgjësohet prej Prokurorit të Specializuar vetëm me vendim të panelit.
- ²Evidentimi i çdo kthimi ose asgjësim të tillë të materialit është i detyrueshëm.
- (3) ¹Personi përkatës njoftohet për çdo vendim për kthimin, ose asgjësimin e materialit, të paktën nëntëdhjetë (90) ditë përpara zbatimit të një vendimi të tillë, ose në përputhje me një vendim tjetër. ²Personi në fjalë mund të kërkojë rishikimin e një vendimi të tillë.

Nënpjesa 2: Masa hetimore të posaçme

Rregulla 34

Kushtet për marrjen e masave hetimore të posaçme

- (1) Në varësi të rregullës 31(1), masa hetimore të posaçme mund të ndërmerren vetëm nëse ekziston dyshim i bazuar se është kryer, është duke u kryer apo do të kryhet një vepër penale përcaktuar në nenin 13 ose 14 të Ligjit, ose vepër penale përcaktuar në nenet 388(2) dhe (3), 393, 394(1), (4) dhe (5), 395, 396, 397(1), 400(2) deri në (4), 409, 410, 423 ose 424, të Kodit Penal të Kosovës, siç përmendet në nenin 15(2) të Ligjit.
- (2) Masa hetimore të posaçme mund të ndërmerren kur provat nuk mund të sigurohen me anë të ndonjë mase tjetër më pak ndërhyrëse por po aq të efektshme, dhe merren në lidhje me një person ose vend konkret, kur ekziston dyshim i bazuar se:
- (a) personi në fjalë ka kryer, është duke kryer ose do të kryejë cilëndo vepër penale nga paragrafi (1), brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara;
 - (b) personi në fjalë merr ose përcjell komunikim për të dyshuarin apo të akuzuarin, ose prej të dyshuarit apo të akuzuarit, ose mjeti i tij i komunikimit përdoret prej të dyshuarit ose të akuzuarit;
 - (c) një vend konkret përdoret apo do të përdoret për kryerjen e një vepre penale nga paragrafi (1), brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara; ose

- (d) provat në lidhje me një vepër penale nga paragrafi (1) mund të zbulohen në një vend konkret dhe provat e kërkuara janë të domosdoshme për hetimin.
- (3) Personi përmendur në paragrafin (2) njoftohet nga Prokurori i Specializuar për cilëndo masë të ndërmarrë në lidhje me të në bazë të rregullës 34 deri në rregullën 36, me kusht që kjo të mos rrezikojë qëllimin e masës së ndërmarrë ose kryerjen e procedurave.

Rregulla 35

Masa hetimore të posaçme të autorizuara prej një paneli

- (1) Për marrjen e masave hetimore të posaçme, Prokurori i Specializuar kërkon autorizimin e një paneli.
- (2) Kur është bindur se janë plotësuar kushtet e rregullës 31(1) dhe rregullës 34, paneli mund të nxjerrë një vendim për autorizimin e masave hetimore të posaçme të kërkuara, në të cilin përmenden:
- (a) periudha kohore për të cilën jepet autorizimi, në varësi të rrethanave përkatëse të hetimit, e cila nuk mund të zgjasë më shumë se gjashtëdhjetë (60) ditë;
- (b) procedura e raportimit në lidhje me zbatimin e masave të autorizuara dhe materialin e mbledhur, qoftë brenda afateve të rregullta, ose me përfundimin e masave, varësisht nga vendimi i panelit, në përputhje me rregullën 31(2);
- (c) autorizimi për hyrje në një vend konkret, në rast se është e nevojshme për zbatimin, vijimin ose përfundimin e masës hetimore përkatëse. Për një autorizim të tillë nuk është i detyrueshëm njoftimi i të dyshuarit apo të akuzuarit, përveç nëse në rrethanat përkatëse të çështjes, paneli gjykon se njoftimi i të dyshuarit apo të akuzuarit nuk rrezikon efektshmërinë e masës së kërkuar.
- (3) Periudha kohore përcaktuar në paragrafin (2)(a) mund të zgjatet më së shumti 12 muaj, në qoftë se me gjithë zellin e duhur të Prokurorit të Specializuar qëllimi i hetimit nuk është realizuar dhe ende përmbushen kushtet e parapara në rregullën 31(1) dhe rregullën 34.
- (4) ¹Në rrethana të jashtëzakonshme të përcaktuara nga faktorë si pesha e veprës penale, kompleksiteti i hetimit, ose konstatimi se me gjithë zellin e duhur Prokurori i Specializuar ka zbuluar rrethana të reja pak para përfundimit të masës përkatëse, periudha e përcaktuar në paragrafin (3) mund të zgjatet edhe më tej. ²Paneli rishikon rregullisht masat e miratuara, të paktën çdo gjashtëdhjetë (60) ditë, dhe mund t'i përfundojë ato në çdo kohë, në qoftë se kushtet përkatëse nuk përmbushen më dhe në qoftë se kjo diktohet nga detyrimi i respektimit të të drejtave të njeriut.

Rregulla 36

Masa hetimore të posaçme të urdhëruara prej Prokurorit të Specializuar

- (1) Prokurori i Specializuar mund të urdhërojë masa hetimore të posaçme pa autorizimin e një paneli në qoftë se janë përmbushur kushtet e përcaktuara në rregullën 31(1) dhe rregullën 34, dhe:
 - (a) zbatimi i menjëhershëm i masave të tilla është i domosdoshëm për mundësimin e mbledhjes së provave të cilat nuk mund të sigurohen në një mënyrë tjetër; dhe
 - (b) çdo vonesë si rezultat i kërkimit të autorizimit prej panelit, do të rrezikonte hetimin apo sigurinë e një dëshmitari, viktime ose personi tjetër të rrezikuar.
- (2) Prokurori i Specializuar i paraqet panelit kërkesë për miratimin e masave të tilla menjëherë dhe jo më vonë se njëzet e katër (24) orë pas fillimit të zbatimit të tyre.
- (3) ¹Paneli që shqyrton kërkesën miraton masat hetimore të posaçme brenda tri (3) ditësh nga paraqitja e kërkesës, vetëm nëse bindet se janë përmbushur kushtet e paragrafit (1). ²Rregulla 35 zbatohet *mutatis mutandis*.
- (4) ¹Në qoftë se një kërkesë e tillë nuk është paraqitur, nuk është miratuar, ose paneli nuk ka nxjerrë vendim në lidhje me të, urdhri i Prokurorit të Specializuar për masa hetimore të posaçme pushon së qeni në fuqi dhe Prokurori i Specializuar ndërpret menjëherë masat përkatëse. ²Materiali i mbledhur, në qoftë se ka, nuk mund të përdoret për hetim apo ndjekje penale.

Nënpjesa 3: Kontrollimi dhe sekuestrimi

Rregulla 37

Kontrollimi dhe sekuestrimi i autorizuar prej një paneli

- (1) Prokurori i Specializuar i kërkon një paneli autorizim për kontrollim dhe sekuestrim në qoftë se në rrethanat konkrete provat nuk mund të sigurohen në një mënyrë tjetër dhe kontrollimi dhe sekuestrimi i kërkuar duket se është e vetmja masë e efektshme për nevojat e hetimit.
- (2) Paneli mund të autorizojë kontrollimin e pronës së një personi ose të vendeve, ambienteve, ose objekteve të tjera në lidhje me të cilat personi në fjalë ka pritshmëri të arsyeshme për respektimin e privatësisë, si edhe të autorizojë sekuestrimin e sendeve të gjetura gjatë kontrollimit, në qoftë se:
 - (a) ekziston dyshim i bazuar se personi në fjalë ka kryer, është duke kryer, ose do të kryejë një veprë penale brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara dhe kontrollimi do të rezultojë në arrestimin e atij personi, ose në zbulimin dhe sekuestrimin e provave të domosdoshme për hetimin;
 - (b) ekziston dyshim i bazuar se kontrollimi do të rezultojë në arrestimin e një të dyshuari; ose
 - (c) kontrollimi është i domosdoshëm për mbledhjen dhe ruajtjen e provave për një veprë penale brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara dhe ekziston dyshim i bazuar se prova të tilla gjenden në pronën, vendin ose objektin që do të kontrollohet.
- (3) Paneli mund të autorizojë kontrollimin e një personi në qoftë se ekziston dyshim i bazuar se kontrollimi do të rezultojë në zbulimin e provave për një veprë penale brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara dhe rrjedhimisht në sekuestrimin e provave të tilla.

- (4) Në rast se bindet se janë përmbushur kushtet e përcaktuara në paragrafët (1) deri në (3), në varësi të rrethanave, si edhe kushtet e parapara në rregullën 31(1), paneli mund të marrë vendim për autorizimin e kontrollimit dhe sekuestrimit i cili përmban:
- (a) kohën, kohëzgjatjen dhe shkallën e kontrollimit dhe sekuestrimit, duke përfshirë të dhëna për personin ose pronën, vendin, ambientin ose objektin në lidhje me të cilat autorizohet masa përkatëse; dhe
 - (b) procedurën e raportimit në lidhje me zbatimin e masës së autorizuar dhe materialin e sekuestruar, në përputhje me rregullën 31(2).
- (5) Paneli mund të përcaktojë edhe kushte të tjera që i gjykon të nevojshme.

Rregulla 38

Kontrollimi dhe sekuestrimi prej Prokurorit të Specializuar

- (1) Bazuar në nenin 35 dhe nenin 39 të Ligjit dhe në përputhje me kushtet e përcaktuara në rregullën 37 (1-3), Prokurori i Specializuar, pa autorizimin e një paneli, mund të kryejë kontrollimin e një personi ose prone, vendi, ambienteve apo objekti, dhe të sekuestrojë përkohësisht çfarëdo sendi të gjetur gjatë kontrollimit, në qoftë se:
- (a) personi në fjalë me vetëdije dhe vullnetarisht pajtohet me kryerjen e kontrollimit dhe sekuestrimin;
 - (b) personi në fjalë është kapur duke kryer një veprë penale brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara dhe pas ndjekjes nga afër do të arrestohet; ose
 - (c) një veprim i tillë është i domosdoshëm për të parandaluar rrezikun e menjëhershëm të një dëmi të rëndë dhe të pandreqshëm ndaj personave të tjerë ose pronës.
- (2) Kërkesën për miratimin e kontrollimit dhe sekuestrimit, Prokurori i Specializuar ia parqet një paneli menjëherë dhe jo më vonë se njëzet e katër (24) orë pas fillimit të kontrollimit dhe sekuestrimit.
- (3) Paneli që shqyrton kërkesën mund të miratojë kontrollimin dhe sekuestrimin brenda tri (3) ditësh nga paraqitja e kërkesës vetëm nëse bindet se janë plotësuar kushtet e përcaktuara në paragrafin (1).
- (4) ¹Në qoftë se një kërkesë e tillë nuk është paraqitur, nuk është miratuar, ose paneli nuk ka nxjerrë vendim në lidhje me të, urdhri i Prokurorit të Specializuar për kontrollim dhe sekuestrim pushon së qeni në fuqi dhe Prokurori i Specializuar ndërpret menjëherë kontrollimin dhe sekuestrimin.
- ²Materiali i sekuestruar, në qoftë se ka, nuk mund të përdoret për hetim apo ndjekje penale.

Rregulla 39

Kryerja e kontrollimit dhe sekuestrimit

- (1) Në varësi të paragrafit (2), kontrollimi dhe sekuestrimi në bazë të rregullës 37 ose rregullës 38, kryhen prej Prokurorit të Specializuar në prani të personit përkatës dhe para kryerjes së kontrollimit dhe sekuestrimit, Prokurori i Specializuar:

- (a) i jep një kopje të legalizuar të vendimit të panelit apo të urdhrorit të Prokurorit të Specializuar personit ndaj të cilit është marrë vendimi ose urdhri përkatës;
- (b) informon personin në fjalë për të drejtat e tij sipas rregullës 42 ose rregullës 43, në varësi të rrethanave;
- (c) siguron që mbrojtësi i personit të jetë i pranishëm gjatë kontrollimit dhe sekuestrimit, përveç nëse personi heq dorë vullnetarisht nga ushtrimi i kësaj të drejte, apo logjikisht nuk mund të pritët prania e mbrojtësit; dhe
- (d) siguron praninë e një vëzhguesi të pavarur i cili shërben si dëshmitar gjatë kryerjes së kontrollimit dhe sekuestrimit.
- (2) ¹Kontrollimi dhe sekuestrimi mund të kryhen edhe pa praninë e personit përkatës në qoftë se ky person nuk mund të gjendet ose refuzon të jetë i pranishëm gjatë kryerjes së kontrollimit dhe kur çdo vonesë në kryerjen e kontrollimit dhe sekuestrimit do të rrezikonte hetimin apo sigurinë ose pronën e një dëshmitari, viktime apo personi tjetër të rrezikuar. ²Zbatohen paragrafi (1)(c), nëse është e realizueshme, dhe (d). ³Personi përkatës informohet për kryerjen e kontrollimit dhe sekuestrimit menjëherë pasi të përcaktohet vendndodhja e tij.
- (3) Gjatë kryerjes së kontrollimit dhe sekuestrimit bëhet kujdes që të shmanget çfarëdo dëmtimi i panevojshëm i pronës.
- (4) ¹Prokurori i Specializuar dokumenton kohën e kryerjes, kohëzgjatjen, shkallën, dhe të gjitha hollësitë e tjera të kontrollimit dhe sekuestrimit. ²Në rastet kur paneli ka përcaktuar kushte plotësuese në lidhje me kryerjen e kontrollimit dhe sekuestrimin, dokumentohet edhe zbatimi i kushteve plotësuese. ³Prokurori i Specializuar përpilon listën e inventarit të sendeve të sekuestruara me përshkrim dhe informacion të hollësishëm në lidhje me secilin send të sekuestruar. ⁴Prokurori i Specializuar, vëzhguesi i pavarur, personi përkatës dhe mbrojtësi i tij, në qoftë se është i pranishëm, nënshkruajnë listën e inventarit dhe mund të bëjnë vërejtje me shkrim në lidhje me kryerjen e kontrollimit dhe sekuestrimit. ⁵Dokumentohet edhe refuzimi i personit përkatës për të nënshkruar dokumentin, si edhe arsyet e refuzimit.
- (5) Prokurori i Specializuar mban dhe ruan sendet e sekuestruara në përputhje me rregullën 32.

Nënpjesa 4: Masa të tjera

Rregulla 40

Zhvarrosja dhe ekzaminimi *post-mortem*

- (1) Në qoftë se ka arsye të besojë se kufoma e një personi vdekja e të cilit ka të ngjarë të jetë pasojë e një veprë penale brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara, mund të gjendet në një vend të caktuar, Prokurori i Specializuar i kërkon panelit autorizim për këqyrjen e vendvarrosjes dhe për zhvarrosje, dhe nëse zbulohet kufoma e personit, për ekzaminimin *post-mortem* të kufomës.
- (2) Në qoftë se trupi gjykues miraton masa të tilla, rregulla 202 ose rregulla 208, sipas rastit, zbatohen *mutatis mutandis*.

- (3) Ekzaminimin *post-mortem* të kufomës së zhvarrosur bazuar në paragrafin (1), e kryen një ekspert mjeko-ligjor i miratuar prej trupit gjykues për të përcaktuar, ndër të tjera:
- (a) identitetin e kufomës;
 - (b) shkakun dhe kohën e vdekjes; dhe
 - (c) llojin e lëndimeve të mundshme.

Rregulla 41

Mbledhja e materialeve trupore për ekspertizë mjeko-ligjore

- (1) Mbledhja e qimeve, pështymës, mostrave të gjakut, indeve trupore ose materialeve të tjera të ngjashme, të cilat nuk mund të merren pa kontakt fizik ose ndërhyrje trupore në trupin e një personi, mund të kryhet me miratim me shkrim dhe të dhënë vullnetarisht të personit përkatës, pasi personi në fjalë të jetë këshilluar me mbrojtësin e vet, ose me vetëdije të ketë hequr dorë nga e drejta për t'u këshilluar me mbrojtësin e vet.
- (2) Në mungesë të një miratimi të tillë, një panel mund të autorizojë masat e parapara në paragrafin (1) në lidhje me një person, në qoftë se:
- (a) ekziston dyshim i bazuar se personi në fjalë ka kryer një veprë penale brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara; ose
 - (b) zbulimi i të vërtetës kërkon që të përcaktohet nëse në trupin e personit përkatës ka gjurmë apo pasoja të një veprë penale brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara.
- (3) Për marrjen e vendimit, dhe sipas nevojës, pasi të ketë dëgjuar personin në fjalë, paneli merr parasysh, ndër të tjera:
- (a) llojin dhe peshën e veprës penale;
 - (b) në qoftë se materialet që kërkohen mund të sigurohen me anë të një metode tjetër;
 - (c) procedurën përkatëse për kryerjen e ekspertizës mjeko-ligjore; dhe
 - (d) pasojat për shëndetin e personit në fjalë.
- (4) Mbledhja e mostrave të gjakut, indeve trupore ose materialeve të tjera të ngjashme mund të kryhet vetëm prej një eksperti të kualifikuar mjekësor.
- (5) Materiali i përmendur në paragrafët (1) dhe (2) nuk përdoret për asnjë qëllim tjetër, përveç se për hetimin dhe ndjekjen e veprave penale brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara.

Pjesa II: Të drejtat e personave gjatë hetimit**Rregulla 42****Dispozitë e përgjithshme**

Gjatë hetimit që kryen Prokurori i Specializuar, një person:

- (a) nuk detyrohet të inkriminojë vetveten ose të pranojë fajësinë;
- (b) nuk i nënshtrohet asnjë forme shtrëngimi, nxitjeje, premtimi të paarsyeshëm, dhune apo kërcënimi, torture ose ndonjë forme tjetër trajtimi apo ndëshkimi mizor, çnjerëzor, ose poshtërues;
- (c) në qoftë se merret në pyetje në një gjuhë tjetër prej gjuhës që kupton dhe flet, ka të drejtën e ndihmës pa pagesë të një përkthyesi me gojë, si edhe të përkthimeve me shkrim të nevojshme për përmbushjen e kushtit të drejtësisë dhe paanësisë; dhe
- (d) nuk arrestohet ose paraburgoset në mënyrë arbitrare dhe nuk privohet nga liria, përveç se në përputhje me Ligjin dhe Rregulloren.

Rregulla 43**Të drejtat e të dyshuarve gjatë hetimit**

- (1) Në qoftë se Prokurori i Specializuar ka arsye për të dyshuar se një person ka kryer ose ka marrë pjesë në kryerjen e një vepre penale brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara, personi në fjalë konsiderohet i dyshuar dhe pasi informohet për këtë, gëzon të paktën të drejtat e përcaktuara në nenin 38(3) të Ligjit.
- (2) Për të drejtat e përcaktuara në nenin 38(3) të Ligjit, Prokurori i Specializuar e informon të dyshuarin para marrjes në pyetje, në mënyrën dhe gjuhën që i dyshuari kupton dhe flet.
- (3) ¹Veprimet hetimore që kërkojnë praninë e të dyshuarit, veçanërisht marrja në pyetje, ballafaqimi, seanca e identifikimit ose rikonstruksioni i vendit të ngjarjes, nuk fillojnë pa praninë e Mbrojtësit të Specializuar. ²I dyshuari mund të heqë dorë nga kjo e drejtë nëse Prokurori i Specializuar sigurohet se i dyshuari e kupton rëndësinë e kësaj të drejte dhe pasojat e heqjes dorë prej saj. ³Kur e informon të dyshuarin për këtë të drejtë, Prokurori i Specializuar mban parasysh rrethanat personale të të dyshuarit, ndër të tjera moshën dhe gjendjen mendore e fizike të të dyshuarit. ⁴Heqja dorë nga kjo e drejtë dhe rrethanat e heqjes dorë nga kjo e drejtë dokumentohen me shkrim prej Prokurorit të Specializuar dhe nënshkruhen prej të dyshuarit.
- (4) ¹I dyshuari informohet se mund të kërkojë rikthimin e të drejtës së përfaqësimit në cilëndo fazë të marrjes në pyetje. ²Kur i dyshuari kërkon rikthimin e të drejtës së përfaqësimit, marrja në pyetje ndërpritet dhe rifillon vetëm në praninë e Mbrojtësit të Specializuar. ³Marrja në pyetje ose cilido veprim hetimor i kryer para rikthimit të së drejtës së përfaqësimit, mbetet i vlefshëm dhe nuk përsëritet.

Rregulla 44**Regjistrimi i marrjes në pyetje të të dyshuarve**

- (1) ¹Gjatë marrjes në pyetje të një të dyshuari nga ana e Prokurorit të Specializuar, zbatohet procedura e përcaktuar në rregullën 43. ²Marrja në pyetje filmohet në përputhje me procedurën e mëposhtme:
- (a) i dyshuari informohet në një gjuhë që kupton dhe flet, se marrja në pyetje do të filmohet. Në rast se i dyshuari kundërshton filmimin e marrjes në pyetje, fakti se i dyshuari është informuar, si edhe përgjigjja e të dyshuarit, dokumentohen me shkrim dhe dokumenti nënshkruhet prej të dyshuarit;
 - (b) në rast ndërprerjeje gjatë marrjes në pyetje, Prokurori i Specializuar përmend faktin dhe kohën e ndërprerjes para se të ndërpritet filmimi, dhe gjithashtu përmend kohën e rifillimit të marrjes në pyetje në vazhdimin e filmimit. Gjatë ndërprerjeve, Prokurori i Specializuar nuk bën kurrfarë diskutimesh në lidhje me çështjen që hetohet apo pozitën e të dyshuarit;
 - (c) në fund të marrjes në pyetje, të dyshuarit i jepet mundësia të sqarojë, plotësojë ose ndryshojë çfarëdo që të ketë thënë. Në fund të filmimit përmendet koha e përfundimit të marrjes në pyetje;
 - (d) një kopje e videofilmimit i jepet të dyshuarit apo Mbrojtësit të Specializuar të të dyshuarit;
 - (e) pasi është bërë një kopje e videofilmimit, origjinali i videofilmimit mbyllet me vulë në praninë e të dyshuarit dhe nënshkruhet prej Prokurorit të Specializuar dhe të dyshuarit; dhe
 - (f) videofilmimi transkripton në qoftë se Prokurori i Specializuar paraqet aktakuzë kundër të dyshuarit.
- (2) ¹Në rrethana të posaçme të cilat nuk mundësojnë filmimin e marrjes në pyetje të të dyshuarit, marrja në pyetje nga paragrafi (1) mund të kryhet edhe pa u filmuar. ²Prokurori i Specializuar dokumenton arsyet e mosndjekjes së procedurës së përshkruar në paragrafin (1).
- (3) ¹Në rast se në bazë të paragrafit (1) ose (2), marrja në pyetje nuk filmohet, Prokurori i Specializuar përgatit transkriptin me shkrim të marrjes në pyetje të të dyshuarit, dhe transkripti nënshkruhet prej Prokurorit të Specializuar dhe të dyshuarit. ²Prokurori i Specializuar dokumenton çdo refuzim të të dyshuarit për leximin ose nënshkrimin e transkriptit, si edhe arsyet e refuzimit, dhe u kërkon të gjithë të pranishmëve të tjerë ta lexojnë dhe nënshkruajnë transkriptin.

Rregulla 45**Pranimet**

Pranimi jashtëgjyqësor prej të dyshuarit ose të akuzuarit që bëhet gjatë marrjes në pyetje prej Prokurorit të Specializuar, konsiderohet të jetë bërë lirisht dhe vullnetarisht, me kusht që Prokurori i Specializuar të vërtetojë se janë përmbushur përpikmërisht kërkesat e rregullës 43 dhe rregullës 44.

Rregulla 46**Ruajtja e informacionit**

- (1) Varësisht prej detyrimeve të Administratorit përcaktuar në rregullën 24, Prokurori i Specializuar është përgjegjës për mbajtjen, ruajtjen dhe sigurinë e informacionit dhe të materialit fizik dhe elektronik të mbledhur gjatë hetimeve të Prokurorit të Specializuar, derisa dhe nëse një informacion apo material i tillë paraqitet si provë në një gjykim.
- (2) Përveç mënyrës elektronike të paraqitjes së provave të përdorur prej Dhomave të Specializuara, Prokurori i Specializuar duhet të sigurojë që cilido material i tillë të jetë i disponueshëm nëse kërkohet nga Mbrojtja ose trupi gjykses.

Rregulla 47**Pushimi i hetimit**

- (1) Në qoftë se brenda një afati të arsyeshëm pasi një person të jetë bërë i dyshuar dhe të jetë informuar për këtë, dhe kundër tij Prokurori i Specializuar nuk paraqet aktakuzë para Dhomave të Specializuara sipas nenit 38(4) të Ligjit, i dyshuari mund t'i kërkojë Prokurorit të Specializuar pushimin e hetimit kundër tij.
- (2) Në qoftë se një kërkesë e tillë hidhet poshtë ose nuk merret parasysh, i dyshuari mund të kërkojë që një gjykatës i vetëm i caktuar në pajtim me nenin 25(1)(f) të Ligjit, ta shqyrtojë çështjen, dhe në qoftë se është e nevojshme, të urdhërojë pushimin e hetimit kundër të dyshuarit.

Kapitulli 4

Fletëthirrja, arrestimi dhe paraburgimi

Pjesa I: Dispozita të përgjithshme

Rregulla 48

Parime themelore

- (1) Asnjë person nën juridiksionin e Dhomave të Specializuara nuk privohet nga liria, përveç se në përputhje me Ligjin dhe Rregulloren.
- (2) Me kërkesën e një pale ose *proprio motu*, një trup gjykues mund të lëshojë fletarrestime, fletëthirrje për paraqitje në gjyq, vendime ose urdhra sikurse mund ta lypë hetimi ose përgatitjet dhe kryerja e procedurave gjyqësore.

Rregulla 49

Fletëthirrjet dhe urdhrat e tjerë

- (1) Çdo fletëthirrje, vendim ose urdhër të Dhomave të Specializuara, Administratori ua dorëzon autoriteteve kompetente.
- (2) Kur fletëthirrja, vendimi ose urdhri i dorëzohet Kosovës ose një shteti të tretë që ka marrëveshje bashkëpunimi me Dhomat e Specializuara, ose që ka marrë përsipër obligimin e dhënies së ndihmës mbi çfarëdo baze tjetër, autoritetet kompetente përkatëse veprojnë me zellin e duhur për të mundësuar zbatimin efektiv të tyre.
- (3) Kur fletëthirrja, vendimi ose urdhri është në lidhje me një person, vendndodhja e të cilit është, ose dihet se ka qenë së fundi në një shtet të tretë të ndryshëm prej çfarëdo shteti të tretë tjetër të përmendur në paragrafin (2), kërkesën për bashkëpunim së bashku me fletëthirrjen ose urdhrin përkatës, Administratori ua dorëzon autoriteteve kompetente të atij shteti.
- (4) ¹Nëse personi në fjalë nuk është i pranishëm në vendin ku duhet t'i dorëzohet dokumenti, zyrtari dorëzues lë një njoftim me shkrim ku personit të cilit i drejtohet fletëthirrja ose urdhërparaqitja i kërkohet të paraqitet në një vend, datë dhe orë të caktuar për të marrë personalisht dokumentin. ²Në rast se edhe pas dy përpjekjeve për dorëzim personal të dokumentit të kryera brenda një kohe të arsyeshme, personi të cilit i drejtohet dokumenti nuk paraqitet, ose refuzon të marrë fletëthirrjen ose urdhërparaqitjen, zyrtari dorëzues i dokumentit evidenton datën, kohën dhe numrin e përpjekjeve, si edhe arsyet e refuzimit të dokumentit, në qoftë se arsye të tilla bëhen të njohura. ³Zyrtari dorëzues lë fletëthirrjen ose urdhërparaqitjen në një vend ku dokumenti konsiderohet i dorëzuar.

Rregulla 50

Transferimi në Dhomat e Specializuara

- (1) Kur një dëshmitar, i dyshuar ose i akuzuar procedohet në bazë të një fletëthirrjeje, vendimi ose urdhri të Dhomave të Specializuara apo të Prokurorit të Specializuar, ose është duke vuajtur një

dënim në Kosovë, trupi gjykues u drejton autoriteteve kompetente një urdhër për transferimin pa vonesë të atij personi në Dhomat e Specializuara, dhe në këtë urdhër trupi gjykues mund të përcaktojë kushtet e transferimit dhe të paraburgimit të mëpasshëm, pas këshillimeve me Administratorin.

- (2) Gjithashtu, trupi gjykues mund të urdhërojë ose të kërkojë transferimin e personave të tillë prej cilitdo shteti të tretë, në bazë të marrëveshjes së atij shteti me Kosovën apo me Dhomat e Specializuara, ose në bazë të reciprocitetit.

Rregulla 51

Zhdëmtimi për arrestim ose paraburgim të paligjshëm

- (1) Pas një vendimi të formës së prerë se një person është arrestuar apo paraburgosur në mënyrë të paligjshme me autorizimin e Dhomave të Specializuara, personi në fjalë mund t'i paraqesë Kryetarit kërkesë për zhdëmtim ose për ndonjë masë ndreqëse tjetër, brenda gjashtë (6) muajsh pas daljes së vendimit të formës së prerë.
- (2) ¹Kryetari cakton një panel i cili merr vendimin në lidhje me kërkesën pasi të ketë dëgjuar parashtrimet e Prokurorit të Specializuar. ²Në përcaktimin e zhdëmtimit të duhur ose të ndonjë mase ndreqëse tjetër të justifikueshme për rastet e përcaktuara në paragrafin (1), paneli merr parasysh pasojat e arrestimit dhe paraburgimit të paligjshëm në rrethanat personale, familjare, shoqërore dhe profesionale të personit që ka paraqitur kërkesën.

Pjesa II: Arrestimi

Rregulla 52

Urdhërarresti prej Prokurorit të Specializuar

- (1) Kur një person arrestohet në bazë të një urdhërarresti të lëshuar nga Prokurori i Specializuar sipas nenit 35(2)(h) dhe në përputhje me nenin 41(6) të Ligjit, Prokurori i Specializuar informon menjëherë Kryetarin dhe Administratorin.
- (2) ¹Në përputhje me nenin 41(3) të Ligjit, çdo person i arrestuar në bazë të kësaj rregulle, nxirret para një paneli brenda dyzet e tetë (48) orësh pas arrestimit. ²Paneli duhet të bindet se personi i arrestuar është informuar për arsyet e arrestimit në përputhje me nenin 41(6) të Ligjit, si edhe për të drejtat që gëzon në bazë të Ligjit dhe Rregullores. ³Paneli merr vendimin për mbajtjen e mëtejshme në paraburgim ose lirin e personit brenda dyzet e tetë (48) orësh pas nxjerrjes së personit të paraburgosur para tij.
- (3) ¹Pas një arrestimi sipas paragrafit (1), Prokurori i Specializuar, pa vonesë të papërligjitur, i paraqet panelit kërkesë për urdhër për transferimin e personit të arrestuar në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara. ²Nëse paneli nxjerr urdhër për transferim, Administratori kryen përgatitjet e nevojshme me autoritetet kompetente.

Rregulla 53**Fletarrestimi i lëshuar prej Dhomave të Specializuara**

- (1) Me kërkesë të Prokurorit të Specializuar ose *proprio motu*, një panel mund të lëshojë fletarrestim, në qoftë se është bindur se janë përmbushur kushtet e përcaktuara në nenin 41(6) të Ligjit.
- (2) Fletarrestimi përmban informacionin në vijim:
 - (a) emrin dhe mbiemrin e personit dhe të dhëna të tjera identifikuese;
 - (b) veprat penale nën juridiksionin e Dhomave të Specializuara, mbi bazën e të cilave kërkohet arrestimi i personit;
 - (c) përshkrim të shkurtër të fakteve të cilat pretendohet se përbëjnë veprat penale të lartpërmendura; dhe
 - (d) nëse është e zbatueshme, objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara në të cilin personi do të transferohet.
- (3) Fletarrestimi mbetet në fuqi deri në një urdhër tjetër të panelit.

Rregulla 54**Fletarrestimet ndërkombëtare të lëshuara prej Dhomave të Specializuara**

Me kërkesë të Prokurorit të Specializuar ose *proprio motu*, një panel mund të lëshojë fletarrestim ndërkombëtar i cili u dorëzohet të gjitha shteteve nëpërmjet organeve ndërkombëtare përkatëse.

Rregulla 55**Zbatimi i fletarrestimeve**

- (1) Fletarrestimin e lëshuar prej Dhomave të Specializuara, Administratori ua dorëzon autoriteteve kompetente, dhe sipas rrethanave, Prokurorit të Specializuar.
- (2) Kur fletarrestimi i dorëzohet Kosovës ose një shteti të tretë që ka marrëveshje bashkëpunimi me Dhomat e Specializuara, ose që ka marrë përsipër obligimin e dhënies së ndihmës mbi çfarëdo baze tjetër, autoritetet kompetente të atij shteti veprojnë me zellin e duhur për të mundësuar zbatimin efektiv të fletarrestimit.
- (3) Kur fletarrestimi është në lidhje me një person, vendndodhja e të cilit është ose dihet se ka qenë së fundi në një shtet të tretë të ndryshëm prej çfarëdo shteti të tretë tjetër të përmendur në paragrafin (2), kërkesën për bashkëpunim së bashku me fletarrestimin, Administratori ua dorëzon autoriteteve kompetente të atij shteti.
- (4) ¹Në qoftë se një person arrestohet në Kosovë, ose në një shtet të tretë në bazë të një fletarrestimi të lëshuar prej Dhomave të Specializuara, autoritetet kompetente të atij shteti mund ta paraburgosin personin dhe për këtë informojnë pa vonesë Administratorin, i cili informon menjëherë Kryetarin, panelin dhe palët. ²Administratori bën përgatitjet e nevojshme për transferimin e menjëhershëm të personit të arrestuar në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara, në bashkëpunim me autoritetet kompetente dhe me shtetin pranues.

- (5) ¹Autoritetet e Kosovës zbatojnë fletarrestimin, dhe kryejnë paraburgimin dhe transferimin e personit të arrestuar pa vonesë dhe në përputhje me kushtet e përcaktuara. ²Ato nuk i ofrojnë personit të arrestuar asnjë mjet ligjor që nuk urdhërohet shprehimisht në fletarrestim.
- (6) Në përputhje me nenin 41(5) të Ligjit, çdo person i arrestuar në bazë të kësaj rregulle nxirret pa vonesë të papërligjur para një paneli i cili duhet të bindet se personi në fjalë është informuar për arsyet e arrestimit në përputhje me nenin 41(4) të Ligjit, dhe për të drejtat që gëzon në bazë të Ligjit dhe Rregullores.

Pjesa III: Paraburgimi

Rregulla 56

Mbajtja në paraburgim

- (1) ¹Personi i paraburgosur në bazë të një urdhri për paraburgim mbahet në paraburgim në përputhje me nenin 41(7) të Ligjit. ²Në rrethana të posaçme, personi në fjalë mund të mbahet në paraburgim në një objekt jashtë shtetit pranues apo jashtë Kosovës, deri në transferimin e tij. ³Në rrethana të tilla, me kërkesë të një pale dhe pas këshillimeve me Administratorin, paneli mund të kërkojë modifikimin e kushteve të paraburgimit ose të shprehë mendimin në lidhje me kushtet e paraburgimit. ⁴Gjatë gjithë kohës, personi i paraburgosur është nën juridiksionin e Dhomave të Specializuara.
- (2) ¹Para caktimit të gjykatësit të procedurës paraprake sipas nenit 33(1)(a) të Ligjit, vlerësimin e paraburgimit e bën gjykatësi i vetëm i caktuar në përputhje me nenin 33(2) të Ligjit, çdo dy (2) muaj ose më herët, me kërkesë të të dyshuarit apo të Prokurorit të Specializuar, ose *proprio motu*. ²Përveç arsyeve të përcaktuara në nenin 41(6) të Ligjit, çdo kërkesë për mbajtje të mëtejshme në paraburgim duhet të përligjet prej masave hetimore që do të ndërmerren prej Prokurorit të Specializuar. ³Paraburgimi sipas kësaj dispozite nuk mund të zgjasë më shumë se një (1) vit. ⁴Me përfundimin e kësaj periudhe, dhe në qoftë se gjykatësi i procedurës paraprake ende nuk është caktuar, i dyshuari lirohet nga paraburgimi.
- (3) Pa cenuar nenin 21(4)(c) të Ligjit, në bazë të një kërkesë ose *proprio motu*, dhe me qëllim mbrojtjen e dëshmitarëve apo viktimave, e informacionit konfidencial apo ndershmërisë së procesit, paneli mund të nxjerrë vendim lidhur me kushtet e paraburgimit dhe çështje që kanë lidhje me paraburgimin, ndër të tjera vendim mbi përcaktimin e kufizimeve të nevojshme dhe proporcionale të mundësisë për komunikim të personit të paraburgosur.

Rregulla 57**Rishikimi dhe rivlerësimi i mbajtjes në paraburgim**

- (1) ¹Pas caktimit të gjykatësit të procedurës paraprake sipas nenit 33(1)(a) të Ligjit, dhe deri sa aktgjykimi të bëhet i formës së prerë, trupi gjykues i angazhuar me çështjen vlerëson vendimin mbi mbajtjen në paraburgim, pasi të kenë kaluar dy (2) muaj nga vendimi i fundit në lidhje me paraburgimin, në përputhje me nenin 41(10), (11) dhe (12) të Ligjit. ²Trupi gjykues siguron që një person të mos mbahet në paraburgim për një periudhë të tejzgatur deri në hapjen e çështjes kundër atij personi. ³Në rast se Prokurori i Specializuar shkakton vonesë të papërligjur, trupi gjykues, pasi t'i ketë dëgjuar parashtrimet e palëve, mund ta lirojë personin e paraburgosur në bazë të kushteve që i gjykon të përshtatshme.
- (2) Në rast të zbulimit të fakteve të reja të cilat e bëjnë të paligjshme mbajtjen e mëtejshme në paraburgim të një personi, personi në fjalë mund t'i kërkojë trupit gjykues që ka nxjerrë vendimin për mbajtjen e tij në paraburgim, rishqyrtimin e vendimit përkatës.
- (3) Në qoftë se ekzistojnë arsye të mjaftueshme të cilat përligjin lirimin e personit të paraburgosur, në varësi të nenit 41(6) të Ligjit, me kërkesë të personit të paraburgosur ose *proprio motu*, dhe pasi t'i ketë dëgjuar parashtrimet e palëve, trupi gjykues mund të urdhërojë lirimin e personit në cilëndo fazë të procesit gjyqësor.
- (4) ¹Në bazë të një kërkesë sipas paragrafëve (2) ose (3), trupi gjykues mund të përcaktojë kushte të lirimit që i gjykon të përshtatshme për të garantuar praninë e të akuzuarit gjatë procesit gjyqësor, në përputhje me nenin 41(12) të Ligjit. ²Trupi gjykues dëgjon parashtrimet e një shteti të tretë në qoftë se personi i paraburgosur kërkon të lirohet në territorin e atij shteti. ³Personi i paraburgosur nuk lirohet në territorin e shtetit të tretë pa pëlqimin e atij shteti. ⁴Vendimi merret sa më shpejt që të jetë e mundur dhe jo më vonë se tri (3) ditë pas parashtrimit të fundit.

Rregulla 58**Apelimi i ndërmjetëm i mbajtjes në paraburgim**

- (1) Vendimet në lidhje me mbajtjen në paraburgim mund të apelojnë në Gjykatën e Apelit, në përputhje me nenin 45(2) të Ligjit.
- (2) Në lidhje me apelimin e një vendimi për mbajtjen e një personi në paraburgim, zbatohet rregulla 170.
- (3) ¹Apeli i vendimit për lirimin e një personi dorëzohet brenda dy ditësh (2) pas daljes së një vendimi të tillë. Përgjigjja ndaj apelit dorëzohet brenda një (1) dite pas apelit. ²Prokurori i Specializuar nuk ka të drejtë të paraqesë kundërpërgjigje.
- (4) ¹Apeli nuk ka efekt pezullues, përveç nëse urdhërohet ndryshe prej panelit të Gjykatës së Apelit si masë e jashtëzakonshme në lidhje me një kërkesë për pezullim të paraqitur me apelin. ²Në rast se Prokurori i Specializuar kërkon efekt pezullues të një vendimi për lirimin e një personi, personi në fjalë nuk mund të lirohet përveç se dhe deri në një vendim të panelit të Gjykatës së Apelit për refuzimin e kërkesës për efekt pezullues. ³Paneli i Gjykatës së Apelit merr vendimin mbi kërkesën për efekt pezullues brenda pesë (5) ditësh pas parashtrimit të fundit.

Rregulla 59**Mbrojtja e parimit të ligjshmërisë kundrejt vendimeve të formës së prerë mbi mbajtjen në paraburgim**

¹Në pajtim me nenin 48(6) të Ligjit, personi i paraburgosur mund të kërkojë mbrojtjen e ligjshmërisë kundrejt vendimeve të formës së prerë ku urdhërohet ose zgjatet mbajtja në paraburgim sipas rregullës 58. ²Një kërkesë e tillë i paraqitet Kryetarit, në përputhje me rregullën 193.

Rregulla 60**Vdekja e një personi të paraburgosur**

¹Në rast të vdekjes së një personi të paraburgosur nën juridiksionin e Dhomave të Specializuara, Administratori përcakton shkakun e vdekjes dhe për këtë qëllim mund të urdhërojë hetimet dhe ekzaminimet e nevojshme. ²Në qoftë se konstatohet se vdekja nuk ka ndodhur për shkaqe natyrore, Administratori ia kalon çështjen autoriteteve kompetente vendore.

Kapitulli 5

Dispozita lidhur me fazat e ndryshme të procedurës

Pjesa I: Dispozita të përgjithshme

Rregulla 61

Mbikëqyrja e procedurës në sallën e gjyqit

- (1) ¹Kryetari i trupit gjykues mbikëqyr mbajtjen e rregullit në sallën e gjyqit dhe në galerinë për publikun, si edhe sjelljen e të gjithë pjesëmarrësve. ²Kryetari i trupit gjykues merr masat e nevojshme, ndër të tjera përjashtimin e një personi, me qëllim mbrojtjen e të drejtës së të akuzuarit për gjykim të drejtë dhe publik, ose ruajtjen e dinjitetit dhe normave të mirësjelljes gjatë procesit.
- (2) ¹Kryetari i trupit gjykues mund të urdhërojë largimin e përkohshëm të të akuzuarit nga salla e gjyqit dhe vijimin e procedurave në mungesë të të akuzuarit, në qoftë se i akuzuari ka vazhduar me sjellje rendprishëse edhe pasi i është tërhequr vëmendja se një sjellje e tillë mund të ketë për pasojë largimin nga salla e gjyqit, me kusht që interesat e të akuzuarit të jenë të përfaqësuara prej Mbrojtësit të Specializuar. ²Në një rast të tillë, trupi gjykues i mundëson të akuzuarit që ta ndjekë procedurën dhe t'i japë udhëzime Mbrojtësit të Specializuar nga jashtë sallës së gjyqit.
- (3) Kryetari i trupit gjykues mund të urdhërojë kontrollimin e cilitdo personi të pranishëm në sallën e gjyqit dhe në galerinë për publikun, në qoftë se është e nevojshme për arsye sigurie, si edhe për administrimin e duhur të drejtësisë.

Rregulla 62

Detyrat e Prokurorit të Specializuar

¹Gjatë ushtrimit të detyrave të veta, Prokurori i Specializuar kontribuon në përcaktimin e të vërtetës prej Dhomave të Specializuara. ²Prokurori i Specializuar merr masat për mbrojtjen dhe respektimin e duhur të viktimave dhe dëshmitarëve, si edhe të të drejtave themelore të të dyshuarve dhe të akuzuarve.

Rregulla 63

Shpërdorimi i procedurave

- (1) Në qoftë se trupi gjykues gjykon se Mbrojtësi, ose Përfaqësuesi i Prokurorit të Specializuar është fyes apo shpërdorues, ose ndryshe pengon zhvillimin e duhur të procedurës, ose në qoftë se Mbrojtësi ose Përfaqësuesi i Prokurorit të Specializuar nuk i përmbush normat e etikës profesionale në ushtrimin e detyrave, pasi t'i ketë tërhequr vërejtjen e duhur, trupi gjykues mund:
 - (a) të shqiptojë dënim me gjobë deri në pesëqind (500) euro për çdo shpërdorim sipas këtij paragrafi;
 - (b) të pezullojë të drejtën e Mbrojtësit ose Përfaqësuesit të Prokurorit të Specializuar për t'u paraqitur para trupit gjykues; ose

- (c) pasi t'i ketë dhënë Mbrojtësit dhe, kur është e zbatueshme, të akuzuarit, mundësinë për të bërë parashtrime, të marrë vendimin për heqjen e të drejtës së Mbrojtësit për të përfaqësuar një të dyshuar ose të akuzuar, apo viktimat pjesëmarrëse në procedurat para Dhomave të Specializuara. Në një rast të tillë merren masat e nevojshme për zëvendësimin e Mbrojtësit, për të garantuar mosçenimin e të drejtës së të akuzuarit për gjykim të drejtë dhe të shpejtë, dhe kur është e zbatueshme, e të drejtave të viktimave pjesëmarrëse në procedurë.
- (2) ¹Vendimin e marrë sipas paragrafit (1), trupi gjykues ia komunikon Administratorit, në qoftë se Mbrojtësi në fjalë është caktuar prej Administratorit, ose kur është e zbatueshme, Prokurorit të Specializuar. ²Sjelljen kundërvajtëse të një Mbrojtësi trupi gjykues mund t'ia raportojë komisionit disiplinor të paraparë në Kodin e Etikës Profesionale, dhe cilitdo organi kompetent të shtetit ku Mbrojtësi apo Përfaqësuesi i Prokurorit të Specializuar ushtron profesionin si avokat.
- (3) Kur vendimi sipas paragrafit (1) është në lidhje me Prokurorin e Specializuar, trupi gjykues njofton Kryetarin, dhe Kryetari mund të informojë Autoritetin Emërues.

Rregulla 64**Ndihma joefektive e Mbrojtësit**

¹Pasi t'i ketë dhënë Mbrojtësit, dhe, kur është e zbatueshme, të akuzuarit, mundësinë për të bërë parashtrime, trupi gjykues mund të vendosë t'i heqë Mbrojtësit të drejtën e përfaqësimit të një të dyshuari apo të akuzuari, ose të viktimave pjesëmarrëse në procedurat para Dhomave të Specializuara, me arsyetimin se përfaqësimi nuk është efektiv aq sa duhet për plotësimin e parimit të barazisë së palëve. ²Në një rast të tillë, merren masat e parapara në rregullën 63(1)(c).

Rregulla 65**Mospërmbushja e urdhrorit të një trupi gjykues**

- (1) Në varësi të nenit 42(7) dhe (8) të Ligjit, kur një person që nuk është Mbrojtësi, qëllimisht refuzon përmbushjen e një urdhri të një trupi gjykues i cili shoqërohet me paralajmërim për masa ndëshkimore në rast shkeljeje, pasi ta ketë dëgjuar personin, kryetari i trupit gjykues mund të urdhërojë si vijon:
- (a) moslejimin e pranisë së atij personi në seancat në sallën e gjyqit, për një periudhë jo më të gjatë se tridhjetë (30) ditë;
 - (b) kur është e zbatueshme moslejimin e ushtrimit të detyrave prej atij personi para trupit gjykues për një periudhë jo më të gjatë se tridhjetë (30) ditë; ose
 - (c) në rast sjelljeje kundërvajtëse të rëndë, caktimin e një dënimi me gjobë deri në pesëqind (500) euro për çdo rast të mospërmbushjes së urdhrorit sipas këtij paragrafi.
- (2) Në qoftë se e gjykon të përshtatshme zgjatjen e periudhës së moslejimit, kryetari i trupit gjykues ia referon çështjen trupit gjykues i cili mund të mbajë seancë për të vendosur nëse do të urdhërojë zgjatjen e periudhës së moslejimit apo moslejim të përhershëm.

Rregulla 66**Mjetet shtrënguese**

¹Brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara, mjetet shtrënguese, si për shembull prangat, përdoren vetëm me urdhër të Administratorit, si masë për parandalimin e arratisjes apo të vetëlëndimit, lëndimit të të tjerëve apo dëmeve materiale të mëdha. ²Të akuzuarit i hiqen mjetet shtrënguese para hyrjes në sallë të gjyqit për t'u paraqitur para trupit gjykues, përveç nëse trupi gjykues ka autorizuar mbajtjen e prangave edhe brenda sallës së gjyqit.

Rregulla 67***Amicus Curiae***

- (1) Në cilëndo fazë të procesit, një panel mund të ftojë ose të lejojë autoritetet e Kosovës, një shtet të tretë, organizatë, ose person, të paraqesin parashtrime në cilësi të *amicus curiae* në lidhje me cilëndo çështje që paneli e gjykon të përshtatshme dhe që mund të ndihmojë marrjen e vendimit të duhur për çështjen gjyqësore.
- (2) Parashtrimi i çfarëdo konstatimi nga *amicus curiae* nuk shkakton vonesë të procedurës gjyqësore.
- (3) ¹Parashtrimet me shkrim sipas paragrafit (1) i dorëzohen Administratorit i cili i shpërndan në përputhje me urdhrin e panelit. ²Me miratimin e panelit, palët dhe Mbrojtësi i Viktimave mund t'u përgjigjen këtyre parashtrimeve brenda shtatë (7) ditësh prej dorëzimit të tyre.

Rregulla 68**Mungesa e të akuzuarit**

- (1) I akuzuari gjykohet duke qenë i pranishëm në gjyq, përveç se kur përcaktohet ndryshe në Ligj dhe Rregullore.
- (2) Në qoftë se është në gjendje të lirë dhe ka qenë i pranishëm në seancën e paraqitjes së parë, i akuzuari, me lejen e trupit gjykues, mund të ndjekë vijimin e gjykimit nëpërmjet videokonferencës, me kusht që Mbrojtësi i Specializuar i të akuzuarit të jetë i pranishëm në seancë.
- (3) ¹Në qoftë se është në gjendje të lirë, dhe pa lejen e trupit gjykues apo pa ndonjë arsye të vlefshme nuk paraqitet në një seancë gjyqësore ku është thirrur sipas rregullave të jetë i pranishëm fizikisht apo të marrë pjesë nëpërmjet videokonferencës, trupi gjykues shtyn seancën, lëshon fletarrestim, urdhëron paraburgimin e të akuzuarit dhe cakton datën e vijimit të seancës. ²Pas arrestimit, i akuzuari nxirret para trupit gjykues i cili merr vendimin për vijimin e mbajtjes në paraburgim në përputhje me rregullën 56. ³Rregulla 57 deri në rregullën 59 zbatohen *mutatis mutandis*.
- (4) Kur i akuzuari ndodhet në paraburgim dhe refuzon të paraqitet para trupit gjykues, trupi gjykues mund të urdhërojë kryerjen e procedurës gjyqësore pa praninë e të akuzuarit, në qoftë se është bindur se:
 - (a) i akuzuari ka bërë paraqitjen e parë;

- (b) i akuzuari është informuar në përputhje me rregullat dhe me kohë për detyrimin e të qenit i pranishëm në gjyq;
 - (c) i akuzuari vullnetarisht dhe qartësisht ka hequr dorë nga e drejta për t'u gjykuar duke qenë i pranishëm në gjyq, ose ka humbur këtë të drejtë;
 - (d) interesat e të akuzuarit përfaqësohen nga Mbrojtësi i Specializuar i cili është fizikisht i pranishëm në seancat gjyqësore; dhe
 - (e) trupi gjykues gjykon se nuk është e domosdoshme që i akuzuari të jetë i pranishëm në një seancë konkrete.
- (5) ¹Në çdo kohë, i akuzuari lejohet të kthehet dhe të jetë i pranishëm në procedurën gjyqësore. ²Për çdo javë, Administratori verifikon vendimin e të akuzuarit për të mos qenë i pranishëm në gjykim dhe heqjen dorë nga e drejta e të qenit i pranishëm në gjykim dhe në lidhje me këtë informon trupin gjykues.
- (6) Kur i akuzuari është i paraburgosur dhe fizikisht i paaftë për të qenë i pranishëm në gjykim, trupi gjykues i mundëson të akuzuarit që të ndjekë procedurën gjyqësore dhe t'i japë udhëzimet e veta Mbrojtësit të Specializuar nga jashtë sallës së gjyqit.

Rregulla 69

Ekzaminimi mjekësor i të dyshuarit ose i të akuzuarit

- (1) ¹Me kërkesë të një pale ose *proprio motu*, trupi gjykues mund të urdhërojë ekzaminimin mjekësor, psikiatrik, ose psikologjik të të dyshuarit apo të të akuzuarit. ²Në një rast të tillë, trupi gjykues thërret një ekspert për ta ndihmuar në marrjen e vendimit.
- (2) ¹Në qoftë se trupi gjykues gjykon se i akuzuari nuk është i aftë të dalë në gjyq, procedura gjyqësore shtyhet. ²Urdhri për shtyrjen e procedurës gjyqësore rivlerësohet çdo katër (4) muaj, ose më herët, me kërkesë të një pale ose *proprio motu*, në qoftë se për këtë ekzistojnë arsye bindëse. ³Në qoftë se është e nevojshme, trupi gjykues mund të urdhërojë ekzaminime të mëtejshme mjekësore të të dyshuarit, ose të akuzuarit.

Rregulla 70

Vdekja e të akuzuarit

¹Në rast të vdekjes së një të akuzuari, trupi gjykues pushon procesin kundër të akuzuarit. ²Një vendim i tillë nuk cenon mjetet juridike që mund të kërkohen në cilindo sistem gjyqësor vendor.

Rregulla 71**Masat e përkohshme për ruajtjen e kapitalit**

- (1) ¹Pas lëshimit të një urdhërarresti apo fletarrestimi, ose pas konfirmimit të një aktakuze, si dhe duke u kushtuar vëmendjen dhe kujdesin e duhur të drejtave të të dyshuarit apo të të akuzuarit, një trup gjykues mund t'i urdhërojë autoritetet e Kosovës apo t'u kërkojë shteteve të treta marrjen e masave të përkohshme për ruajtjen e pronës, fitimeve dhe kapitalit të një të dyshuari apo të akuzuari, që janë përdorur për kryerjen e një vepre penale, apo që janë përfituar prej kryerjes së një vepre penale. ²Një urdhër i tillë nuk cenon të drejtat e palëve të treta *bona fide*.
- (2) ¹Nuk është e domosdoshme që i dyshuari apo i akuzuari të informohet për një urdhër të tillë, përveç nëse trupi gjykuesi gjykon se në rrethanat konkrete të çështjes, informimi i të dyshuarit apo të akuzuarit nuk kërcënon efektivitetin e masave të kërkuara. ²Në rrethana të tilla, Administratori e njofton të dyshuarin apo të akuzuarin, dhe sipas rrethanave, cilindo person ose shtet të tretë të interesuar për procedurën.
- (3) Në qoftë se një urdhër i tillë nxirret pa njoftim paraprak, menjëherë pas zbatimit të masave të urdhëruara, trupi gjykuesi i kërkon Administratorit që ta informojë të dyshuarin apo të akuzuarin, dhe, sipas rrethanave, personat ose shtetet e treta të interesuara dhe t'i ftojë të paraqesin parashtrimet e tyre në qoftë se urdhri përkatës duhet të shfuqizohet ose të ndryshohet.

Rregulla 72**Procedura e përsheptuar**

- (1) Në qoftë se konfirmon një aktakuzë në lidhje me një vepër penale sipas nenit 15(2) të Ligjit, me qëllim përsheptimin e procedurës, gjykatësi i procedurës paraprake mund t'ia dorëzojë dosjen e çështjes një trupi gjykues në përputhje me nenin 25(2) të Ligjit, menjëherë pas daljes së vendimeve në lidhje me mocionet paraprake, pavarësisht prej rregullës 98(1).
- (2) Çdo trup gjykues i caktuar në një çështje sipas nenit 15(2) të Ligjit, mund t'i shkurtojë afatet dhe të marrë çfarëdo mase tjetër që e gjykon të nevojshme për përsheptimin e procedurës duke i kushtuar vëmendjen dhe kujdesin e duhur të drejtës së të akuzuarit për gjykim të drejtë.
- (3) ¹Përveç nëse paneli i Gjykatës së Apelit urdhëron ndryshe, apelimet e një aktgjykimi të një trupi gjykues sipas nenit 15(2) të Ligjit trajtohen në mënyrë të përsheptuar, në bazë të dosjes së çështjes. ²Vendimet mbi apelimet të tilla mund të merren tërësisht mbi bazën e parashtrimeve me shkrim.
- (4) Kjo rregull nuk cenon kryerjen e shpejtë të procedurave të tjera gjyqësore para Dhomave të Specializuara.

Pjesa II: Vendi i zhvillimit të procedurës

Rregulla 73

Veprimtaria gjyqësore jashtë selisë së Dhomave të Specializuara

¹Në përputhje me nenin 26(2) të Ligjit, me autorizimin e Kryetarit, një panel mund t'i ushtrojë funksionet e veta në një vend tjetër, jashtë selisë së Dhomave të Specializuara. ²Duke i kushtuar vëmendjen dhe kujdesin e duhur konfidencialitetit dhe sigurisë, mund të përdoret lidhja nëpërmjet videokonferencës, posta elektronike, si edhe mënyra të tjera të komunikimit elektronik.

Rregulla 74

Vizitat në terren dhe paraqitja e dëshmitarëve në gjyq jashtë selisë së Dhomave të Specializuara

(1) ¹Pasi t'i ketë dëgjuar palët dhe, nëse është e nevojshme, pjesëmarrësit e tjerë në procedura, një trup gjykues mund të vendosë që, në rrethana të jashtëzakonshme dhe nëse lipset për administrimin e duhur të drejtësisë, t'i ushtrojë funksionet e veta në një vend konkret, jashtë selisë së Dhomave të Specializuara, në përputhje me nenin 3(6) të Ligjit, për sa vijon:

- (a) për të vizituar vendin e krimit; dhe
- (b) për shkak të pamundësisë së dëshmitarit për t'u paraqitur në gjyq në selinë e Dhomave të Specializuara për arsye të një sëmundjeje të rëndë ose rrethanave të tjera penguese të cilat pamundësojnë paraqitjen e tij në gjyq në selinë e Dhomave të Specializuara, në qoftë se dëshmia e këtij dëshmitari nuk është marrë më herët.

²Trupi gjykues gjithashtu përcakton nëse në rrethanat përkatëse do të ishin më të përshtatshme mënyra të tjera të dhënies së dëshmisë, të pranisë në seanca gjyqësore, ose të vizitave në terren.

(2) ¹Para marrjes së një vendimi sipas paragrafit (1), trup gjykuesi këshillohet me Administratorin në lidhje me sigurinë, shpenzimet dhe konfidencialitetin. ²Në qoftë se vendi i përcaktuar në paragrafin(1) ndodhet në një shtet të tretë, Administratori këshillohet me shtetin në fjalë dhe, në qoftë se është e nevojshme, bën marrëveshjet e nevojshme në pajtim me nenin 4 të Ligjit.

(3) Në qoftë se marrëveshjet e tilla janë të mundshme, Kryetari nxjerr një vendim administrativ për mundësimin e zhvendosjes.

(4) ¹Në këshillim me Kryetarin, Administratori nxjerr Udhëzim Praktik për Kryerjen e Vizitave në Terren, me qëllim planifikimin e vizitave në terren dhe garantimin e ndjekjes së praktikave të njësuara. ²Në lidhje me këtë, Kryetari mund të këshillohet me Zyrën e Prokurorit të Specializuar dhe me Organin Përfaqësues të Pavarur të Mbrojtësve të Specializuar.

Pjesa III: Parashtrimet dhe vendimet**Rregulla 75****Mocionet dhe parashtrimet e tjera**

- (1) Prokurori i Specializuar dhe Administratori, si edhe cilado palë pas paraqitjes së parë të të Akuzuarit, mund t'i parashtrojnë panelit përkatës kërkesë për një mjet ligjor, përveç nëse parashihet ndryshe në Rregullore.
- (2) ¹Përgjithësisht dhe sipas gjykimit të panelit, parashtrimet e palëve dhe pjesëmarrësve në procedura, urdhrat dhe vendimet në lidhje me çështje rutinore apo çështje të cilat nga aspekti faktik dhe juridik nuk janë aspak, ose janë fare pak komplekse, bëhen ose paraqiten gojarisht. ²Urdhra dhe vendime të tilla shoqërohen ose pasohen me arsyetim me shkrim kur kjo është e nevojshme për sqarimin ose zbatimin e tyre. ³Administratori dokumenton çdo urdhër ose vendim të dhënë gojarisht.
- (3) Pa cenuar paragrafin (2) dhe në qoftë se nuk përcaktohet ndryshe me një urdhër ose në Rregullore, parashtrimet me shkrim të palëve gjatë procedurave gjyqësore nuk pasohen me argumentime gojore.
- (4) Në qoftë se gjykon se një parashtrim është qëllimkeq ose cenon të drejtat ose procesin, një panel mund të urdhërojë Administratorin që të pezullojë ose të ulë pagesën e tarifës përkatëse të Mbrojtësit për atë parashtrim, ose të informojë Prokurorin e Specializuar në lidhje me parashtrime të tilla të Përfaqësuesit të Prokurorit të Specializuar, sipas rastit.
- (5) ¹Palët dhe Mbrojtësi i Viktimave nuk kanë të drejtë të paraqesin mocion për referim sipas nenit 49(4) të Ligjit, dhe mocionet e paraqitura për këtë qëllim nuk do të merren në shqyrtim. ²Kjo nuk e pengon panelin që të bëjë referim në përputhje me nenin 49(4) të Ligjit, e as të akuzuarin ose Mbrojtësin e Viktimave që të bëjnë referime në përputhje me nenin 49(3) të Ligjit.

Rregulla 76**Afatet për dorëzimin e parashtrimeve**

¹Përveç nëse përcaktohet ndryshe në Rregullore, përgjigja ndaj një mocioni dorëzohet brenda dhjetë (10) ditësh prej dorëzimit të mocionit, kurse kundërpërgjigja ndaj përgjigjes, në qoftë se ka një të tillë, dorëzohet brenda pesë (5) ditësh prej dorëzimit të përgjigjes. ²Trupi gjykues merr në shqyrtim kundërpërgjigjen ose pjesë të saj vetëm nëse kanë të bëjnë me çështje të reja që dalin nga përgjigja. ³Kërkesa për zgjatje të afatit paraqitet në kohë, për t'i lënë trupit gjykues kohë të mjaftueshme për marrjen e vendimit në lidhje me kërkesën para skadimit të afatit përkatës.

Rregulla 77**Apelimet e ndërmjetme me leje të trupit gjykues**

- (1) Në rastet kur një palë kërkon të apelojë vendimin e një trupi gjykues që nuk është i apelueshëm sipas Ligjit dhe Rregullores, pala në fjalë i parashtron kërkesë për leje për apelim të ndërmjetëm

trupit gjykues që ka nxjerrë vendimin e kontestuar, brenda shtatë (7) ditësh prej daljes së vendimit.

- (2) Trupi gjykues miraton lejen në qoftë se vendimi lidhet me një çështje që do të ndikonte ndjeshëm në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit, ose në rezultatin e gjykimit, ndër të tjera, në qoftë se mjetet e përshtatshme juridike praktikisht nuk do të mund të miratoheshin pas mbylljes së çështjes që gjykohet dhe për të cilën, një vendim i menjëhershëm nga ana e panelit të Gjykatës së Apelit mund të kontribuojë thelbësisht në procesin gjyqësor.
- (3) ¹Trupi gjykues nxjerr vendim me arsyetim brenda shtatë (7) ditësh prej parashtrimit të fundit të palëve apo, kur është e zbatueshme, Mbrojtësit të Viktimave, dhe identifikon çështjen apo çështjet, nëse ka të tilla, lidhur me të cilën apo të cilat miratohet leja. ²Në rast se trupi gjykues nuk nxjerr vendimin brenda afatit të paraparë, leja për apelim konsiderohet e miratuar.

Rregulla 78

Kuvendimet për marrjen e vendimit

- (1) ¹Kuvendimet e një paneli për marrjen e një vendimi zhvillohen privatisht dhe janë rreptësisht konfidenciale. ²Të pranishëm gjatë kuvendimeve mund të jenë ndihmësit e gjykatësve.
- (2) ¹Secili gjykatës paraqet mendimin dhe përfundimet e veta në lidhje me secilën pikë që shqyrtohet gjatë kuvendimeve, si edhe bën të gjitha përpjekjet për shkëmbim paraprak të versionit me shkrim të mendimeve të veta, para daljes së një vendimi apo aktgjykimi. ²Gjykatësit në përbërje të një paneli bëjnë të gjitha përpjekjet për arritjen e unanimitetit në marrjen e vendimeve. ³Në qoftë se nuk arrihet unanimitet, vendimi ose aktgjykimi i arsyetuar jepet nga shumica e gjykatësve të panelit. ⁴Vendimit ose aktgjykimit mund t'i bashkëngjiten mendime të veçuara ose mospajtuese.

Rregulla 79

Kompetenca për rishqyrtimin e vendimeve

- (1) ¹Në rrethana të jashtëzakonshme dhe kur është vërtetuar se një arsyetim është qartësisht i gabuar, apo kur rishqyrtimi është i domosdoshëm për të shmangur padrejtësinë, me kërkesë të një pale, ose, kur është e zbatueshme, të Mbrojtësit të Viktimave, apo *proprio motu*, dhe pasi t'i ketë dëgjuar palët, një panel mund t'i rishqyrtojë vendimet e veta. ²Aktgjykimet nuk janë të rishqyrtueshme.
- (2) Kërkesa për rishqyrtimin e një vendimi nuk e pezullon afatin e paraparë për një mjet juridik.

Pjesa IV: Mbrojtja e dëshmitarëve dhe viktimave**Rregulla 80****Masat mbrojtëse**

- (1) Bazuar në nenin 23(1) të Ligjit, një panel, *proprio motu* ose me kërkesë të një pale, të Zyrës për Mbrojtjen dhe Mbështetjen e Dëshmitarëve, të një dëshmitari ose, kur është e zbatueshme, të Mbrojtësit të Viktimave, mund të urdhërojë masa mbrojtëse për mbrojtjen, sigurinë, mirëqenien fizike dhe mendore, dinjitetin dhe privatësinë e dëshmitarëve, viktimave pjesëmarrëse në procedura gjyqësore dhe të personave të tjerë të rrezikuar për shkak të dëshmisë së një dëshmitari, me kusht që masat të jenë në pajtim me të drejtat e të akuzuarit.
- (2) Para nxjerrjes së një urdhri të tillë, trupi gjykues kërkon pëlqimin e personit për të cilin kërkohen masa mbrojtëse.
- (3) Mocioni për masa mbrojtëse, ose pjesë të tij, si edhe përgjigjet ndaj mocionit, mund të dorëzohen si konfidenciale dhe të shënohen *ex parte* dhe kanë këtë status klasifikimi deri në një urdhër tjetër të trupit gjykues, ose deri në riklasifikimin e tyre në përputhje me Kapitullin 5, Pjesa IV.
- (4) Trupi gjykues mund të mbajë seancë *in camera* për marrjen e vendimit nëse do të urdhërojë, ndër të tjera:
 - (a) masa për parandalimin e nxjerrjes publike të identitetit ose vendndodhjes së një dëshmitari, viktime pjesëmarrëse në procedurat gjyqësore, ose të një personi të lidhur familjarisht ose në një mënyrë tjetër me dëshmitarin ose viktimën, të tilla si:
 - (i) fshirja e emrave dhe të dhënave që zbulojnë identitetin e një personi nga dokumentacioni publik i Dhomave të Specializuara;
 - (ii) mosnxjerrja e dokumentacionit që identifikon dëshmitarin, ose viktimën pjesëmarrëse në procedurë gjyqësore;
 - (iii) mosnxjerrja e dokumentacionit, materialit apo informacionit që identifikon dëshmitarin ose mbi bazën e të cilit Mbrojtësi i Viktimave, ose viktimat pjesëmarrëse në procedura, mund ta identifikojnë dëshmitarin;
 - (iv) dhënia e dëshmisë përmes pajisjeve për ndryshimin e pamjes ose zërit;
 - (v) dhënia e dëshmisë përmes transmetimit të brendshëm me dy kamera sigurie; ose
 - (vi) caktimi i një pseudonimi;
 - (b) seanca private ose me dyer të mbyllura, në përputhje me rregullën 120;
 - (c) masa të posaçme për t'ua lehtësuar dhënien e dëshmisë dëshmitarëve të traumatizuar ose të cenueshëm, duke përfshirë viktimat e dhunës seksuale dhe dhunës mbi bazë gjinore, dëshmitarët e moshuar apo ata të moshës nën 18 vjeç, ndër të cilat:
 - (i) mundësimi i pranisë së një psikologu, këshillëdhënësi, apo anëtari të afërt të familjes gjatë dhënies së dëshmisë prej dëshmitarit;
 - (ii) transmetim i brendshëm me një kamerë të sigurisë;

- (iii) të akuzuarit i pamundësohet të shohë dëshmitarin drejtpërsëdrejti; ose
- (iv) dorëzimi paraprak i pyetjeve të cilat përcillen nëpërmjet trupit gjykues;
- (d) mosnxjerrja prej Mbrojtësit të Specializuar për të Akuzuarin e materialit apo informacionit që mund të çojë në zbulimin e identitetit të dëshmitarit apo viktimës pjesëmarrëse në procedurë gjyqësore; ose
- (e) në rrethana të jashtëzakonshme, dhe në varësi të garancive mbrojtëse të nevojshme:
 - (i) mosnxjerrja për palët e materialit apo informacionit që mund të çojë në zbulimin e identitetit të dëshmitarit apo viktimës pjesëmarrëse në procedurë gjyqësore; ose
 - (ii) anonimitet i plotë i dëshmitarit.
- (5) Paneli mund të urdhërojë cilindo kombinim të masave të mësipërme, ose masa të tjera të përshtatshme për rrethanat konkrete, me qëllim mbrojtjen e dëshmitarëve, ose të viktimave pjesëmarrëse në procedura gjyqësore.
- (6) Në pajtim me nenin 23(2) të Ligjit, përgjithësisht masat e përcaktuara në paragrafët 4)(a)(i) dhe (ii) u mundësohen të gjithë dëshmitarëve të cenueshëm, ndër të tjerë viktimave të dhunës seksuale apo të dhunës mbi bazë gjinore, si edhe personave nën moshën 18 vjeç, me përjashtim kur ata i refuzojnë shprehimisht këto masa.
- (7) Kur urdhëron caktimin e masave mbrojtëse, trupi gjykues vendos nëse transkripti i procedurës gjyqësore lidhur me dëshminë e dëshmitarit të mbrojtur do të mund të lejohet të përdoret në procese të tjera para Dhomave të Specializuara ose në një juridiksion tjetër dhe cakton masat përkatëse.
- (8) Para dhënies së dëshmisë prej një dëshmitari, Zyra për Mbrojtjen dhe Mbështetjen e Dëshmitarëve informon dëshmitarin për sa vijon:
 - (a) rrezikun e zbulimit të paqëllimshëm ose të paligjshëm të identitetit apo dëshmisë së dëshmitarit, pavarësisht prej masave mbrojtëse të urdhëruara; dhe
 - (b) mundësinë e ndryshimit të masave mbrojtëse në përputhje me rregullën 81.

Rregulla 81

Ndryshimi i masave mbrojtëse

- (1) Kur një trup gjykues ka urdhëruar masa mbrojtëse në lidhje me një dëshmitar, viktimë pjesëmarrëse në procedurë, ose persona të tjerë të rrezikuar për shkak të dëshmisë së dhënë prej një dëshmitari, këto masa:
 - (a) mbeten në fuqi *mutatis mutandis* në çfarëdo procesi të mëpasshëm para Dhomave të Specializuara ose në një juridiksion tjetër, veçse dhe derisa të ndryshohen në përputhje me procedurën e përcaktuar në këtë rregull; dhe
 - (b) nuk e pengojnë Prokurorin e Specializuar që të përmbushë çfarëdo detyrimi për nxjerrje materiali sipas Rregullores në një proces të mëpasshëm, me kusht që Prokurori i

Specializuar të informojë palën mbrojtëse të cilës po i bëhet i njohur materiali, për llojin e masave mbrojtëse të urdhëruara dhe detyrimin për respektimin e tyre.

- (2) Një palë në procesin fillestar ose të mëpasshëm para Dhomave të Specializuara, ose Administratori, që kërkon ndryshimin e masave mbrojtëse të urdhëruara, duhet:
- (a) t'i bëjë kërkesë trupit gjykues i cili ka urdhëruar masat mbrojtëse; ose
 - (b) në qoftë se ai trup gjykues nuk është më i angazhuar me procesin fillestar, trupit gjykues të angazhuar me procesin e mëpasshëm.
- (3) ¹Një gjykatës ose panel gjykatësish në një gjykatë në Kosovë apo në një shtet të tretë, ose palët në një proces gjyqësor në një gjykatë në Kosovë apo në një shtet të tretë, me autorizimin e autoritetit prokurorial ose gjyqësor përkatës, e një viktime pjesëmarrëse në procedura gjyqësore apo një dëshmitari për të cilin Dhomat e Specializuara kanë urdhëruar masa mbrojtëse, mund të kërkojnë ndryshimin e masave mbrojtëse nëpërmjet një kërkesë drejtuar Kryetarit. ²Në këtë rast, Kryetari:
- (a) ia përcjell kërkesën trupit gjykues që ka urdhëruar masat mbrojtëse; ose
 - (b) cakton një gjykatës të vetëm për të marrë vendim në lidhje me kërkesën, në qoftë se trupi gjykues përkatës nuk është më i angazhuar.
- (4) Para se të marrë vendimin në lidhje me kërkesën e paraqitur sipas kësaj rregulle, trupi gjykues ose gjykatësi i vetëm, bën të gjitha përpjekjet për marrjen e të gjithë informacionit përkatës prej procesit gjyqësor gjatë të cilit janë urdhëruar masat mbrojtëse, dhe këshillohet me gjykatësin që ka urdhëruar masat mbrojtëse, në qoftë se gjykatësi në fjalë është ende në Regjistër.
- (5) ¹Trupi gjykues ose gjykatësi i vetëm që vendos në lidhje me kërkesën e paraqitur sipas kësaj rregulle, nëpërmjet Zyrës për Mbrojtjen dhe Mbështetjen e Dëshmitarëve sigurohet që personi i mbrojtur të ketë dhënë pëlqimin për ndryshimin e masave mbrojtëse. ²Në rast të mosdhënies së pëlqimit, ndryshimi i masave mbrojtëse mund të urdhërohet edhe *proprio motu* kur kjo përlligjet nga rrethana të ngutshme, ose kur mosndryshimi i tyre mund të ketë për pasojë dështimin e drejtësisë.
- (6) ¹Një dëshmitar, ose, kur është e zbatueshme, përfaqësuesi ligjor i dëshmitarit, mund të heqë dorë prej të gjithave, ose prej disa masave mbrojtëse që janë miratuar për të në bazë të rregullës 80, pasi të jetë informuar nga trupi gjykues, ose nga Zyra për Mbrojtjen dhe Mbështetjen e Dëshmitarëve për pasojat e heqjes dorë. ²Veprimi i lartpërmendur kryhet para një paneli, ose në formën e një deklarate me shkrim të nënshkruar nga dëshmitari dhe nga Zyra për Mbrojtjen dhe Mbështetjen e Dëshmitarëve. ³Paneli sigurohet se heqja dorë është bërë lirshëm dhe vullnetarisht.

Pjesa V: Klasifikimi**Rregulla 82****Klasifikimi i parashtrimeve të dorëzuara**

- (1) ¹Parashtrimet e dorëzuara, ose pjesë të tyre, klasifikohen si në vijim:
 - (a) Publike: mund t'i bëhen të njohura publikut;
 - (b) Konfidenciale: mund t'u bëhen të njohura vetëm palëve dhe pjesëmarrësve të autorizuar;
 - (c) Rreptësisht konfidenciale: mund t'u bëhen të njohura vetëm një numri të kufizuar personash, sikurse urdhërohet prej Dhomave të Specializuara.

²Parashtrimet konfidenciale dhe rreptësisht konfidenciale shënohen *ex parte* atëherë kur Administratori urdhërohet që të mos ua shpërndajë njërës apo më shumë palëve ose pjesëmarrësve në procedurë.
- (2) Dhomat, Administratori, palët dhe pjesëmarrësit në procedurë përpilojnë dhe mbajnë listën e personave që kanë ose kanë pasur qasje në parashtrime të klasifikuara rreptësisht konfidenciale.
- (3) ¹Për çdo parashtrim të dorëzuar me status konfidencial ose rreptësisht konfidencial, shënohet arsyeja e një klasifikimi të tillë, si dhe nëse dhe kur mund të ndryshohet statusi i parashtrimit përkatës. ²Përveç se dhe deri kur të urdhërohet ndryshe prej një trupi gjykues, parashtrimi trajtohet sipas statusit të klasifikimit që ka.
- (4) Përveçse kur trupi gjykues urdhëron ndryshe, çdo përgjigje, kundërpërgjigje apo parashtrim tjetër në lidhje me parashtrimin e parë, ka të njëjtin status klasifikimi.
- (5) ¹Në qoftë se arsyet për një klasifikim të caktuar pushojnë së ekzistuari, dorëzuesi i parashtrimit të parë i paraqet trupit gjykues kërkesë për riklasifikim. ²Gjithashtu, një trup gjykues mund të ndryshojë statusin e një parashtrimi të dorëzuar, me kërkesë të një pjesëmarrësi tjetër në procedura, apo *proprio motu*. ³Në rast kërkesë për ndryshimin e masave mbrojtëse zbatohet rregulla 81.
- (6) Nxjerrja e paautorizuar e dokumentacionit ose informacionit me status rreptësisht konfidencial dhe konfidencial, mund të rezultojë në nisjen e procedurës të paraparë në nenin 15(2) të Ligjit dhe nenin 400(1) të Kodit Penal të Kosovës për shkeljen e fshehtësisë së procedurave.

Rregulla 83**Klasifikimi i dokumentacionit të procesit gjyqësor dhe të provave**

- (1) Në çdo dokument të procesit gjyqësor dhe të provave që nuk është publik, evidentohet arsyeja e një klasifikimi të tillë, si edhe nëse dhe kur mund të ndryshohet statusi i klasifikimit të dokumentit në fjalë.
- (2) Administratori mban evidencën e afateve të caktuara për riklasifikimin e statusit të dokumenteve dhe informon trupin gjykues për mbarimin e vlefshmërisë së këtyre afateve.

- (3) Administratori nxjerr një udhëzim praktik që mundëson administrimin e duhur dhe efektiv të dokumentacionit në funksion të paragrafit (1).

Rregulla 84

Riklasifikimi i dokumentacionit të procesit gjyqësor dhe të provave

- (1) Rregullisht dhe para nxjerrjes së aktgjykimit, trupi gjykues rishikon klasifikimin e dokumentacionit të procesit gjyqësor dhe të provave, dhe, kur është e zbatueshme, urdhëron riklasifikimin e statusit të dokumentacionit përkatës.
- (2) Pasi aktgjykimi të ketë marrë formën e prerë, Kryetari mund të caktojë një gjykatës të vetëm për të rishikuar dokumentacionin e procesit gjyqësor dhe të provave, në lidhje me riklasifikimin.
- (3) Gjykatësi i vetëm mund të nxjerrë vendim në lidhje me riklasifikimin e dokumentacionit sipas paragrafit (2) pasi të ketë ndërmarrë të gjitha masat e arsyeshme për marrjen e pëlqimit të një autoriteti të Kosovës, të një shteti të tretë, subjekti, apo personi ndaj të cilit ndryshimi i statusit të dokumentit ndikon drejtpërsëdrejti.
- (4) ¹Vendimi për ndryshimin e statusit të klasifikimit të dokumentacionit sipas paragrafit (3) hyn në fuqi nëntëdhjetë (90) ditë pas dorëzimit. ²Cilido autoritet i Kosovës, shtet i tretë, subjekt, apo person ndaj të cilit ndryshimi i statusit të dokumentacionit ndikon drejtpërsëdrejti, mund të paraqesë kërkesë për rishikimin e vendimit prej Kryetarit.

Kapitulli 6

Aktakuza dhe procedura paraprake

Pjesa I: Aktakuza

Rregulla 85

Funksionet e gjykatësit të procedurës paraprake para konfirmimit të aktakuzës

- (1) Bazuar në nenin 33(1)(a) të Ligjit, Kryetari cakton një gjykatës të procedurës paraprake për kryerjen e funksioneve të përcaktuara në nenin 39 të Ligjit.
- (2) Bazuar në nenin 39 të Ligjit, gjykatësi i procedurës paraprake merr vendim të shpejtë në lidhje me kërkesat e Prokurorit të Specializuar që kanë të bëjnë me kryerjen e hetimeve.
- (3) ¹Gjykatësi i procedurës paraprake dhe Prokurori i Specializuar mund të mbajnë mbledhje gjatë hetimeve dhe para konfirmimit të aktakuzës. ²Për çdo mbledhje gjykatësi i procedurës paraprake mban një procesverbal konfidencial dhe *ex parte*, statusi i të cilit ndryshon kur nuk ekzistojnë më arsyet për statusin fillestar.
- (4) Varësisht prej rregullës 102 dhe rregullës 103, të gjitha dokumentet dhe informacioni që Prokurori i Specializuar ia paraqet gjykatësit të procedurës paraprake gjatë hetimeve, mbeten rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.
- (5) Bazuar në nenin 39(2) të Ligjit, gjykatësi i procedurës paraprake parashikon një datë për vendimin e vet, datë që në varësi të veçorive të çështjes gjyqësore, nuk është më vonë se gjashtë (6) muaj nga dorëzimi i aktakuzës dhe i materialit mbështetës.

Rregulla 86

Paraqitja, shqyrtimi dhe konfirmimi i aktakuzës

- (1) Në qoftë se gjatë një hetimi, Prokurori i Specializuar bindet se ekziston dyshim i bazuar mirë se një i dyshuar ka kryer, ose ka marrë pjesë në kryerjen e një veprë penale brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara, Prokurori i Specializuar informon Kryetarin i cili cakton një gjykatës të procedurës paraprake në pajtim me nenin 33(1)(a) të Ligjit.
- (2) Prokurori i Specializuar ia dorëzon aktakuzën në mënyrë konfidenciale dhe *ex parte* gjykatësit të procedurës paraprake për vendim bazuar në nenin 39(2) të Ligjit.
- (3) ¹Në aktakuzën e dorëzuar sipas nenit 38(4) të Ligjit jepen emri dhe të dhënat personale të të dyshuarit dhe një përshkrim i shkurtër i fakteve të çështjes dhe të veprës ose veprave penale për të cilat akuzohet i dyshuari dhe në veçanti forma e përgjegjësisë penale të pretenduar në lidhje me veprat penale të akuzuara sipas nenit 16 të Ligjit. ²Aktakuza dorëzohet së bashku me materialin mbështetës i cili ndër të tjera, përmban:
 - (a) prova mbështetëse të fakteve materiale; dhe
 - (b) një përmbledhje të detajuar ku tregohet lidhja e çdo prove me secilën akuzë, sidomos për sa u përket veprimeve të të dyshuarit në lidhje me veprën ose veprat penale të pretenduara.

- (4) ¹Gjykatësi i procedurës paraprake shqyrton materialin mbështetës në lidhje me secilën prej akuzave dhe përcakton nëse është vërtetuar një dyshim i bazuar mirë kundër të dyshuarit. ²Gjatë këtij shqyrtimi, gjykatësi i procedurës paraprake mund:
- (a) të kërkojë, ose të lejojë Prokurorin e Specializuar të dorëzojë material shtesë në mbështetje të cilësdo ose të gjitha akuzave;
 - (b) të kërkojë prej Prokurorit të Specializuar që të rishikojë aktakuzën me synimin që të japë më shumë hollësi për cilëndo prej akuzave, dhe veprimet konkrete të të dyshuarit, ose të mundësojë saktësi ligjore, ose më shumë qartësi në paraqitjen e akuzave; ose
 - (c) t'i kërkojë Prokurorit të Specializuar që të pakësojë numrin e akuzave ose të zvogëlojë kuadrin e akuzave.
- ³Për secilin prej këtyre rasteve përpilohet procesverbal me shkrim i cili përfshihet në dosjen e çështjes.
- (5) Si rezultat i këtij shqyrtimi, bazuar në nenin 39(2) të Ligjit, gjykatësi i procedurës paraprake konfirmon ose hedh poshtë tërësisht, ose pjesërisht akuzat, në një vendim të arsyetuar.
- (6) Me konfirmimin e cilësdo prej akuzave të aktakuzës:
- (a) i dyshuari bëhet i akuzuar; dhe
 - (b) gjykatësi i procedurës paraprake mund të lëshojë një fletarrestim apo një urdhërparaqitje, ose çfarëdo vendimi apo urdhri të paraparë në nenin 39(3) të Ligjit.
- (7) Mbrojtja mund të paraqesë kundërshtime ndaj një vendimi mbi aktakuzën, vetëm në bazë të rasteve të parapara në rregullën 97.
- (8) ¹Administratori ruan aktakuzën e konfirmuar nga gjykatësi i procedurës paraprake dhe përgatit kopje të legalizuara me vulën e Dhomave të Specializuara. ²Në qoftë se është e nevojshme, aktakuza përkthehet në një gjuhë që i akuzuari kupton dhe flet dhe ky përkthim i bashkëngjitet çdo kopjeje të legalizuar të aktakuzës.
- (9) Moskonfirmimi i cilësdo prej akuzave të aktakuzës nuk e pengon Prokurorin e Specializuar që më pas të dorëzojë aktakuzë të ndryshuar, ose të përfshijë të njëjtën akuzë në një aktakuzë të mbështetur nga prova të reja.
- (10) Administratori informon Kryetarin për aktakuzën e konfirmuar.

Rregulla 87

Dorëzimi i aktakuzës

- (1) ¹Pas konfirmimit të aktakuzës, pa vonesë të papërligjur dhe në varësi të paragrafit (2) dhe (4), Administratori i dorëzon personalisht aktakuzën të akuzuarit. ²Administratori i dorëzon të akuzuarit një kopje të legalizuar të aktakuzës, si edhe një përkthim të aktakuzës në një gjuhë që i akuzuari kupton dhe flet.
- (2) Në rast se është e nevojshme dhe bazuar në rregullën 202, Administratori mund të kryejë dorëzimin personal të aktakuzës nëpërmjet ndihmës së autoriteteve të Kosovës, dhe me kërkesë

të Prokurorit të Specializuar, mund të marrë masa të tjera që i gjykon të nevojshme për publikimin e aktakuzës.

- (3) Autoritetet e Kosovës të cilave u është kërkuar ndihmë për dorëzimin e aktakuzës, e informojnë Administratorin për masat që kanë marrë, brenda pesëmbëdhjetë ditësh (15) ditësh pas marrjes së urdhrorit për ndihmë.
- (4) Në qoftë se i akuzuari banon në një shtet të tretë me të cilin Dhomat e Specializuara kanë një marrëveshje bashkëpunimi bazuar në nenin 4 të Ligjit, ose i cili ka një marrëveshje për ndihmë juridike reciproke me Kosovën, dorëzimi personal i aktakuzës bëhen në pajtim me cilëndo prej këtyre marrëveshjeve dhe në prani të Administratorit.
- (5) Në qoftë se i akuzuari banon në një shtet të tretë, të ndryshëm nga shtetet që përmenden në paragrafin (4), bazuar në nenin 55(1) të Ligjit dhe rregullën 208, Administratori u dërgon një kërkesë për ndihmë dhe bashkëpunim autoriteteve kompetente të atij shteti për të mundur dorëzimin e aktakuzës duke shmangur vonesat e papërligjura.
- (6) Paraqitja e parë sipas rregullës 92 bëhet brenda shtatë (7) ditësh pasi të akuzuarit i është dorëzuar aktakuza, ose në rast se i akuzuari është arratisur brenda tri (3) ditësh pas arrestimit, cilado datë që është e mëvonshme.

Rregulla 88

Statusi publik i aktakuzës

- (1) Varësisht prej paragrafit (2), pas konfirmimit prej gjykatësit të procedurës paraprake, aktakuza bëhet publike.
- (2) ¹Në rrethana të posaçme, në rast se para konfirmimit të aktakuzës Prokurori i Specializuar paraqet arsye të vlefshme, për arsye të sigurisë, për parandalimin e arratisjes së të akuzuarit, apo të çrregullimit të procedurave, ose trazirave shoqërore, gjykatësi i procedurës paraprake, ndër të tjera, mund të urdhërojë përkohësisht mosnxjerrjen publike të aktakuzës, dokumenteve ose informacionit që ka lidhje me aktakuzën deri në një urdhër të dytë. ²Sidoqoftë, aktakuza bëhet publike, nëse është e nevojshme me redaktime, jo më vonë se paraqitja e parë e të akuzuarit.
- (3) Pavarësisht nga paragrafi (2), Prokurori i Specializuar mund t'u bëjë të njohur aktakuzën ose një pjesë të saj autoriteteve të një shteti të tretë apo subjekti tjetër, në qoftë se e gjykon të nevojshme për hetimin ose ndjekjen penale.

Rregulla 89

Bashkimi ose veçimi i akuzave

- (1) Në një aktakuzë mund të përfshihen dy ose më shumë vepra penale dhe akuza, në qoftë se:
 - (a) i njëjti i akuzuar ka marrë pjesë në veprat penale të pretenduara;
 - (b) veprat penale dhe akuzat bazohen mbi të njëjtat fakte; ose
 - (c) veprat penale dhe akuzat formojnë, ose janë pjesë e një sërë veprash penale të pretenduara të njëjta ose të ngjashme, apo veprimesh të njëjta ose të ngjashme.

- (2) Në cilëndo fazë të procedurave, pasi dëgjon palët, një panel mund të urdhërojë:
- (a) veçimin e veprave penale, ose të akuzave, në qoftë se diktohet prej rrethanave konkrete të çështjes; ose
 - (b) që personat e akuzuar bashkërisht të gjykohen veçazi për hir të një gjykimi të drejtë e të shpejtë, ose për të shmangur çfarëdo konflikti interesash që mund t'i shkaktojë padrejtësi të rëndë një të akuzuari.

Rregulla 90

Ndryshimi i aktakuzës

- (1) Në pajtim me nenet 39(8) dhe 40(7) të Ligjit, Prokurori i Specializuar mund të ndryshojë aktakuzën:
- (a) në çdo kohë para konfirmimit, pa autorizim;
 - (b) midis konfirmimit dhe caktimit të çështjes trupit gjykues, me autorizim të gjykatësit të procedurës paraprake i cili e ka konfirmuar aktakuzën, dhe pasi të jetë dëgjuar i akuzuari; dhe
 - (c) pas caktimit të çështjes trupit gjykues, me autorizim të atij trupi gjykues, pasi të jetë dëgjuar i akuzuari.
- (2) ¹Një trup gjykues mund të autorizojë ndryshimin e aktakuzës në qoftë se bindet se ndryshimi nuk shkakton padrejtësi, ose nuk është mospërputhës me të drejtat e të akuzuarit. ²Në rast se Prokurori i Specializuar kërkon të përfshijë akuza të reja, ose t'i zëvendësojë akuzat me akuza më të rënda, rregulla 86(3-4) zbatohet *mutatis mutandis*. ³Në rast se bëhet ndryshimi i autorizuar i aktakuzës, nuk kërkohet sërish konfirmim i saj.
- (3) Në rast se aktakuza e ndryshuar përfshin akuza të reja, ose akuzat zëvendësohen me akuza më të rënda, dhe i akuzuari tashmë është paraqitur para një trupi gjykues në pajtim me rregullën 92, paraqitja vijuese organizohet sa më shpejt që të jetë e realizueshme.
- (4) ¹Mbrojtjes i jepen njëzet e një (21) ditë për dorëzimin e mocioneve paraprake sipas rregullës 97, në lidhje me akuzat e reja. ²Në rast se del e nevojshme, trupi gjykues mund të shtyjë datën e hapjes së çështjes për t'i mundësuar Mbrojtjes kohë të mjaftueshme për përgatitje.
- (5) Pavarësisht nga paragrafi 1(b) dhe (c), Prokurori i Specializuar mund ta ndryshojë aktakuzën pa marrë autorizim, në kuadër të një marrëveshjeje për pranimin e fajësisë sipas rregullës 94.

Rregulla 91

Tërheqja e aktakuzës ose e akuzave

- (1) Në pajtim me nenin 40(7) të Ligjit, Prokurori i Specializuar mund të tërheqë aktakuzën, ose ndonjë prej akuzave të aktakuzës:
- (a) në çdo kohë para konfirmimit të aktakuzës, pa autorizim;

- (b) midis konfirmimit të aktakuzës dhe caktimit të çështjes trupit gjykues, me autorizim të gjykatësit të procedurës paraprake i cili e ka konfirmuar aktakuzën, dhe
 - (c) pas caktimit të çështjes një trupi gjykues, me autorizim të atij trupi gjykues.
- (2) Mbrojtja informohet pa vonesë mbi tërheqjen e aktakuzës apo e ndonjë prej akuzave të aktakuzës.
 - (3) Pavarësisht nga paragrafi (1)(b) dhe (c), Prokurori i Specializuar mund të tërheqë akuza pa marrë autorizim, në kuadër të një marrëveshjeje për pranimin e fajësisë sipas rregullës 94.
 - (4) Tërheqja e aktakuzës ose e akuzave nuk e pengon Prokurorin e Specializuar që më pas të paraqesë një aktakuzë në përputhje me rregullën 86, në rast se Prokurori i Specializuar paraqet prova të reja të cilat nuk njiheshin, ose nuk ishin të disponueshme në lidhje me aktakuzën e tërhequr, ose akuza shtesë.

Pjesa II: Paraqitja e parë dhe deklarimi i fajësisë ose pafajësisë

Rregulla 92

Paraqitja e parë e të akuzuarit

- (1) ¹Bazuar në nenin 39(4) të Ligjit dhe rregullën 87(6), i akuzuari nxirret para gjykatësit të procedurës paraprake pa vonesë të papërligjur. ²Në rast se i akuzuari nuk ka zgjedhur Mbrojtës të Specializuar, Administratori mund të caktojë përkohësisht një Mbrojtës të Specializuar i cili është i disponueshëm brenda një kohe të shkurtër për përfaqësimin e të akuzuarit në paraqitjen e parë dhe në çfarëdo paraqitje tjetër të mundshme të nevojshme.
- (2) Bazuar në nenin 39(5) të Ligjit, gjykatësi i procedurës paraprake:
 - (a) bindet se është respektuar e drejta e të akuzuarit për të pasur mbrojtës;
 - (b) lexon, ose mundëson që të akuzuarit t'i lexohet aktakuza në një gjuhë që i akuzuari kupton dhe flet dhe bindet se i akuzuari e ka kuptuar aktakuzën;
 - (c) informon të akuzuarin se brenda tridhjetë (30) ditësh pas paraqitjes së parë, të akuzuarit do t'i kërkohet të deklarojë nëse është fajtor, ose i pafajshëm për çdo akuzë, ose, në qoftë se dëshiron, i akuzuari mund të deklarojë menjëherë nëse është fajtor ose i pafajshëm;
 - (d) në qoftë se i akuzuari pranon fajësinë, procedohet sipas rregullës 93;
 - (e) në qoftë se i akuzuari vetëdeklarohet i pafajshëm, procedohet sipas rregullës 95;
 - (f) në qoftë se gjatë paraqitjes së parë ose paraqitjeve vijuese, i akuzuari nuk vetëdeklarohet në lidhje me fajësinë ose pafajësinë, në emër të të akuzuarit bëhet deklarimi se është i pafajshëm dhe procedohet sipas rregullës 95; dhe
 - (g) cakton data të tjera të përshtatshme për kryerjen e funksioneve të veta sipas rregullës 95.

- (3) Në dëm të të akuzuarit nuk nxirret asnjë përfundim, në rast se i akuzuari refuzon të deklarohet nëse është fajtor apo i pafajshëm.

Rregulla 93

Pranimi i fajësisë

- (1) ¹Në qoftë se i akuzuari pranon fajësinë, gjykatësi i procedurës paraprake informon Kryetarin, i cili cakton një trup gjykues. ²Në pajtim me rregullën 98, gjykatësi i procedurës paraprake ia kalon trupit gjykues dosjen e çështjes.
- (2) Në bazë të rrethanave, Prokurori i Specializuar mund:
- (a) të ndryshojë akuzat sipas rregullës 90, ose të tërheqë akuzat sipas rregullës 91(3);
 - (b) të propozojë një dënim konkret, ose kufijtë konkretë të dënimeve të përshtatshme; ose
 - (c) të mos kundërshtojë dënimin konkret, ose kufijtë konkretë të dënimeve propozuar nga Mbrojtësi i Specializuar.
- (3) Trupi gjykues i caktuar nga Kryetari, mund të shpallë fajësinë dhe të caktojë një datë për seancën e shqiptimit të dënimit sa më shpejt që të jetë e realizueshme, në qoftë se, pasi ka dëgjuar të akuzuarin, bindet se:
- (a) pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht;
 - (b) i akuzuari kupton kontekstin dhe pasojat e pranimi të fajësisë;
 - (c) pranimi i fajësisë është krejtësisht i qartë dhe i padykuptimtë;
 - (d) ekziston bazë faktike e mjaftueshme për vërtetimin e fakteve thelbësore të nevojshme për vërtetimin e veprës penale dhe pjesëmarrjen e të akuzuarit; dhe
 - (e) janë marrë parasysh si duhet interesat e drejtësisë.
- (4) Në rast se i akuzuari pranon fajësinë vetëm për disa akuza, në lidhje me këto akuza zbatohen paragrafi (1) dhe (2).
- (5) Në qoftë se nuk bindet se janë përmbushur kushtet e parashtruara në paragrafin (3), trupi gjykues e konsideron të paqenë pranimin e fajësisë dhe urdhëron që procedimi të vijojë sipas procedurës së zakonshme paraprakë në Ligj dhe në Rregullore.
- (6) Trupi gjykues jep vendim të arsyetuar mbi pranimin e fajësisë, i cili zyrtarisht përfshihet në dosjen e çështjes.

Rregulla 94

Marrëveshja për pranimin e fajësisë

- (1) Në çdo kohë para mbylljes së çështjes dhe mundësisht para hapjes së çështjes, Prokurori i Specializuar dhe Mbrojtja mund të arrijnë një marrëveshje me shkrim për pranimin e fajësisë.

- (2) Marrëveshja për pranimin e fajësisë është një marrëveshje midis Prokurorit të Specializuar dhe Mbrojtjes mbi:
- akuzat, ndër të cilat pjesëmarrja e të akuzuarit në veprën penale, ose veprat penale të akuzuara, dhe formën ose format e përgjegjësisë penale; dhe
 - një dënim konkret të përshtatshëm, ose kufij konkretë të dënimeve të përshtatshme; dhe
 - zhdëmtimin.
- (3) ¹Në qoftë se Prokurori i Specializuar dhe Mbrojtja arrijnë marrëveshje për pranimin e fajësisë para caktimit të një trupi gjykues, gjykatësi i procedurës paraprake informon Kryetarin i cili cakton një trup gjykues. ²Në pajtim me rregullën 98, gjykatësi i procedurës paraprake ia kalon dosjen e çështjes trupit gjykues.
- (4) Trupi gjykues urdhëron nxjerrjen e marrëveshjes për pranimin e fajësisë në seancë të hapur ose, në qoftë se dëgjon arsye bindëse, në seancë me dyer të mbyllura.
- (5) Trupi gjykues e miraton marrëveshjen për pranimin e fajësisë në qoftë se bindet se:
- Mbrojtësi i Specializuar ka diskutuar kushtet e marrëveshjes për pranimin e fajësisë me të akuzuarin;
 - i akuzuari i kupton kushtet e marrëveshjes për pranimin e fajësisë;
 - i akuzuari pranon fakte në lidhje me akuzat e përmendura në marrëveshjen për pranimin e fajësisë dhe është pajtuar me vullnet të lirë me këtë marrëveshje, pa kërcënime ose detyrim;
 - i akuzuari kupton pasojat e marrëveshjes për pranimin e fajësisë dhe heq dorë nga e drejta për t'u gjykuar me procedurë gjyqësore të zakonshme;
 - ekziston bazë faktike e mjaftueshme për vërtetimin e fakteve thelbësore të nevojshme për vërtetimin e veprës penale dhe pjesëmarrjen e të akuzuarit; dhe
 - janë marrë parasysh si duhet interesat e drejtësisë.
- (6) ¹Kushtet e marrëveshjes për pranimin e fajësisë nuk janë detyruese për trupin gjykues. ²Trupi gjykues mund t'u paraqesë Prokurorit të Specializuar dhe Mbrojtjes propozime për ndryshime dhe t'u kërkojë që t'i marrin në shqyrtim këto propozime.
- (7) Në qoftë se nuk bindet se janë përmbushur kushtet e parashtruara në paragrafin (5), trupi gjykues e konsideron të paqenë marrëveshjen për pranimin e fajësisë dhe urdhëron që procedimi të vijojë sipas procedurës së zakonshme, paraparë në Ligj dhe në Rregullore.
- (8) ¹Trupi gjykues jep vendim të arsyetuar mbi marrëveshjen për pranimin e fajësisë i cili përfshihet në dosjen e çështjes. ²Vendimi që miraton marrëveshjen për pranimin e fajësisë ka fuqinë ligjore të një aktgjykimi të formës së prerë dhe mund të riprocedohet penalisht vetëm në bazë të nenit 48 të Ligjit dhe rregullës 187.

Pjesa III: ***Procedura paraprake***

Rregulla 95

Funksionet e gjykatësit të procedurës paraprake pas konfirmimit të aktakuzës

- (1) Pas konfirmimit të aktakuzës sipas rregullës 86 dhe pas paraqitjes së parë të të akuzuarit sipas rregullës 92, gjykatësi i procedurës paraprake bashkërendon komunikimin midis palëve deri në momentin kur çështja i kalohet trupit gjykues sipas nenit 40(1) të Ligjit.
- (2) ¹Gjykatësi i procedurës paraprake siguron që të mos ketë vonesa të paarsyeshme të nisjes së procedimit dhe merr të gjitha masat e nevojshme për përgatitjen e shpejtë të çështjes për gjykim.
²Ndër të tjera, gjykatësi i procedurës paraprake:
 - (a) përcakton kalendarin dhe planin e punës në lidhje me detyrimet e palëve gjatë procedurës paraprake;
 - (b) përcakton afate për nxjerrjen e materialeve në pajtim me Kapitullin 7, merr masa për të mundësuar nxjerrjen e materialeve në kohë dhe përgatit një raport për trupin gjykues mbi nxjerrjen e materialeve;
 - (c) ndërmer hapa për përcaktimin dhe shkurtimin e listës së pikave të kontestuara dhe të pakontestuara midis palëve;
 - (d) mban seanca të nevojshme për të mundësuar procedim të drejtë dhe të shpejtë;
 - (e) përcakton afate për dorëzimin e mocioneve deri kur dosja e çështjes gjyqësore t'i kalohet trupit gjykues, ndër të cilat edhe mocione kundërshtuese të palëve në lidhje me pranueshmërinë e provave të nxjerra sipas rregullës 102;
 - (f) vendos në lidhje me mocione paraprake të dorëzuara sipas rregullës 97 para se dosja e çështjes gjyqësore t'i kalohet trupit gjykues;
 - (g) vendos në lidhje me mocione të dorëzuara sipas rregullës 52, rregullës 56 dhe rregullës 57;
 - (h) vendos në lidhje me mocione për masa mbrojtëse, të dorëzuara para se dosja e çështjes gjyqësore t'i jetë kaluar trupit gjykues;
 - (i) vendos në lidhje me kërkesat për pranimin si viktimë pjesëmarrëse në procedura, dorëzuar para se dosja e çështjes gjyqësore t'i jetë kaluar trupit gjykues; dhe
 - (j) parashikon një datë brenda së cilës çështja duhet të jetë gati për gjykim.

³Në kryerjen e këtyre funksioneve, gjykatësi i procedurës paraprake merr mendimin e palëve dhe kur është e zbatueshme, të Mbrojtësit të Viktimave, në mungesë të të akuzuarit dhe të personave të tjerë. Seanca të tilla mund të mbahen *in camera*. Administratori mban procesverbalin e seancës.
- (3) Pasi të ketë dëgjuar palët, gjykatësi i procedurës paraprake evidenton pikat juridike dhe faktike për të cilat palët kanë arritur marrëveshje.
- (4) Gjykatësi i procedurës paraprake urdhëron Prokurorin e Specializuar që brenda një afati të përcaktuar të dorëzojë:

- (a) dosjen paraprake të Prokurorit të Specializuar e cila, ndër të tjera, përmban për çdo akuzë një përmbledhje të provave të cilat Prokurori i Specializuar synon t'i paraqesë në lidhje me kryerjen e veprës penale të pretenduar dhe formës së përgjegjësisë penale të pretenduar të të akuzuarit. Kjo dosje përfshin çfarëdo pranim në lidhje me faktet nga ana e Mbrojtjes, si edhe një listë të pikave të pakontestuara;
- (b) listën e dëshmitarëve që Prokurori i Specializuar synon të thërrasë, ku ndër të tjera përfshihen:
- (i) një përlogaritje e kohëzgjatjes së gjithsejtë për paraqitjen e provave nga Prokurori i Specializuar;
 - (ii) numri i gjithsejtë i dëshmitarëve që përfshin edhe numrin e dëshmitarëve të cilët priten të dëshmojnë kundër secilit të akuzuar dhe për secilën akuzë;
 - (iii) emri ose pseudonimi i secilit dëshmitar;
 - (iv) një përmbledhje e fakteve në lidhje me të cilat pritet të dëshmojë secili dëshmitar;
 - (v) pretendimet në aktakuzë në lidhje me të cilat pritet të dëshmojë secili dëshmitar, duke përmendur konkretisht akuzat dhe paragrafët përkatës të aktakuzës;
 - (vi) informacion nëse dëshmitari do të dëshmojë duke qenë fizikisht i pranishëm, ose nëpërmjet mënyrave të tjera të parapara në Rregullore; dhe
 - (vii) një përlogaritje e kohëzgjatjes së marrjes në pyetje të secilit dëshmitar.
- (c) listën e provave materiale të propozuara që Prokurori i Specializuar synon të paraqesë, ku përfshihet, kurdoherë që është e mundshme, çfarëdo kundërshtimi i Mbrojtjes lidhur me autenticitetin e këtyre provave;
- (5) ¹Pas dorëzimit prej Prokurorit të Specializuar të materialeve të përmendura në paragrafin (4), gjykatësi i procedurës paraprake fton Mbrojtjen që brenda një afati të përcaktuar të dorëzojë dosjen paraprake e cila përmban:
- (a) një përshkrim të përgjithshëm të brendisë së mbrojtjes së të akuzuarit;
 - (b) akuzat dhe pikat që i akuzuari kundërshton, duke përmendur paragrafët konkretë në dosjen paraprake të Prokurorit të Specializuar dhe arsyet e kundërshtimit të të akuzuarit ndaj tyre; dhe
 - (c) një listë të dëshmitarëve të mundshëm që Mbrojtja synon të thërrasë e cila nuk paragjykon çfarëdo ndryshim ose dorëzim të mëvonshëm të saj. Për çdo dëshmitar, Mbrojtja saktëson se me cilin aspekt përkatës konkret lidhet dëshmia e dëshmitarit.

²Gjithashtu, brenda një afati të përcaktuar nga gjykatësi i procedurës paraprake, Mbrojtja informon Prokurorin e Specializuar mbi synimin e vet për të përdorur alibinë ose çfarëdo arsye tjetër që përjashton përgjegjësi penale, ndër të cilat aftësia mendore e kufizuar, ose mungesa e aftësisë mendore, intoksikimi, domosdoshmëria, shtrëngimi dhe gabime faktike ose ligjore.

Rregulla 96**Konferencat mbi ecurinë e çështjes**

- (1) Gjykatësi i procedurës paraprake mbledh një konferencë mbi ecurinë e çështjes sa më shpejt që të jetë e mundur, pas paraqitjes së parë të të akuzuarit dhe më pas nëse del e nevojshme për:
 - (a) organizimin e shkëmbimeve midis palëve dhe, kur është e zbatueshme, të Mbrojtësit të Viktimave për të garantuar përgatitje të shpejta për gjykimin;
 - (b) ndërmarrjen e hapave që mundësojnë çdo përgatitje të nevojshme prej palëve në mënyrë të zellshme dhe në kohë; dhe
 - (c) rishikimin e ecurisë së çështjes dhe që palëve, e kur është e zbatueshme Mbrojtësit të Viktimave, t'u jepet mundësia e ngritjes së problemeve në lidhje me çështjen.
- (2) Me pëlqimin me shkrim të të akuzuarit që jepet pas këshillimit me Mbrojtësin e vet të Specializuar, në bazë të kësaj rregulle konferenca për ecurinë e çështjes mund të mbahet:
 - (a) në praninë e të akuzuarit dhe me pjesëmarrjen e Mbrojtësit të Specializuar nëpërmjet videokonferencës;
 - (b) në praninë e Mbrojtësit të Specializuar dhe me pjesëmarrjen e të akuzuarit nëpërmjet videokonferencës; dhe
 - (c) në mungesë të të akuzuarit dhe me praninë e Mbrojtësit të Specializuar, ose pjesëmarrjes së Mbrojtësit të Specializuar nëpërmjet videokonferencës.

Rregulla 97**Mocionet paraprake**

- (1) Në pajtim me nenin 39(1) të Ligjit, i akuzuari mund t'i dorëzojë mocione paraprake gjykatësit të procedurës paraprake, të cilat:
 - (a) nuk njohin juridiksionin e Dhomave të Specializuara;
 - (b) pretendojnë mangësi në formën e aktakuzës; dhe
 - (c) kërkojnë veçimin e akuzave sipas rregullës 89(2).
- (2) ¹Mocionet e lartpërmendura bëhen me shkrim dhe dorëzohen brenda tridhjetë (30) ditësh pas nxjerrjes së të gjithë materialit dhe deklaratave të përmendura në rregullën 102(1)(a). ²Vendimet në lidhje me këto mocione merren brenda njëzet e një (21) ditësh pas dorëzimit të parashtrimit të fundit, ose para deklaratave hyrëse sipas rregullës 126, në datën më të mëhershme.
- (3) ¹Apelet kundër vendimeve mbi mocionet paraprake sipas paragrafit (1)(a) lejohen vetvetiu bazuar në nenin 45(2) të Ligjit. ²Për të gjitha vendimet e tjera që merren në bazë të paragrafit (1), vlen rregulla 77.

Rregulla 98**Kalimi i dosjes së çështjes trupit gjykues**

- (1) Pas marrjes së parashtrimeve nga Prokurori i Specializuar dhe Mbrojtja bazuar në rregullën 95(4-5) dhe rregullën 97 dhe brenda tridhjetë (30) ditësh pas marrjes së çdo vendimi të formës së prerë në lidhje me mocione paraprake, gjykatësi i procedurës paraprake i jep trupit gjykues dosjen e plotë të çështjes gjyqësore, e cila përmban:
 - (a) aktakuzën e konfirmuar së bashku me materialin mbështetës sipas rregullës 86(3);
 - (b) të gjitha parashtrimet dhe materialet e dorëzuara nëpërmjet sistemit elektronik të administrimit gjyqësor;
 - (c) çfarëdo provash të administruara që nuk përmenden në paragrafin (1)(b);
 - (d) çfarëdo letërkëmbimi në lidhje me çështjen që nuk është dorëzuar në Njësinë e Administrimit Gjyqësor;
 - (e) një dokument dorëzues që përfshin:
 - (i) argumentet e palëve dhe nëse është e zbatueshme, të Mbrojtësit të Viktimave, në lidhje me faktet dhe ligjin përkatës;
 - (ii) pikat për të cilat palët pajtohen;
 - (iii) listën e urdhrave dhe vendimeve të dhëna nga gjykatësi i procedurës paraprake;
 - (iv) provat e paraqitura nga secila palë;
 - (v) sugjerime në lidhje me numrin dhe rëndësinë e dëshmitarëve që do të thirren;
 - (vi) pikat e kundërshtuara faktike dhe ligjore;
 - (vii) ecurinë e nxjerrjes së materialeve;
 - (viii) të gjitha mbledhjet me palët; dhe
 - (ix) çfarëdo çështje tjetër të pazgjidhur;
 - (f) kërkesa dhe vendime në lidhje me nxjerrjen e materialit; dhe
 - (g) çfarëdo materiali tjetër që ka lidhje me çështjen.
- (2) Kalimi i dosjes së çështjes gjyqësore bazuar në paragrafin (1), kryhet në mënyrë elektronike.
- (3) Para kalimit të dosjes së çështjes sipas paragrafit (1), gjykatësi i procedurës paraprake informon në lidhje me sa më lart dhe në kohë Kryetarin, për të mundësuar caktimin në kohë të një trupi gjykues.

Pjesa IV: Mundësi hetimore e vetme**Rregulla 99****Dispozita të përgjithshme**

- (1) Në qoftë se palët gjykojnë se një hetim ofron një mundësi të vetme për marrjen e dëshmisë prej një dëshmitari ose për shqyrtimin, mbledhjen ose verifikimin e provave të cilat më pas mund të mos jenë të disponueshme gjatë procesit gjyqësor, me kërkesë të një pale gjykatësi i procedurës paraprake mund të marrë masa të nevojshme për të garantuar ruajtjen e provave.
- (2) ¹Në rast se një aktakuzë nuk është konfirmuar ende dhe Prokurori i Specializuar nuk ka parashtruar kërkesë për masa sipas kësaj rregulle, mirëpo gjykatësi i procedurës paraprake gjykon se masa të tilla janë të domosdoshme për ruajtjen e provave që i gjykon thelbësore për Mbrojtjen gjatë gjykimit, gjykatësi i procedurës paraprake këshillohet me Prokurorin e Specializuar nëse ky i fundit ka arsye të vlefshme për mosparaqitje kërkesë për masa të tilla. ²Në qoftë se pas këshillimit, gjykatësi i procedurës paraprake arrin në përfundimin se mosparaqitja e kërkesës për masa të tilla prej Prokurorit të Specializuar është e papërligjur, gjykatësi i procedurës paraprake ka të drejtë të marrë masat në fjalë *proprio motu*.
- (3) Ndër masat e përmendura në paragrafin (1) përfshihen:
 - (a) pjesëmarrja e gjykatësit të procedurës paraprake, ose e një gjykatësi të caktuar nga Kryetari në një mundësi hetimore të vetme, me kërkesë të palëve ose *proprio motu*;
 - (b) rekomandime ose urdhra në lidhje me procedurat që duhen zbatuar;
 - (c) urdhër për dokumentimin e procedurave; dhe
 - (d) autorizim dhënë Mbrojtësit të Specializuar për prani dhe përfaqësim të interesave të Mbrojtjes.
- (4) Pranueshmëria e provave të mbledhura ose të ruajtura për gjykimin sipas kësaj rregulle, gjatë fazës së gjykimit përcaktohet prej rregullës 138 dhe rëndësia e tyre përcaktohet nga trupi gjyqësor.

Rregulla 100**Marrja e deponimeve pas vendimit të gjykatësit të procedurës paraprake**

- (1) Në qoftë se ekzistojnë arsye që bëjnë të besohet se dëshmia e një dëshmitari të mundshëm mund të bëhet e padisponueshme, gjykatësi i procedurës paraprake mund të urdhërojë *proprio motu* ose me kërkesë të një pale, marrjen e një deponimi për përdorim në gjyq, pavarësisht nëse personi deponimi i të cilit kërkohet është apo nuk është në gjendje të paraqitet personalisht para Dhomave të Specializuara për të dëshmuar.
- (2) Mocioni për marrjen e një deponimi duhet të përmbajë emrin dhe vendndodhjen e personit prej të cilit kërkohet deponimi, datën dhe vendin ku do të merret deponimi, një deklaratë të çështjeve në lidhje me të cilat do të pyetet personi, dhe rrethanat që arsyetojnë marrjen e deponimit.
- (3) ¹Në qoftë se mocioni miratohet, pala me kërkesën e së cilës do të merret deponimi, njofton në kohë palën tjetër dhe nëse është e zbatueshme, Mbrojtësin e Viktimave, të cilëve u jepet

mundësia të jenë të pranishëm në marrjen e deponimit dhe të marrin në pyetje personin prej të cilit do të merret deponimi. ²Gjykatësi i procedurës paraprake mund të mbikëqyrë dhe të rekomandojë, ose urdhërojë në lidhje me mbledhjen dhe ruajtjen e dëshmive dhe marrjen në pyetje të personave.

- (4) ¹Dëshmia deponuese mund të merret ose në selinë e Dhomave të Specializuara, ose jashtë saj, dhe mund të merret gjithashtu përmes videokonferencës me kërkesë të cilësdo palë. ²Rregulla 143 zbatohet *mutatis mutandis*.
- (5) ¹Gjykatësi i procedurës paraprake garanton marrjen e deponimit në përputhje me Rregulloren dhe evidentimin e saktë të deponimit prej Administratorit në një procesverbal. ²Ky procesverbal përmban informacionin vijues:
- (a) pyetjet dhe përgjigjet;
 - (b) çfarëdo problemesh të ngritura dhe vendime të marra në lidhje me to; dhe
 - (c) nëse problemet i janë bërë të njohura trupit gjykues.
- (6) Gjykatësi i procedurës paraprake ia kalon procesverbalin trupit gjykues, qoftë si pjesë e dosjes së plotë të çështjes gjyqësore përcaktuar sipas rregullës 98, ose në një fazë të mëvonshme, në varësi të rrethanave të përshtatshme.

Rregulla 101

Provat e mbledhura nga autoritetet gjyqësore të një shteti të tretë

- (1) Në qoftë se Dhomat e Specializuara pengohen në ushtrimin e një mundësie hetimore në pajtim me rregullën 99 në territorin e një shteti të tretë, me kërkesë të palëve ose *proprio motu*, një panel mund t'u kërkojë autoriteteve gjyqësore të atij shteti të zbatojnë mundësinë hetimore të vetme në përputhje me një marrëveshje dypalëshe, nëse një marrëveshje e tillë ekziston, ose në përputhje me një marrëveshje të përkohshme, në varësi të kushteve të përcaktuara në paragrafët (2) dhe (3).
- (2) ¹Në qoftë se autoritetet kompetente të shtetit të tretë përkatës pajtohen për sa më lart, paneli dhe palët mund të jenë të pranishme në marrjen në pyetje të dëshmitarit që kryhet nga një autoritet gjyqësor i atij shteti duke u bazuar në pyetjet e parashtruara nga palët. ²Autoriteti gjyqësor mund t'i lejojë palët që ta pyesin dëshmitarin drejtpërsëdrejti.
- (3) ¹Administratori mund të filmojë seancën e pyetjeve. ²Me kërkesë të një pale dhe për aq sa është e realizueshme, Administratori mundëson transkriptin e marrjes në pyetje të dëshmitarëve.
- (4) Varësisht prej pëlqimit të shtetit të tretë në fjalë, gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarit mund të jetë i pranishëm gjykatësi i procedurës paraprake, ose një gjykatës i caktuar nga kryetari i një paneli.

Kapitulli 7

Nxjerrja e materialit

Rregulla 102

Nxjerrja e materialit nga Prokurori i Specializuar

- (1) ¹Në varësi të dispozitave të rregullës 105, rregullës 107 dhe rregullës 108, Prokurori i Specializuar i vë në dispozicion Mbrojtjes, dhe, kur është e zbatueshme, Mbrojtësit të Viktimave:
- (a) sa më shpejt që të jetë e mundur, por të paktën brenda tridhjetë (30) ditësh nga paraqitja e parë e të akuzuarit, materialet mbështetëse të aktakuzës të dorëzuar për konfirmim, si dhe të gjitha deklaratat e marra prej të akuzuarit; dhe
 - (b) brenda afatit kohor të përcaktuar prej trupit gjykues dhe jo më vonë se tridhjetë (30) ditë përpara hapjes së çështjes nga Prokurori i Specializuar:
 - (i) deklaratat e të gjithë dëshmitarëve që Prokurori i Specializuar synon t'i thërrasë për të dëshmuar në gjykim;
 - (ii) të gjitha deklaratat e tjera të dëshmitarëve, raportet e ekspertëve, deponimet apo transkriptet që Prokurori i Specializuar synon t'i paraqesë në gjykim;
 - (iii) deklarata të dëshmitarëve të tjerë të Prokurorit të Specializuar, kur merret vendimi për thirrjen e këtyre dëshmitarëve; dhe
 - (iv) provat materiale që Prokurori i Specializuar synon t'i paraqesë në gjykim.

²Deklaratat e të gjithë dëshmitarëve të cilët Prokurori i Specializuar synon t'i thërrasë për të dëshmuar në gjykim vihen në dispozicion në një gjuhë që i akuzuari kupton dhe flet.

- (2) ¹Bazuar në nenin 21(6) të Ligjit, Prokurori i Specializuar i jep njoftim të hollësishëm Mbrojtjes për çdo material dhe provë që ka në zotërim. ²Me kërkesë të Mbrojtjes, Prokurori i Specializuar vë në dispozicion çfarëdo deklarate, dokumenti, fotografie dhe lejon këqyrjen e çdo sendi tjetër të prekshëm nën ruajtjen ose kontrollin e Prokurorit të Specializuar, që Mbrojtja i konsideron juridikisht thelbësore për përgatitjen e vet, ose që i janë marrë, apo i përkisnin të akuzuarit. ³Nxjerrja e materialeve dhe provave të tilla bëhet pa vonesë. ⁴Prokurori i Specializuar informon menjëherë trupin gjykues në qoftë se ekzistojnë arsye për kundërshtimin e rëndësisë materiale të informacionit të lartpërmendur.
- (3) ¹Nxjerrja e materialit në bazë të paragrafit (2) finalizohet gjatë fazës së procedurës paraprake. ²Më pas, Prokurori i Specializuar jep njoftim për çdo nxjerrje materiali të ri, së bashku me arsyet për vonesën e nxjerrjes së materialit.

Rregulla 103

Nxjerrja e provave shfajësuese

Në varësi të rregullës 107 dhe rregullës 108, Prokurori i Specializuar i vë menjëherë në dispozicion Mbrojtjes çdo informacion për të cilin ka arsye të besohet se sugjeron pafajësinë, apo lehtëson fajësinë e të akuzuarit, apo ndikon në besueshmërinë ose mbështetshmërinë e provave të Prokurorit të

Specializuar, sapo një informacion i tillë të jetë nën ruajtjen, kontrollin apo dijeninë faktike të Prokurorit të Specializuar.

Rregulla 104

Nxjerrja e materialit nga Mbrojtja

- (1) Në rast se Mbrojtja ka bërë njoftim në përputhje me rregullën 95(5), brenda afatit kohor të caktuar nga trupi gjykues dhe në kohë të mjaftueshme përpara hapjes së çështjes sipas rregullës 124 për t'i mundësuar Prokurorit të Specializuar të përgjigjet, Mbrojtja e informon Prokurorin e Specializuar për:
 - (a) në rast alibie, vendin ose vendet ku i akuzuari pretendon të ketë qenë i pranishëm në kohën e veprës penale të pretenduar, emrat dhe të dhënat e përditësuara për kontaktimin e dëshmitarëve dhe çdo provë tjetër tek e cila i akuzuari synon të mbështetet për të vërtetuar alibinë; ose
 - (b) në rast të arsyeve të tjera që përjashtojnë përgjegjësi penale, emrat dhe të dhënat e përditësuara për kontaktimin e dëshmitarëve, dhe çdo provë tjetër tek e cila i akuzuari synon të mbështetet për vërtetimin e këtyre arsyeve.
- (2) Brenda afatit kohor të përcaktuar nga trupi gjykues, Prokurori i Specializuar i njofton Mbrojtjes emrat e dëshmitarëve që synon të thërrasë për të dëshmuar si kundërpërgjigje ndaj cilësdo prej provave të përmendura në paragrafin (1).
- (3) ¹Mosnjoftimi prej Mbrojtjes i alibisë ose i çdo arsyeje tjetër që përjashton përgjegjësi penale nuk kufizon të drejtën e të akuzuarit për t'u mbështetur tek këto arsye. ²Çdo vonesë në njoftim duhet të përligjet. Trupi gjykues mund të nxjerrë përfundime negative nga mosnjoftimi.
- (4) Trupi gjykues shqyrton, *proprio motu*, nga ana juridike, arsyet sipas paragrafit (1)(b) edhe nëse këto nuk janë paraqitur nga Mbrojtja.
- (5) Nëse vendos të paraqesë prova, brenda afatit kohor të caktuar nga trupi gjykues dhe jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë përpara hapjes së çështjes së vet, Mbrojtja:
 - (a) i lejon Prokurorit të Specializuar të këqyrë dhe të bëjë kopje të çfarëdo deklarate, dokumenti, fotografie dhe sendi tjetër të prekshëm nën ruajtjen ose kontrollin e Mbrojtjes, që Mbrojtja synon t'i përdorë si prova në gjykim;
 - (b) i jep Prokurorit të Specializuar deklaratat, nëse ka, e të gjithë dëshmitarëve të cilët Mbrojtja synon t'i thërrasë për të dëshmuar në gjykim, si dhe të gjitha deklaratat e marra që Mbrojtja synon t'i paraqesë në gjykim; dhe
 - (c) i jep Prokurorit të Specializuar provat materiale që Mbrojtja synon t'i paraqesë në gjykim.
- (6) Deklaratat e çdo dëshmitari shtesë i vihen në dispozicion Prokurorit të Specializuar me t'u marrë vendimi për thirrjen e këtyre dëshmitarëve dhe, në çdo rast, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë para datës së caktuar për dhënien e dëshmisë nga këta dëshmitarë.
- (7) Kur është e zbatueshme, materialet e paragrafëve (5) dhe (6) i vihen në dispozicion edhe Mbrojtësit të Viktimave.

Rregulla 105**Moszbulimi i përkohshëm i identitetit**

- (1) ¹Në rrethana të veçanta, palët, ose kur është e zbatueshme, Mbrojtësi i Viktimave, mund t'i bëjnë kërkesë trupit gjykues për moszbulim të përkohshëm të identitetit të një dëshmitari ose viktime pjesëmarrëse në procedura të rrezikuar, deri sa të urdhërohen masat e përshtatshme mbrojtëse. ²Në kërkesën e arsyetuar përfshihen masat konkrete që kërkohen.
- (2) Në marrjen e vendimit për moszbulimin e përkohshëm të identitetit, trupi gjykues mund të këshillohet me Zyren për Mbrojtjen dhe Mbështetjen e Dëshmitarëve.
- (3) Në varësi të rregullës 80(4)(e), identiteti i dëshmitarit bëhet i njohur paraprakisht në kohë të mjaftueshme për t'i dhënë Mbrojtjes mundësi të përgatitet.

Rregulla 106**Mosnxjerrja e raporteve, memorandumeve dhe dokumenteve të tjera të brendshme**

¹Në varësi të rregullës 103 dhe nëse një panel nuk ka urdhëruar ndryshe, raportet, memorandumet dhe dokumentet e tjera të brendshme në lidhje me hetimin ose përgatitjen e një çështjeje, të përgatitura nga njëra prej palëve ose Mbrojtësi i Viktimave, ndihmësit ose përfaqësuesit e tyre, nuk janë objekt i nxjerrjes ose njoftimit sipas kësaj Rregulloreje. ²Në rastin e Prokurorit të Specializuar, këtu përfshihen raportet, memorandumet, ose dokumentet e tjera të brendshme të përgatitura nga TFHS-ja, ose ndihmësit apo përfaqësuesit e saj në lidhje me hetimet e TFHS-së.

Rregulla 107**Informacion i mbrojtur që nuk është objekt i nxjerrjes së materialit**

- (1) ¹Në qoftë se Prokurori i Specializuar ka nën ruajtje ose kontroll informacion që i është dhënë në mënyrë konfidenciale dhe vetëm për qëllimin e mbledhjes së provave të reja, një informacion i tillë dhe burimi përkatës mbrohen sipas nenit 58 të Ligjit. ²Materiali ose informacioni fillestar nuk nxirren pa pëlqimin e dhënësit dhe në asnjë rast nuk paraqitet si provë materiale pa iu bërë i ditur paraprakisht të akuzuarit.
- (2) ¹Në rastet kur informacioni është objekt i nxjerrjes së materialit, Prokurori i Specializuar i bën trupit gjykues kërkesë konfidenciale dhe *ex parte* për t'u liruar, tërësisht ose pjesërisht, nga detyrimi sipas rregullës 102 dhe rregullës 103 për nxjerrjen e materialit fillestar. ²Në kërkesë përfshihet edhe informacioni në fjalë. ³Prokurori i Specializuar mund të bëjë kërkesë edhe për masa kompensuese sipas rregullës 108(2).
- (3) Në qoftë se pas marrjes së pëlqimit të dhënësit të materialit ose informacionit fillestar sipas paragrafit (1), Prokurori i Specializuar vendos ta përdorë cilëndo pjesë të tij si provë, trupi gjykues, pavarësisht nga rregulla 121, rregulla 122 dhe rregulla 132, nuk mund:
 - (a) të urdhërojë asnjë palë të paraqesë prova të tjera shtesë të marra nga dhënësi i materialit ose informacionit fillestar;

- (b) të thërrasë dhënësin e materialit ose informacionit fillestar si dëshmitar, apo të urdhërojë praninë e tij në pajtim me Rregulloren, me qëllim paraqitjen e provave të tilla shitesë; ose
 - (c) të urdhërojë praninë e dëshmitarëve të tjerë, apo të kërkojë dorëzimin e dokumenteve, me qëllim marrjen e provave të tilla shitesë.
- (4) Nëse Prokurori i Specializuar thërret një dëshmitar që të paraqesë si provë çfarëdo informacioni sipas kësaj rregulle, trupi gjykues nuk mund ta detyrojë atë dëshmitar t'i përgjigjet çfarëdo pyetjeje në lidhje me informacionin ose burimin e informacionit, në qoftë se dëshmitari refuzon të përgjigjet për arsye konfidencialiteti.
- (5) E drejta e të akuzuarit për të kundërshtuar provat e paraqitura nga Prokurori i Specializuar mbetet e pandryshuar, varësisht nga kufizimet që përmbajnë paragrafët (3) dhe (4).
- (6) Dispozitat e kësaj rregulle vlejnë *mutatis mutandis* për informacion konkret nën ruajtjen apo kontrollin e Mbrojtjes.
- (7) Asgjë në paragrafët (3) dhe (4) nuk ndikon në kompetencën e trupit gjykues për përjashtimin e këtyre provave, apo për marrjen e çfarëdo mase të nevojshme për garantimin e një gjykimi të drejtë.

Rregulla 108

Informacion tjetër që nuk është objekt i nxjerrjes së materialit

- (1) Kur informacioni nën ruajtjen, kontrollin ose në dijeninë faktike të Prokurorit të Specializuar duhet nxjerrë sipas rregullës 102 ose rregullës 103, por kur një gjë e tillë mund:
- (a) të cenojë hetimet në kryerje e sipër, ose hetimet e ardhshme;
 - (b) të shkaktojë rrezik të rëndë për sigurinë e një dëshmitari, viktime pjesëmarrëse në procedura, ose anëtarëve të familjeve të tyre; ose
 - (c) të jetë në kundërshtim, për ndonjë arsye tjetër, me interesin publik ose të drejtat e palëve të treta;
- Prokurori i Specializuar mund t'i bëjë trupit gjykues kërkesë konfidenciale dhe *ex parte* për mosnxjerrjen e informacionit përkatës, në tërësi ose pjesërisht.
- (2) Në një kërkesë të tillë, Prokurori i Specializuar përfshin informacionin në fjalë, arsyet e mosnxjerrjes, redaktimet e propozuara nëse ka, dhe një deklaratë lidhur me masat kompensuese, ndër të cilat:
- (a) identifikimi i informacionit të ri të ngjashëm;
 - (b) dorëzimi i një përmbledhjeje të informacionit;
 - (c) dorëzimi i informacionit në formë të redaktuar; ose
 - (d) parashtrimi i fakteve përkatëse lidhur me arsyet e mosnxjerrjes.

- (3) ¹Trupi gjykues shqyrton nëse informacioni në fjalë i nënshtrohet nxjerrjes në bazë të Rregullores. ²Nëse arrin në këtë përfundim, trupi gjykues shqyrton kërkesën e Prokurorit të Specializuar dhe arsyet e mosnxjerrjes, së bashku me masat kompensuese të propozuara.
- (4) ¹Trupi gjykues mund të urdhërojë marrjen e masave të përshtatshme kompensuese. ²Në qoftë se, sipas mendimit të trupit gjykues, asnjë masë nuk do të garantonte të drejtën e të akuzuarit për një gjykim të drejtë, Prokurorit të Specializuar i jepet mundësia që, ose ta nxjerrë informacionin, ose t'i ndryshojë ose tërheqë akuzat me të cilat lidhet informacioni.
- (5) Prokurori i Specializuar mund t'i kërkojë Kryetarit të emërojë një *amicus curiae* për ta ndihmuar dhe këshilluar trupin gjykues lidhur me masat kompensuese.
- (6) Paragrafët (1-5) zbatohen *mutatis mutandis* për Mbrojtjen.

Rregulla 109

Procedura e nxjerrjes së materialeve

Për aq sa është e realizueshme, pala:

- (a) i përmbush të gjitha detyrimet e veta të nxjerrjes së materialit në formë elektronike, së bashku me programet e përshtatshme kompjuterike të dhëna nga Administratori që mundësojnë kryerjen e kërkimeve në material;
- (b) jep një përshkrim të qartë dhe të përmbledhur të dokumenteve, ose kategorive të dokumenteve, që i janë dhënë palës kundërshtare; dhe
- (c) e kategorizon informacionin në përputhje me akuzat e aktakuzës, me referenca konkrete për veprat penale që përbëjnë bazën e tyre, elementet kontekstuale të veprave penale, veprimet e pretenduara të të akuzuarit, ose, kur është e zbatueshme, provat që do të paraqiten nga Prokurori i Specializuar.

Rregulla 110

Mospërmbushja e detyrimit të nxjerrjes së materialit

Me kërkesën e një prej palëve ose *proprio motu*, trupi gjykues mund të vendosë për masat që do të merren si rezultat i mospërmbushjes së detyrimeve të nxjerrjes së materialit në bazë të Rregullores, ndër të cilat edhe pezullimi i procesit dhe përjashtimi i provave, përveç provave shfajësuese.

Rregulla 111

Komunikimet dhe informacionet e privileguara

- (1) ¹Komunikimet e bëra në kontekstin e marrëdhënies profesionale ndërmjet një personi dhe Mbrojtësit të tij të Specializuar, konsiderohen të privileguara dhe dokumentohen vetëm në përputhje me këtë Rregullore, ose me Rregulloren e Paraburgimit, Ankesave dhe Procedurave Disiplinore. ²Komunikime të tilla nuk i nënshtrohen nxjerrjes, përveç nëse:
- (a) personi jep pëlqimin me shkrim për këtë;

- (b) personi i bën të njohur vullnetarisht përmbajtjen e komunikimeve një pale të tretë dhe pala e tretë më pas jep dëshmi për këtë nxjerrje; ose
 - (c) personi synonte të kryente një vepër penale dhe komunikimet i shërbenin kryerjes së asaj veprë penale.
- (2) Komunikimet e bëra në kontekstin e marrëdhënieve profesionale ose marrëdhënieve të tjera konfidenciale konsiderohen të privileguara dhe, rrjedhimisht, nuk i nënshtrohen nxjerrjes, nëse një panel vendos që:
- (a) këto komunikime bëhen në kontekst të një marrëdhënieje konfidenciale e cila krijon pritshmëri të arsyeshme për privatësi dhe mosnxjerrje;
 - (b) konfidencialiteti është thelbësor për natyrën e asaj marrëdhënieje; dhe
 - (c) privilegji nuk është kërkuar në mënyrë të palejueshme për qëllim shpërdorues, ose nuk përbën provë për një vepër penale.
- (3) ¹Një panel njeh si të privileguara komunikimet e bëra në kontekstin e marrëdhënies profesionale midis një personi dhe mjekut, psikologut ose këshillëdhënësit të tij, në veçanti ato që lidhen me viktimat, ose midis një personi dhe një kleriku. ²Trupi gjykues njeh si të privileguara komunikimet e bëra në kontekstin e rrëfimit të shenjtë, kur ky është pjesë përbërëse e praktikës së atij besimi fetar.
- (4) ¹Një trup gjykues njeh si të privileguar çdo informacion, dokument ose provë tjetër që KNKK-ja ka marrë në zotërim gjatë, ose si rrjedhojë e kryerjes së funksioneve të veta në përputhje me Statutet e Lëvizjes Ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe. ²Informacione, dokumente, ose prova të tjera të tilla nuk nxirren në asnjë fazë të procesit gjyqësor, përfshirë edhe përmes dëshmisë të ndonjë zyrtari ose punonjësi të tanishëm apo të mëparshëm të KNKK-së, përveç nëse:
- (a) pas konsultimeve, KNKK-ja jep pëlqimin me shkrim për nxjerrje të materialeve të lartpërmendura, ose ka hequr dorë nga ky privilegj në ndonjë mënyrë tjetër; ose
 - (b) këto informacione, dokumente apo prova të tjera përmbahen në deklaratat dhe dokumentet publike të KNKK-së.
- (5) Asgjë në paragrafin (4) nuk ndikon në pranueshmërinë e të njëjtave prova të marra nga një burim tjetër që nuk është KNKK-ja, zyrtarë ose punonjës të tij, kur këto prova janë marrë prej atij burimi në mënyrë të pavarur nga KNKK-ja, zyrtarët ose punonjësit e tij.
- (6) Nëse trupi gjykues konkludon se informacionet, dokumentet, ose provat e tjera të KNKK-së kanë rëndësi thelbësore për një çështje gjyqësore të caktuar, ndërmjet Dhomave të Specializuara dhe KNKK-së mbahen konsultime për zgjidhjen e problemit nëpërmjet bashkëpunimit, duke pasur parasysh rrethanat e çështjes, rëndësinë e provave të kërkuara, nëse provat mund të merren nga një burim tjetër përveç KNKK-së, interesat e një gjykimi të drejtë dhe të shpejtë dhe interesat e viktimave pjesëmarrëse në procedura, si edhe kryerjen e funksioneve të Dhomave të Specializuara dhe KNKK-së.

Rregulla 112

Mbetja në fuqi e detyrimit të nxjerrjes së materialit

¹Nëse njëra nga palët zbulon prova apo informacion shtesë që, sipas Rregullores, duhej të ishte nxjerrë më parë, ajo palë ua bën të njohura menjëherë këto prova apo informacione palës kundërshtare dhe panelit. ²Prokurori i Specializuar i jep Mbrojtjes çdo informacion shfajësues të përmendur në rregullën 103, pavarësisht nga mbyllja e çështjes sipas rregullës 136, apo ndonjë apeli të mëpasshëm.

Kapitulli 8

Pjesëmarrja e viktimave në procedura

Rregulla 113

Pranimi si viktimë pjesëmarrëse në procedura

- (1) ¹Pas konfirmimit të aktakuzës nga gjykatësi i procedurës paraprake në bazë të rregullës 86 dhe në kohë të mjaftueshme përpara hapjes së çështjes në bazë të rregullës 124, një person që pretendon se është viktimë e një vepre penale të pretenduar në aktakuzë, mund të bëjë kërkesë për pranim si viktimë pjesëmarrëse në procedura, në të cilën saktëson se si i përmbush kriteret si viktimë dhe jep vendin dhe datën e veprës penale që pretendohet se ka shkaktuar dëm. ²Formularët e kërkesës nuk u bëhen të njohura palëve.
- (2) ¹Zyra e Pjesëmarrjes së Viktimave regjistron dhe vlerëson kërkesat dhe ia dorëzon trupit gjykues, së bashku me një rekomandim për pranueshmërinë dhe përfaqësimin e përbashkët, si dhe një kërkesë për masa mbrojtëse sipas rregullës 80, sipas rastit. ²Në të njëjtën kohë, Zyra e Pjesëmarrjes së Viktimave u dorëzon palëve një raport konfidencial lidhur me sa më sipër.
- (3) Palët mund të bëjnë parashtrime vetëm në lidhje me aspektin ligjor të pranueshmërisë dhe përfaqësimit të përbashkët.
- (4) Në marrjen e vendimit nëse një viktimë mund të marrë pjesë në procedura, trupi gjykues shqyrton nëse paraqitësi i kërkesës ka dhënë prova *prima facie* për dëmin e pësuar si rezultat i drejtpërdrejtë i një vepre penale të përfshirë në aktakuzë.
- (5) ¹Përpara hapjes së çështjes, trupi gjykues nxjerr një vendim të arsyetuar me anë të të cilit miraton ose refuzon pranimin dhe përfaqësimin e përbashkët në procedura, si dhe çfarëdo kërkesë për masa mbrojtëse sipas rregullës 80, sipas rastit. ²Vendimi u njoftohet paraqitësit të kërkesës, Zyrës së Pjesëmarrjes së Viktimave dhe palëve.
- (6) ¹Personave të cilëve u refuzohet kërkesa kanë të drejtën e apelimit të vendimit brenda katërmbëdhjetë (14) ditësh me ndihmën, sipas nevojës, të Mbrojtësit nga Lista e Mbrojtësve të Viktimave, që u caktohet si grup. ²Palët mund të kërkojnë leje për apelim të vendimit sipas rregullës 77, por vetëm mbi bazën e gabimeve ligjore.
- (7) Kur viktimave u miratohet e drejta e pjesëmarrjes në procedura, grupit të viktimave pjesëmarrëse në procedura Administratori i cakton një Mbrojtës të Viktimave në përputhje me Direktivën për Mbrojtësit.
- (8) Pasi konsultohet me Zyrën e Pjesëmarrjes së Viktimave, trupi gjykues vendos nëse viktimat pjesëmarrëse në procedura të ndahen në grupe me përfaqësim të përbashkët, duke marrë parasysh:
 - (a) çfarëdo konflikti interesash që mund të pengojë përfaqësimin e përbashkët;
 - (b) interesa të ngjashme që mund të lehtësojnë përfaqësimin e përbashkët; dhe
 - (c) të drejtat e të akuzuarit dhe interesat për një gjykim të shpejtë e të drejtë.

- (9) Çdo person i identifikuar në një aktgjykim të formës së prerë si viktimë që ka pësuar dëm të drejtpërdrejtë si pasojë e kryerjes së veprave penale nga një i akuzuar i shpallur fajtor nga Dhomat e Specializuara, mund t'i kërkojë Administratorit një kopje të legalizuar të aktgjykimit për të ushtruar të drejtat e veta sipas legjislacionit shtetëror apo ndonjë legjislacioni tjetër përkatës, në përputhje me nenin 22(9) të Ligjit.

Rregulla 114

Modalitetet e pjesëmarrjes në procedurën gjyqësore

- (1) Viktimat pjesëmarrëse në procedura ushtrojnë të drejtat e tyre përmes një Mbrojtësi të Viktimave që u caktohet, gjatë të gjitha fazave të procedurave gjyqësore në përputhje me nenet 22(6) dhe 46(9) të Ligjit.
- (2) Mbrojtësi i Viktimave ka të drejtën të bëjë deklaratat hyrëse dhe përmbyllëse dhe mund të jetë i pranishëm në procedurën paraprake dhe të gjykit, nëse trupi gjykues e çmon të arsyeshme, me qëllim garantimin e interesave personale dhe të drejtave të viktimave pjesëmarrëse në procedura, në përputhje me nenin 22(3) të Ligjit.
- (3) ¹Mbrojtësi i Viktimave ka qasje në materiale konfidenciale, përveç nëse Rregullorja parashikon ndryshe, ose sipas vendimit të trupit gjykues. ²Mbrojtësi i Viktimave i informon rregullisht klientët për zhvillimet përkatëse në lidhje me çështjen gjyqësore, në një mënyrë që nuk zbulon informacione konfidenciale.
- (4) ¹Kurdoherë që preken interesat personale të viktimave pjesëmarrëse në procedura dhe nëse Rregullorja nuk e parashikon ndryshe, Mbrojtësi i Viktimave, nën mbikëqyrjen e trupit gjykues:
- bën parashtrime me gojë dhe me shkrim, dhe
 - u bën pyetje dëshmitarëve.

²Nëse është e nevojshme dhe varësisht nga rrethanat, trupi gjykues nxjerr udhëzime të posaçme që rregullojnë pjesëmarrjen e viktimave në procedura, në pajtim me nenet 22(3) dhe (6) të Ligjit.

- (5) ¹Nëse palët nuk kanë dorëzuar prova, ose provat e paraqitura nuk e trajtojnë aq sa duhet ndikimin e veprave penale të pretenduara mbi interesat personale të viktimave pjesëmarrëse në procedura, Mbrojtësi i Viktimave mund t'i kërkojë trupit gjykues të urdhërojë dorëzimin e provave përkatëse ose të thërrasë dëshmitarët për të dhënë dëshmi. ²Në këto raste, trupi gjykues mund t'i japë urdhër Mbrojtësit të Viktimave t'u bëjë të njohura palëve materialet përkatëse, nëse këto materiale janë nën ruajtjen dhe kontrollin e Mbrojtësit të Viktimave.

Kapitulli 9

Procedura e gjykimit

Pjesa I: Përgatitja dhe administrimi i procedurës së gjykimit

Rregulla 115

Caktimi i trupit gjykues

- (1) ¹Bazuar në nenin 33(1)(b) të Ligjit, Kryetari cakton një trup gjykues sa më shpejt që të jetë e mundshme. ²Pas hapjes së çështjes gjyqësore sipas rregullës 124, në çdo fazë të gjykimit është i pranishëm një gjykatës rezervë. Për procedurën sipas nenit 15(2) të Ligjit, Kryetari cakton një trup gjykues të përbërë nga një gjykatës i vetëm.
- (2) Gjithashtu, Kryetari mund të ricaktojë një trup gjykues të formuar më parë, në rast se është e nevojshme, në përputhje me Rregulloren.

Rregulla 116

Administrimi i procedurës dhe konferencat për ecurinë e çështjes

- (1) ¹Trupi gjykues merr vazhdimisht të gjitha masat dhe miraton procedurat e nevojshme për lehtësimin e kryerjes së drejtë e të shpejtë të gjykimit. ²Pas këshillimit me palët, trupi gjykues përcakton një plan pune që tregon detyrimet e palëve dhe cakton afate për plotësimin e këtyre detyrimeve.
- (2) ¹Shpejt pas caktimit sipas rregullës 117, trupi gjykues mban një konferencë përgatitore për gjykimin. ²Brenda tridhjetë (30) ditësh pas mbajtjes së konferencës përgatitore për gjykimin, ose mbi bazën e datës që ka caktuar vetë, trupi gjykues mban konferencë përgatitore për Prokurorin e Specializuar në bazë të rregullës 118. ³Në qoftë se Mbrojtja vendos të paraqesë prova, trupi gjykues mban një konferencë përgatitore për Mbrojtjen në bazë të rregullës 119.
- (3) Para hapjes së çështjes dhe pasi të ketë dëgjuar palët dhe, kur është e zbatueshme, Mbrojtësin e Viktimave, trupi gjykues mund të japë udhëzime që i gjykon të nevojshme për kryerjen e procedurave që garantojnë një gjykim të drejtë, të paanshëm dhe të shpejtë.
- (4) ¹Pas këshillimeve me anëtarët e tjerë të trupit gjykues, kryetari i trupit gjykues mund të nxjerrë urdhra dhe vendime për administrimin e gjykimit bazuar në rregullën 15(4). ²Trupi gjykues mund të lëshojë çfarëdo urdhrash apo vendimesh të nevojshme për garantimin e një gjykimi të drejtë, të paanshëm, e të shpejtë. ³Urdhrat apo vendimet e tilla mund të jenë, ndër të tjera, në lidhje me:
 - (a) detyrimet për nxjerrjen e materialit;
 - (b) masa mbrojtëse për dëshmitarët dhe viktimat pjesëmarrëse në procedura;
 - (c) komunikimet midis palëve dhe dëshmitarëve;
 - (d) kushtet e paraburgimit dhe çështje që kanë lidhje me to; dhe
 - (e) çfarëdo çështjesh të tjera përgatitore të nevojshme.

- (5) Trupi gjykues mund të këshillohet me palët për çfarëdo temash që kanë lidhje me çështjen gjyqësore duke organizuar konferenca për ecurinë e çështjes që i gjykon të nevojshme.

Rregulla 117

Konferenca përgatitore për gjykimin

- (1) Pas marrjes së dosjes së çështjes në bazë të rregullës 98, trupi gjykues mban një konferencë përgatitore për gjykimin me palët dhe, kur është e zbatueshme, me Mbrojtësin e Viktimave.
- (2) ¹Në konferencë përgatitore për gjykimin dhe pasi të ketë dëgjuar palët, trupi gjykues përcakton një afat për çfarëdo mocioni që do të dorëzohet para hapjes së çështjes. ²Për mocione të tilla vendoset para hapjes së çështjes, përveç se kur trupi gjykues për arsye të vlefshme e shtyn vendimin. ³Cilado palë që nuk paraqet kundërshtime, ose kërkesa para fazës së gjyimit brenda afatit të përcaktuar nga kryetari i trupit gjykues, nuk lejohet të paraqesë kundërshtime apo kërkesa të tilla, përveç se kur tregon arsye të vlefshme.
- (3) Trupi gjykues cakton një afat brenda të cilit Mbrojtja bën të ditur nëse ka vendosur:
- të bëjë deklaratë hyrëse menjëherë pas deklaratës hyrëse të Prokurorit të Specializuar dhe, aty ku është e zbatueshme, të Mbrojtësit të Viktimave;
 - të bëjë deklaratë hyrëse pas përfundimit të paraqitjes së provave prej Prokurorit të Specializuar dhe para nisjes së paraqitjes së provave të Mbrojtjes; ose
 - të mos bëjë deklaratë hyrëse.

Rregulla 118

Konferencë përgatitore për Prokurorin e Specializuar

- (1) Në konferencën përgatitore për Prokurorin e Specializuar dhe pasi të ketë dëgjuar palët, trupi gjykues mund:
- të përcaktojë numrin e dëshmitarëve që Prokurori i Specializuar mund të thërrasë dhe të udhëzojë Prokurorin e Specializuar të heqë dëshmitarët përsëritës;
 - t'i kërkojë Prokurorit të Specializuar që të pakësojë numrin, ose të zvogëlojë kuadrin e akuzave në aktakuzë, në qoftë se është e zbatueshme;
 - të ftojë Prokurorin e Specializuar të përcaktojë numrin e vendeve të krimeve, ose të ngjarjeve të përmendura në një ose më shumë akuza në lidhje me të cilat Prokurori i Specializuar mund të paraqesë prova, të cilat pasqyrojnë në masë të arsyeshme veprën penale të akuzuar, duke marrë parasysh rrethanat përkatëse, përfshirë edhe veprat penale të akuzuara, klasifikimin, shkallën dhe llojin e tyre, vendet ku pretendohet se janë kryer dhe viktimat e krimeve;
 - të përcaktojë kohën në dispozicion të Prokurorit të Specializuar për paraqitjen e provave;
 - të kërkojë prej Prokurorit të Specializuar që të shkurtojë kohëzgjatjen e përllogaritur të pyetjeve për cilindo dëshmitar të identifikuar në listën e dëshmitarëve të Prokurorit të Specializuar dorëzuar gjykatësit të procedurës paraprake sipas rregullës 95(4)(b); dhe

- (f) të verifikojë nëse palët kanë plotësuar detyrimet për nxjerrjen e materialit.
- (2) Pasi merr njoftim në kohë dhe i tregohen arsye të vlefshme, trupi gjykues mund të lejojë ndryshim të listave të dëshmitarëve dhe të provave materiale dorëzuar sipas rregullës 95(4)(b).
- (3) ¹Trupi gjykues cakton datën për hapjen e çështjes të cilën e bën publike, si edhe çfarëdo shtyrje të kësaj date. ²Data e hapjes së çështjes është tridhjetë (30) ditë pas konferencës përgatitore për Prokurorin e Specializuar.
- (4) Pasi të ketë dëgjuar palët dhe duke marrë parasysh dosjet paraprake, kryetari i trupit gjykues shënon pikat faktike dhe ligjore për të cilat palët pajtohen.
- (5) Para fillimit të hapjes së çështjes sipas rregullës 124, trupi gjykues cakton një datë të parashikuar për përfundimin e paraqitjes së provave prej Prokurorit të Specializuar sipas rregullës 129 dhe në qoftë se është e mundshme, për mbylljen e çështjes sipas rregullës 136.

Rregulla 119

Paraqitja e provave prej Mbrojtjes dhe konferenca përgatitore për Mbrojtjen

- (1) Më së voni, në përfundimin e paraqitjes së provave prej Prokurorit të Specializuar, ose pas një vendimi sipas rregullës 130, nëse është marrë një vendim i tillë, Mbrojtja vendos nëse do të paraqesë prova dhe informon trupin gjykues në lidhje me këtë.
- (2) Në rast se Mbrojtja vendos të paraqesë prova, trupi gjykues urdhëron dorëzimin e:
- (a) listës së dëshmitarëve të cilët Mbrojtja synon të thërrasë, përfshirë:
- (i) kohëzgjatjen e gjithsejtë të përlllogaritur për paraqitjen e provave prej Mbrojtjes;
 - (ii) numrin e gjithsejtë të dëshmitarëve ku përfshihet edhe numri i dëshmitarëve që do të dëshmojnë për çdo të akuzuar dhe në lidhje me çdo akuzë;
 - (iii) emrin ose pseudonimin e secilit dëshmitar;
 - (iv) një përmbledhje të fakteve në lidhje me të cilat pritet të dëshmojë secili dëshmitar;
 - (v) pretendimet në aktakuzë në lidhje me të cilat pritet të dëshmojë secili dëshmitar, duke përmendur konkretisht akuzat dhe paragrafët përkatës të aktakuzës;
 - (vi) informacion nëse dëshmitari do të dëshmojë duke qenë fizikisht i pranishëm, ose do të dëshmojë nëpërmjet mënyrave të tjera të parapara në Rregullore; dhe
 - (vii) një përlllogaritje të kohëzgjatjes së gjithsejtë të pyetjeve të palës thirrëse të dëshmitarit për atë dëshmitar; dhe
- (b) listës së provave materiale që Mbrojtja propozon të paraqesë në të cilën të bëhet i ditur kurdoherë që është e mundshme, çfarëdo kundërshtimi i Prokurorit të Specializuar në lidhje me autenticitetin e këtyre provave.
- (3) Brenda shtatë (7) ditësh pas dorëzimit të materialeve të Mbrojtjes të përmendura në paragrafin 2, trupi gjykues mban një konferencë përgatitore për Mbrojtjen gjatë së cilës, pasi të ketë dëgjuar palët, trupi gjykues mund:

- (a) të përcaktojë numrin e dëshmitarëve që mund të thërrasë Mbrojtja dhe të udhëzojë Mbrojtjen të heqë dëshmitarët përsëritës;
 - (b) të përcaktojë kohën në dispozicion të Mbrojtjes për paraqitjen e provave;
 - (c) të kërkojë prej Mbrojtjes që të shkurtojë kohëzgjatjen e përlogaritur të pyetjeve për cilindo dëshmitar të identifikuar në listën e dëshmitarëve të Mbrojtjes dorëzuar sipas paragrafit(2)(a);
 - (d) të verifikojë nëse palët kanë plotësuar detyrimet për nxjerrjen e materialit; dhe
 - (e) të japë çfarëdo udhëzimi shtesë të nevojshëm për garantimin e një gjykimi të drejtë e të shpejtë.
- (4) ¹Në konferencën përgatitore për Mbrojtjen, trupi gjykues cakton një datë për nisjen e paraqitjes së provave prej Mbrojtjes, brenda tridhjetë (30) ditësh pas konferencës përgatitore për Mbrojtjen dhe gjithsesi, pas përfundimit të paraqitjes së provave prej Prokurorit të Specializuar sipas rregullës 129. ²Trupi gjykues cakton data të parashikuara për përfundimin e paraqitjes së provave prej Mbrojtjes sipas rregullës 131 dhe në qoftë se është e mundshme për mbylljen e çështjes, sipas rregullës 136.
- (5) Pasi merr njoftim në kohë dhe i tregohen arsye të vlefshme, trupi gjykues mund të lejojë ndryshim të listave të dëshmitarëve dhe të provave materiale dorëzuar sipas paragrafit (2.)

Rregulla 120

Seancat e hapura, private dhe me dyer të mbyllura

- (1) Çdo procedurë gjyqësore para një trupi gjykues, veç kuvendimeve, është publike, përveç se kur trupi gjykues vendos për të kundërtën pasi të ketë dëgjuar palët.
- (2) ¹Seancat me dyer të mbyllura mbahen *in camera*, pa publikun dhe pa transmetim të pamjeve dhe të zërit nga salla e gjyqit. Seanca të tilla urdhërohen vetëm në rrethana të veçanta. ²Seancat private mbahen *in camera*, pa transmetim zanor për publikun jashtë sallës së gjyqit. ³Mbajtja e këtyre seancave urdhërohet vetëm në rrethana të veçanta. Arsyet për mbajtjen e seancave me dyer të mbyllura ose private shqiptohen publikisht.
- (3) Trupi gjykues mund të urdhërojë seanca me dyer të mbyllura ose private, sipas rrethanave, për arsye të:
- (a) rendit publik;
 - (b) sigurisë;
 - (c) interesave të sigurisë shtetërore të Kosovës ose të një shteti të tretë;
 - (d) moszbulimit të identitetit të një dëshmitari ose një viktime pjesëmarrëse në procedura sikurse parashihet në rregullën 80; ose
 - (e) interesave të drejtësisë.

Rregulla 121**Dëshmitarët e thirrur ose që marrin fletëthirrje për paraqitje në gjyq**

- (1) Secila palë ka përgjegjësi të thërrasë dëshmitarët e vet në përputhje me listën e vet të dëshmitarëve.
- (2) Në qoftë se Prokurori i Specializuar thërret një dëshmitar dhe dëshmitari nuk i përgjigjet thirrjes, Prokurori i Specializuar ka përgjegjësi t'i dërgojë një urdhërparaqitje atij dëshmitari.
- (3) Në çfarëdo rastesh të tjera të mosbindjes së dëshmitarit, trupi gjykues i dërgon atij dëshmitari një fletëthirrje për paraqitje në gjyq, mbi bazën e një kërkesë ose *proprio motu*.
- (4) Në qoftë se një dëshmitar nuk ndodhet në Kosovë dhe paraqitja e tij në gjyq nuk mund të sigurohet nëpërmjet fletëthirrjes, Prokurori i Specializuar dhe Administratori kërkojnë bashkëpunimin e shteteve të treta për të mundësuar praninë e dëshmitarit në procedurën e gjykimit sipas nenit 55 të Ligjit dhe rregullës 208.
- (5) Kur thirren ose urdhërohen për paraqitje në gjyq, dëshmitarët udhëzohen që të mos komunikojnë me njëri-tjetrin në lidhje me dëshmitë e tyre, ose në lidhje me çështjen gjyqësore.

Rregulla 122**Mosbindja e dëshmitarit ndaj fletëthirrjes për paraqitje**

- (1) Në qoftë se një dëshmitar i thirrur për paraqitje në gjyq në bazë të rregullave, pa ndonjë arsye të vlefshme nuk paraqitet në gjyq, trupi gjykues, duke mbajtur parasysh rregullën 121(4), mund të urdhërojë ose të kërkojë që dëshmitari të paraqitet në një datë të përcaktuar prej trupit gjykues, dhe e informon dëshmitarin se mosparaqitja mund të ndëshkohet në përputhje me nenin 15(2) dhe 42(7) të Ligjit, dhe rregullën 65.
- (2) Trupi gjykues mund të vendosë për vijimin e gjykimit në mungesë të dëshmitarit, ose për shtyrjen e gjykimit deri në paraqitjen e dëshmitarit në gjyq.

Rregulla 123**Shtyrja e procedurës**

- (1) Kryetari i trupit gjykues mund të urdhërojë shtyrjen e procedurës me jo më shumë se njëzet e një (21) ditë për të mundësuar mbledhjen e provave të caktuara, paraqitjen e dëshmitarit ose përgatitjen e Prokurorit të Specializuar ose të Mbrojtjes, ose për çfarëdo arsye tjetër që përlligj shtyrjen.
- (2) ¹Trupi gjykues mund të shtyjë gjykimin për një periudhë më të gjatë se njëzet e një (21) ditë, për arsye të bazuara. ²Për këtë shtyrje, trupi gjykues nxjerr një vendim të arsyetuar, ku, në qoftë se është e mundshme, saktësohet data për rinisjen e gjykimit. ³Trupi gjykues mund të caktojë seanca të herëpashershme për të diskutuar ecurinë e çështjes, për probleme që presin përgjigje dhe për të mundësuar rinisjen në kohë të gjykimit.

- (3) Gjatë periudhave të pushimit të përcaktuara nga Kryetari sipas rregullës 13(1)(d), përveç se kur është vendosur ndryshe nga trupi gjykues, seancat mbahen vetëm për çështje të ngutshme dhe afatet nuk pezullohen.

Pjesa II: Procedimi i çështjes gjyqësore

Rregulla 124

Hapja e çështjes gjyqësore

- (1) Kryetari i trupit gjykues hap gjykimin dhe i kërkon Administratorit të deklarojë lëndën e çështjes.
- (2) Më pas, gjykimi vijon me leximin prej Prokurorit të Specializuar të aktakuzës së konfirmuar nga gjykatësi i procedurës paraprake, ose të ndryshuar me kërkesë të trupit gjykues në përputhje me rregullën 118(1)(b), ose në përputhje me rregullën 90.
- (3) Pasi bindet se i akuzuari e ka kuptuar aktakuzën, kryetari i trupit gjykues i jep të akuzuarit mundësinë që të konfirmojë deklaratën e vetë fillestare në lidhje me fajësinë ose pafajësinë.

Rregulla 125

Informacioni fillestar për të akuzuarin

- (1) Kryetari i trupit gjykues e informon të akuzuarin për:
 - (a) të drejtën për të heshtur që nuk do të jetë faktor gjatë përcaktimit të fajësisë ose pafajësisë së të akuzuarit;
 - (b) të drejtën se nuk detyrohet të pranojë fajësinë apo të dëshmojë, ose të fajësojë vetveten apo familjarë të tij të afërt;
 - (c) të drejtën e përfaqësimit nga një Mbrojtës i emëruar ose i caktuar; dhe
 - (d) çfarëdo të drejte tjetër thelbësore që konsiderohet e nevojshme për mbrojtjen e të akuzuarit.
- (2) I akuzuari informohet për detyrimet e veta dhe masat e parapara në rregullën 61(2).

Rregulla 126

Deklaratat hyrëse

- (1) ¹Para paraqitjes së provave nga Prokurori i Specializuar, palët dhe Mbrojtësi i Viktimave mund të bëjnë deklaratat hyrëse. ²Këto deklaratat bëhen gojarisht dhe janë vetëm një përmbledhje e përgjithshme e lëndës së çështjes. ³Gjithashtu në këto deklaratat mund të jepet një shpjegim përmbledhës i dëshmive që do të paraqiten dhe se në çfarë mënyre këto dëshmi ndikojnë në pika të ndryshme të çështjes. ⁴Trupi gjykues mund të kufizojë kohëzgjatjen e deklaratave hyrëse.

- (2) Mbrojtja mund të vendosë të bëjë deklaratën hyrëse, ose pas deklaratës hyrëse të Prokurorit të Specializuar, ose pas përfundimit të paraqitjes së provave nga Prokurori i Specializuar dhe para paraqitjes së provave nga Mbrojtja.
- (3) ¹Mbrojtësi i Viktimave mund të bëjë një deklaratë hyrëse në emër të viktimave pjesëmarrëse në procedura në lidhje me interesin e tyre personal për çështjen, në përputhje me nenin 22 (3) dhe (6) të Ligjit. ²Deklarata hyrëse e Mbrojtësit të Viktimave bëhet pas deklaratës hyrëse të Prokurorit të Specializuar dhe para deklaratës hyrëse të Mbrojtësit të Specializuar, nëse Mbrojtësi i Specializuar bën një deklaratë të tillë.

Rregulla 127

Paraqitja e provave

- (1) Palët kanë të drejtë të paraqesin prova që kanë lidhje me çështjen gjyqësore.
- (2) Provat gjatë gjykimit paraqiten në renditjen e mëposhtme, përveç se kur urdhërohet ndryshe nga trupi gjykues:
 - (a) prova të Prokurorit të Specializuar;
 - (b) prova të Mbrojtjes;
 - (c) prova të kërkuara nga trupi gjykues sipas rregullës 132;
 - (d) me autorizim të trupit gjykues, kundërprova të Prokurorisë; dhe
 - (e) me autorizim të trupit gjykues, kundërprova të Mbrojtjes.
- (3) ¹Dëshmitari i thirrur për t'u paraqitur para trupit gjykues, fillimisht pyetet nga pala thirrëse, më tej pyetet nga pala kundërshtare, në qoftë se kjo palë vendos të ushtrojë të drejtën e vet. ²Pyetjet nga pala thirrëse dhe nga pala kundërshtare lejohen në çdo çështje. ³Trupi gjykues mund të lejojë pyetje plotësuese të palës thirrëse, në qoftë se konsiderohet e nevojshme. ⁴Një gjykatës mund t'i bëjë pyetje dëshmitarit në çdo fazë.

Rregulla 128**Transferimi i dëshmitarëve të paraburgosur për të dëshmuar në Dhomat e Specializuara**

- (1) Në qoftë se një person prej të cilit Dhomat e Specializuara, ose njëra prej palëve, kërkojnë të dëshmojë, është i paraburgosur, trupi gjykues mund të urdhërojë transferimin e tij të përkohshëm në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara, ose të kërkojë organizimin e dhënies së dëshmisë nëpërmjet videokonferencës, duke saktësuar për çdo rast masat e nevojshme që mundësojnë kushte të favorshme për dhënien e dëshmisë me vërtetësi dhe në mënyrë të hapur, si edhe për sigurinë, mirëqenien fizike dhe psikologjike, dinjitetin dhe privatësinë e personit që do të dëshmojë.
- (2) Në qoftë se autoritetet e një shteti të tretë, nën juridiksionin dhe kontrollin e të cilit mbahet në paraburgim dëshmitari, kundërshtojnë procedurën e lartpërmendur, trupi gjykues informon Administratorin i cili mund të marrë çdo masë të nevojshme, përfshirë edhe negociatat për arritjen e zgjidhjes së nevojshme.

Rregulla 129**Mbyllja e paraqitjes së provave prej Prokurorit të Specializuar**

Në qoftë se nuk ka dëshmitarë të tjerë për të thirrur apo prova të tjera për të paraqitur, Prokurori i Specializuar e mbyll paraqitjen e provave të veta.

Rregulla 130**Rrëzimi i akuzave**

- (1) Menjëherë pas mbylljes së paraqitjes së provave prej Prokurorit të Specializuar, Mbrojtja e informon trupin gjykues për synimin e vet mbi dorëzimin e një mocioni për rrëzimin e ndonjë akuze, apo të gjitha akuzave në aktakuzë.
- (2) ¹Mocione të tilla dorëzohen brenda dhjetë (10) ditësh nga mbyllja e paraqitjes së provave prej Prokurorit të Specializuar. ²Prokurori i Specializuar mund të paraqesë përgjigje brenda dhjetë (10) ditësh nga dorëzimi i mocionit. ³Mbrojtja nuk ka të drejtë të paraqesë kundërpërgjigje. ⁴Trupi gjykues mund të dëgjojë argumentet gojore të palëve dhe nëse është e zbatueshme, të Mbrojtësit të Viktimave, argumente të cilat mund t'i lejojë për një ose disa akuza konkrete.
- (3) Pasi të ketë dëgjuar palët dhe, nëse është e zbatueshme, Mbrojtësin e Viktimave, nëpërmjet një vendimi që e shqipton gojarisht trupi gjykues mund të rrëzojë disa, ose të gjitha akuzat e aktakuzës, në qoftë se nuk ekzistojnë prova në mbështetje të një vendimi fajësie jashtë dyshimit të arsyeshëm në lidhje me akuzat në fjalë.
- (4) ¹Prokurori i Specializuar ka të drejtën të apelojë një vendim që rrëzon aktakuzën apo çfarëdo akuze të saj në bazë të rregullës 170. ²Mbrojtja nuk ka të drejtë të apelojë vendime që refuzojnë kërkesa për rrëzimin e aktakuzës.

Rregulla 131**Mbyllja e paraqitjes së provave prej Mbrojtjes**

Në qoftë se nuk ka më shumë dëshmitarë që do të thirren, apo prova të tjera për paraqitje në mbrojtje të cilitdo të akuzuar, Mbrojtësi i Specializuar mbyll paraqitjen e provave prej Mbrojtjes.

Rregulla 132**Prova të kërkuara nga trupi gjykues**

Pasi të ketë dëgjuar palët dhe kur është e zbatueshme, Mbrojtësin e Viktimave, trupi gjykues mund të kërkojë parashtrimin e provave shtesë, ose *proprio motu* të thërrasë dëshmi shtesë që nuk janë paraqitur nga palët, ndër të cilat dëshmi ekspertësh, në rast se e gjykon të nevojshme për përcaktimin e të vërtetës.

Rregulla 133**Mocione për plotësimin e seancave të paraqitjes së provave**

¹Pas mbylljes së paraqitjes së provave prej Mbrojtjes sipas rregullës 131, ose pasi të jenë dëgjuar dëshmitë e thirrura nga trupi gjykues sipas rregullës 132, kryetari i trupit gjykues i pyet palët nëse kanë mocione për paraqitje kundërprovash sipas rregullës 127. ²Dhënia e dëshmime të tilla autorizohet vetëm në interes të drejtësisë dhe në rrethana të posaçme.

Rregulla 134**Mbyllja e procedurës së paraqitjes së provave**

Pasi të ketë vendosur në lidhje me mocione të rregullës 133 dhe pas dëgjimit të dëshmime të tilla, në rast se jepen, trupi gjykues:

- (a) deklaron mbylljen e procedurës së paraqitjes së provave;
- (b) fton Prokurorin e Specializuar dhe Mbrojtjen që të dorëzojnë dosjet gjyqësore përfundimtare brenda tridhjetë (30) ditësh;
- (c) fton Mbrojtësin e Viktimave të dorëzojë një deklaratë në lidhje me pasojat e veprave penale të pretenduara ndaj viktimave pjesëmarrëse në procedura brenda tridhjetë (30) ditësh; dhe
- (d) cakton një seancë për deklaratat përmbyllëse që mbahet brenda njëzet e një (21) ditësh pas dorëzimit të dosjeve dhe deklaratës ose deklaratave të përmendura në (b) dhe (c).

Rregulla 135**Deklaratat përmbyllëse**

- (1) ¹Prokurori i Specializuar është i pari që bën deklaratën përmbyllëse e pas tij vijojnë me deklaratat e tyre Mbrojtësi i Viktimave dhe Mbrojtësi i Specializuar. ²Trupi gjykues mund të kufizojë kohëzgjatjen e deklaratave përmbyllëse.

- (2) ¹Në deklaratat përmbyllëse mund të përmenden dëshmitë e pranuar dhe besueshmëria e tyre, besueshmëria e dëshmitarëve, dokumentacioni i procesit dhe ligji në fuqi. ²Mund të përdoret edhe material ilustrues dhe përmbledhje të dëshmimeve, në qoftë se janë të bazuara në provat e pranuar.
- (3) Trupi gjykues mund të kërkojë sqarime për çfarëdo problemi të ngritur në dosjet gjyqësore përfundimtare.
- (4) ¹Prokurori i Specializuar ka të drejtë të kthejë përgjigje. ²Mbrojtësi i Specializuar ka të drejtë të bëjë vërejtje në lidhje me përgjigjet përkatëse. I akuzuari ka të drejtë të marrë fjalën i fundit.

Rregulla 136**Mbyllja e çështjes**

- (1) Pas deklaratave përmbyllëse, kryetari i trupit gjykues e deklaron çështjen të mbyllur.
- (2) Në këtë fazë, trupit gjykues nuk mund t'i paraqitet asnjë parashtrim tjetër, përveç se në rrethana të posaçme dhe duke treguar arsye të vlefshme.
- (3) Në këtë fazë trupi gjykues nuk mund të pranojë asnjë parashtrim, apo të dëgjojë dëshmi të tjera, përveç nëse diktohet prej rrethanave të posaçme.

Pjesa III: Provat***Nënpjesa 1: Pranueshmëria dhe vlerësimi i provave*****Rregulla 137****Dispozita të përgjithshme**

- (1) ¹Palët mund të parashtrojnë prova që kanë lidhje me çështjen. ²Në pajtim me rregullën 132, trupi gjykues mund të urdhërojë paraqitjen e provave, ose thirrjen e dëshmitarëve që gjykohen të nevojshme për përcaktimin e të vërtetës.
- (2) Një trup gjykues vlerëson lirisht të gjitha provat e paraqitura për të përcaktuar pranueshmërinë dhe rëndësinë e tyre.

Rregulla 138**Pranueshmëria e provave**

- (1) ¹Në rast se nuk janë kundërshtuar ose përjashtuar *proprio motu*, provat e paraqitura trupit gjykues, pranohen vetëm në qoftë se kanë lidhje me lëndën, kanë vlerë provuese dhe vlera provuese e tyre nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të tyre. ²Në rrethana të posaçme, në qoftë se trupi gjykues bindet se një çështje nuk ishte e njohur në kohën e paraqitjes së provës, kjo çështje ngrihet menjëherë pasi bëhet e njohur.

- (2) Provat e siguruar nëpërmjet një shkeljeje të Ligjit, ose të Rregullores, apo normave të së drejtës ndërkombëtare janë të papranueshme në qoftë se:
 - (a) shkelja hedh dyshim thelbësor mbi besueshmërinë e provës; ose
 - (b) pranimi i provës do të ishte shkelje, ose do të dëmtonte rëndë ndershmërinë e procedurave.
- (3) Provat e siguruar me anë të torturës, apo të çfarëdo forme të trajtimit çnjerëzor ose poshtëruës, janë të papranueshme dhe përjashtohen.
- (4) Trupi gjykues mund të kërkojë verifikimin e autenticitetit të provave jashtëgjyqësore, varësisht prej nenit 37(5) të Ligjit.

Rregulla 139

Vlerësimi i provave në kuadër të vendimit të gjykimi

- (1) Provat e shpallura të papranueshme, nuk merren parasysh nga trupi gjykues.
- (2) ¹Trupi gjykues vlerëson secilën provë duke mbajtur parasysh tërësinë e provave të administruara në gjykim. ²Gjatë shqyrtimit nëse janë vërtetuar pretendimet faktike, trupi gjykues bën një vlerësim dhe peshim tërësor duke i marrë provat në tërësi.
- (3) Në varësi prej rregullës 140(4), trupi gjykues nuk vendos kushtin ligjor të konfirmimit për vërtetimin e veprave penale apo veprimeve kriminale nën juridiksionin e Dhomave të Specializuara, në veçanti në lidhje me dhunën seksuale.
- (4) Gjatë përcaktimit të rëndësisë që i kushtohet dëshmisë së një dëshmitari, trupi gjykues vlerëson besueshmërinë e dëshmitarit dhe nëse mund të bazohet në dëshminë e dëshmitarit në fjalë.
- (5) Provat rrethore vlerësohen me kujdes dhe vëmendje dhe ofrohen konstatime të arsyetuara, në veçanti në lidhje me përputhshmërinë dhe lidhjen e brendshme logjike të provave të tilla, në qoftë se trupi gjykues e bazon vendimin e fajësisë vetëm mbi këto prova, ose kryesisht mbi këto prova.
- (6) ¹Mospërputhshmëritë e një dëshmie nuk e bëjnë trupin gjykues që ta përjashtojë automatikisht atë dëshmi si jo të besueshme. ²Trupi gjykues mund të pranojë pjesë të një dëshmie dhe të mos pranojë pjesë të tjera të asaj dëshmie.
- (7) Trupi gjykues merr parasysh mënyrën e mbledhjes së provave dhe efektin e mundshëm të saj në ecurinë dhe drejtësinë e paanshmërinë e procedurave.

Rregulla 140

Standardi i vërtetimit

- (1) Trupi gjykues mund të shpallë një të akuzuar fajtor, në qoftë se fajësia vërtetohet jashtë dyshimit të arsyeshëm.

- (2) ¹Standardi i vërtetimit jashtë dyshimit të arsyeshëm zbatohet për faktet që përbëjnë elementet e veprës penale dhe të formës së përgjegjësive së të akuzuarit që përmban aktakuza, si dhe për fakte të tjera ku bazohet vendimi i shpalljes së fajësisë. ²Standardi i vërtetimit jashtë dyshimit të arsyeshëm nuk zbatohet veçazi për çdo provë.
- (3) ¹Sa u përket provave rrethanore, standardi i vërtetimit jashtë dyshimit të arsyeshëm, përmbushet vetëm në qoftë se përfundimi i nxjerrë prej këtyre provave është i vetmi përfundim i arsyeshëm që mund të nxirret prej provave të paraqitura. ²Në qoftë se provat mundësojnë nxjerrjen e më shumë se një përfundimi të arsyeshëm, atëherë standardi i vërtetimit jashtë dyshimit të arsyeshëm nuk përmbushet.
- (4) Shpallja e fajësisë nuk mund të bazohet vetëm, ose në një masë vendimtare në:
- (a) deklaratën e një dëshmitari të cilin Mbrojtja nuk ka pasur mundësi ta pyesë;
- (b) dëshmitë e dëshmitarëve identiteti i të cilëve nuk i është bërë i njohur Mbrojtjes; ose
- (c) dëshminë e një personi nën 18 vjeç, ose e një personi me aftësi gjykuese të dëmtuar dhe për të cilin trupi gjykues ka mendimin se nuk kupton domethënien e detyrimit për të treguar të vërtetën.

Nënpjesa 2: Dëshmitë gojore, deklaratat dhe prova të tjera

Rregulla 141

Dispozita të përgjithshme në lidhje me dëshmitë gojore të dëshmitarëve

- (1) ¹Dëshmitarët e japin dëshminë e tyre në gjyq duke qenë të pranishëm, përveç rasteve të parapara në rregullën 100. ²Trupi gjykues gjithashtu mund të lejojë dhënien e dëshmisë nëpërmjet videokonferencës sipas rregullës 144, si edhe paraqitjen e dëshmisë së dëshmitarit me shkrim ose në forma të tjera në përputhje me Ligjin dhe Rregulloren dhe në një mënyrë që nuk shkakton padrejtësi, apo që nuk është mospërputhëse me të drejtat e të akuzuarit.
- (2) Në varësi të paragrafit (3) dhe rregullës 149(5), para dhënies së dëshmisë, dëshmitari bën betimin solemn si vijon:
- “I ndërgjegjshëm për rëndësinë e dëshmisë sime dhe përgjegjësinë time ligjore, deklaroj solemnisht se do të them të vërtetën, krejt të vërtetën dhe vetëm të vërtetën dhe nuk do të mbaj të fshehtë asgjë për të cilën kam dijeni.”
- (3) Një person nën 18 vjeç, ose një person me aftësi gjykuese të dëmtuar dhe për të cilin trupi gjykues ka mendimin se nuk kupton domethënien e betimit solemn, mund të lejohet të dëshmojë pa e bërë betimin solemn, në qoftë se trupi gjykues ka mendimin se personi në fjalë është në gjendje të përshkruajë çështjet për të cilat ka dijeni dhe kupton domethënien e detyrimit për të treguar të vërtetën.
- (4) ¹Një dëshmitar i cili nuk është dëshmitar ekspert dhe që ende nuk ka dëshmuar, nuk lejohet të jetë i pranishëm gjatë dhënies së dëshmisë prej një dëshmitari tjetër. ²Një dëshmitar që ka dëgjuar dëshminë e një dëshmitari tjetër, nuk përjashtohet nga dhënia e dëshmisë vetëm për këtë arsye. ³Një person që ka marrë pjesë në hetimin e kryer prej një pale, nuk mund të ndalohet të thirret

për të dëshmuar me arsyetimin se ka qenë i pranishëm në sallën e gjyqit gjatë gjykimit, ose e ka përcjellë gjykimin në një mënyrë tjetër.

- (5) Trupi gjykues mund të refuzojë të dëgjojë një dëshmitar emri i të cilit nuk është në listën e dëshmitarëve të dorëzuar nga pala thirrëse sipas rregullës 95(4-5), rregullës 118(2) ose rregullës 119(2) dhe (5).
- (6) ¹Dëshmitari që del para trupit gjykues, ka detyrimin të dëshmojë, përveç nëse është përcaktuar ndryshe në Ligj dhe në Rregullore, në veçanti në rregullën 151. ²Për një dëshmitar i cili del para trupit gjykues dhe ka detyrimin të dëshmojë, zbatohet rregulla 65.
- (7) Pas dhënies së dëshmisë, dëshmitari del nga salla e gjyqit, përveçse kur urdhërohet ndryshe.

Rregulla 142 Deklaratat, marrja në pyetje dhe dhënia e dëshmisë prej të akuzuarit

- (1) Gjatë gjykimit i akuzuari mund të japë deklaratat pa betim që kanë lidhje me çështjen.
- (2) ¹Me kërkesë të Mbrojtësit të Viktimave ose *proprio motu*, trupi gjykues mund t'i bëjë pyetje konkrete të akuzuarit në cilëndo fazë të procesit. ²Para se të bëjë pyetjet, trupi gjykues e informon të akuzuarin se ka të drejtë të heshtë dhe se heshtja e të akuzuarit nuk do të përdoret si faktor kundër të akuzuarit.
- (3) ¹I akuzuari nuk detyrohet të bëjë betim solemn para dhënies së deklaratave ose të përgjigjeve ndaj pyetjeve të bëra. ²Gjykatësit vlerësojnë vlerën provuese të mundshme të deklaratave dhe përgjigjeve të të akuzuarit ndaj pyetjeve.
- (4) I akuzuari mund të dalë edhe dëshmitar, e në një rast të tillë zbatohet rregulla 141(1) dhe (2).

Rregulla 143

Marrja në pyetje e dëshmitarëve

- (1) ¹Pala pyetëse mund t'i bëjë pyetje dëshmitarit dhe t'i tregojë çfarëdo dokumenti apo prove tjetër në përputhje me Rregulloren. ²Në qoftë se një dëshmitar nuk mund të kujtojë faktet që ka dhënë në një deklaratë të mëparshme, me leje prej trupit gjykues, dëshmitari mund t'i tregohen dokumente për t'i freskuar kujtesën. ³Ky paragraf zbatohet *mutatis mutandis* kur Mbrojtësi i Viktimave u bën pyetje dëshmitarëve.
- (2) Me autorizim të trupit gjykues, pala thirrëse e një dëshmitari mund ta pyesë dëshmitarin për sa më poshtë në qoftë se ka lidhje me besueshmërinë e dëshmitarit:
 - (a) dëshmi të dhënë nga dëshmitari që është e pafavorshme për atë palë;
 - (b) një çështje për të cilën logjikisht mund të supozohet se dëshmitari ka dijeni dhe për të cilën sipas trupit gjykues, kur pyetet prej një pale dëshmitari nuk bën përpjekje të njëmendtë për të dëshmuar; dhe
 - (c) nëse dëshmitari ka dhënë një deklaratë të mëhershme mospërputhëse.
- (3) ¹Pyetjet nga pala kundërshtare përqendrohen vetëm në lëndën e pyetjeve të palës thirrëse dhe në aspekte që ndikojnë në besueshmërinë e dëshmitarit. ²Në rast se dëshmitari është në gjendje

të japë dëshmi që ka lidhje me argumentin e palës kundërshtare, dëshmitari mund të pyetet në lidhje me atë lëndë, me kusht që pala përkatëse t'i shpjegojë dëshmitarit llojin e argumentit.

- (4) Në bazë të kundërshtimit të ngritur prej një pale, ose *proprio motu*, kryetari i trupit gjykues mund të ushtrojë kontroll mbi mënyrën dhe rendin e pyetjes së dëshmitarëve dhe paraqitjen e provave me qëllim që:
- (a) pyetjet dhe paraqitja e provave të jenë efikase në përcaktimin e të vërtetës;
 - (b) të shmangen përsëritjet, harxhimi i panevojshëm i kohës dhe i mjeteve; dhe
 - (c) të shmangen keqtrajtimi psikologjik, ose frikësimi i dëshmitarëve.

Rregulla 144

Marrja në pyetje me videokonferencë

- (1) Me kërkesë të një pale ose kur është e zbatueshme, të Mbrojtësit të Viktimave, ose *proprio motu*, trupi gjykues mund të urdhërojë që dëshmia të jepet me videokonferencë, me kusht që nëpërmjet kësaj mënyre dëshmitari të pyetet si duhet.
- (2) Me ndihmën e Administratorit, trupi gjykues mundëson që vendi i zgjedhur për dhënien e dëshmisë me videokonferencë të jetë i përshtatshëm për dhënien e dëshmisë me vërtetësi dhe në mënyrë të hapur dhe të garantojë sigurinë, mirëqenien fizike dhe mendore, dinjitetin dhe privatësinë e dëshmitarit.
- (3) Trupi gjykues garanton që videokonferenca t'u mundësojë palëve dhe trupit gjykues t'i bëjnë pyetje dëshmitarit gjatë dhënies së dëshmisë.
- (4) Administratori mundëson zbatimin efikas dhe të shpejtë të çfarëdo urdhri sipas paragrafit (1).

Rregulla 145

Marrja në pyetje e dëshmitarëve jashtë vendit ku mbahet gjykimi

- (1) Në varësi të dispozitave të rregullës 74, një dëshmitar i thirrur, ose i urdhëruar për paraqitje në gjyq, mirëpo i cili nuk është në gjendje të vijë për shkak të një sëmundjeje të rëndë apo pengesave të tjera, mund të pyetet në vendin ku banon apo është nën kujdes, përveçse në rast kur dëshmia e tij tashmë është marrë dhe ruajtur në bazë të rregullës 100.
- (2) ¹Prokurori i Specializuar, Mbrojtja dhe kur është e zbatueshme, Mbrojtësi i Viktimave, informohen për kohën dhe vendin e marrjes në pyetje. ²Në qoftë se i akuzuari mbahet në paraburgim, trupi gjykues vendos nëse prania e të akuzuarit është e domosdoshme gjatë pyetjeve për dëshmitarin, me kusht që gjatë këtyre pyetjeve të jetë i pranishëm Mbrojtësi i Specializuar i të akuzuarit.

Rregulla 146**Marrja në pyetje e dëshmitarëve me aftësi të kufizuara të posaçme**

¹Gjatë marrjes në pyetje të një dëshmitari me aftësi të kufizuar të posaçme, ndër të cilat mund të përfshihen aftësi e kufizuar në shikim, dëgjim, të folur, apo në shkrim e lexim, mënyra e bërjes së pyetjeve përshtatet sipas nevojës. ²Në qoftë se është e nevojshme, trupi gjykues mund t'i kërkojë një personi që është në gjendje të komunikojë me dëshmitarin, që ta ndihmojë. ³Personi që ndihmon dëshmitarin, bën betim solemn.

Rregulla 147**Marrja në pyetje e dëshmitarëve anonimë**

- (1) Me kërkesë të një pale, ose kur është e zbatueshme, të Mbrojtësit të Viktimave, trupi gjykues mund të vendosë të pyesë një dëshmitar në mungesë të palëve dhe të Mbrojtësit të Viktimave, në qoftë se ekziston një rrezik serioz se:
 - (a) dëshmitari ose një person i afërt me dëshmitarin mund të humbasë jetën, ose të pësojë dëmim të rëndë fizik ose mendor si pasojë e zbulimit të identitetit të tij, dhe masa mbrojtëse të tjera për mbrojtjen e dëshmitarëve sikurse përcaktohet në rregullën 80, do të ishin të pamjaftueshme për parandalimin e një rreziku të tillë; ose
 - (b) zbulimi i identitetit ose përkatësisë së dëshmitarit mund të rrezikojë interesa madhorë të sigurisë kombëtare.
- (2) ¹Në rast se trupi gjykues e miraton kërkesën, palëve dhe kur është e zbatueshme, Mbrojtësit të Viktimave, u jepet mundësia t'i drejtojnë dëshmitarit pyetje të cilat nuk zbulojnë identitetin e dëshmitarit. ²Trupi gjykues ia kalon këto pyetje vetë dëshmitarit. ³Gjithashtu, trupi gjykues mund ta pyesë dëshmitarin *proprio motu*. ⁴Zbatohet rregulla 24, përveç nëse trupi gjykues urdhëron ndryshe.
- (3) ¹Trupi gjykues u jep palëve dhe kur është e zbatueshme, Mbrojtësit të Viktimave, përgjigjet e transkriptuara të dëshmitarit, ku është fshirë çfarëdo informacioni që zbulon ose rrezikon të zbulojë identitetin e dëshmitarit. ²Palët dhe, kur është e zbatueshme, Mbrojtësi i Viktimave, mund t'i dorëzojnë trupit gjykues pyetje shtesë për dëshmitarin.
- (4) ¹Trupi gjykues u mundëson palëve dhe kur është e zbatueshme, Mbrojtësit të Viktimave, transkriptin përfundimtar me redaktimet e nevojshme për mbrojtjen e anonimitetit të dëshmitarit. ²Transkripti përfundimtar i pyetje-përgjigjeve në lidhje me dëshmitarin është pjesë e dokumentacionit gjyqësor.

Rregulla 148**Provat në çështjet e dhunës seksuale të pretenduar**

- (1) Në çështjet ku pretendohet kryerje e dhunës seksuale, trupi gjykues bazohet në parimet e mëposhtme dhe i zbaton këto parime në bazë të rrethanave:
 - (a) Nuk mund të nxirret përfundim se ka pasur pëlqim, duke u bazuar në çfarë ka thënë apo ka bërë viktima, në qoftë se përdorimi i forcës, kërcënimi për përdorim force, shtrëngimi,

apo shfrytëzimi i rrethanave shtrënguese kanë cenuar mundësinë e viktimës për dhënie të pëlqimit të njëmendtë dhe me vullnet të lirë;

- (b) Nuk mund të nxirret përfundim se ka pasur pëlqim, duke u bazuar në çfarë ka thënë apo ka bërë viktimë, në qoftë se viktimë nuk është në gjendje të japë pëlqim të njëmendtë;
 - (c) Nuk mund të nxirret përfundim se ka pasur pëlqim, duke u bazuar në heshtjen, apo mosrezistencën e viktimës ndaj dhunës seksuale të pretenduar; dhe
 - (d) Nuk mund të nxirret përfundim mbi besueshmërinë, karakterin apo prirjen për disponueshmëri seksuale të viktimës ose dëshmitarit duke u bazuar në sjelljen seksuale të mëhershme apo të mëpasshme të viktimës apo dëshmitarit në fjalë.
- (2) Sjellja seksuale e mëhershme ose e mëpasshme nuk pranohet si provë.

Rregulla 149

Dëshmitë e dëshmitarëve ekspertë

- (1) Aktekspertiza përfundimtare e cilitdo dëshmitari ekspert që do të thirret prej një pale, i bëhet e njohur palës kundërshtare dhe kur është e zbatueshme, Mbrojtësit të Viktimave, brenda afatit të përcaktuar nga gjykatësi i procedurës paraprake, ose trupi gjykues sipas rregullës 102(1)(b).
- (2) Brenda shtatë (7) ditësh pasi është njohur me aktekspertizën e një dëshmitari ekspert, ose në bazë të udhëzimeve të trupit gjykues, pala kundërshtare dorëzon një njoftim ku bën të ditur nëse:
 - (a) ka kundërshtim lidhur me kualifikimet e dëshmitarit si ekspert, apo lidhur me rëndësinë e të gjithë aktekspertizës, apo e pjesëve të caktuara të saj, dhe nëse është kështu, cilat pjesë;
 - (b) e pranon aktekspertizën e dëshmitarit ekspert ose pjesë të saj; ose
 - (c) dëshiron t'i bëjë pyetje dëshmitarit ekspert.
- (3) Në qoftë se pala kundërshtare pranon aktekspertizën e dëshmitarit ekspert ose pjesë të saj, kjo aktekspertizë ose pjesë të saj mund të pranohen nga trupi gjykues si provë pa thirrur dëshmitarin ekspert që të dëshmojë duke qenë i pranishëm.
- (4) Në qoftë se një palë i ka ushtruar të drejtat e parapara në paragrafin (2)(b) ose (c), trupi gjykues vendos mbi pranueshmërinë e aktekspertizës së dëshmitarit ekspert pas dëshmisë dhe përgjigjeve të dhëna nga eksperti për pyetjet e bëra.
- (5) Para dhënies së dëshmisë, dëshmitari ekspert bën betim solemn si vijon:

“I ndërgjegjshëm për rëndësinë e dëshmisë sime dhe përgjegjësinë time ligjore, deklaroj solemnisht se do të kryej analizën si ekspert në mënyrë të ndërgjegjshme dhe me aq sa di, dhe se do të jap përfundime dhe mendime të sakta dhe të plota.”
- (6) Në qoftë se është e nevojshme, trupi gjykues mund të autorizojë një dëshmitar ekspert që ende nuk ka dhënë mendim si ekspert, të jetë i pranishëm në një seancë gjatë së cilës një dëshmitar ekspert tjetër dëshmon në lidhje me të njëjtën çështje.

Rregulla 150**Dhënia e dëshmisë nga të bashkakuzuarit**

- (1) Mbrojtja mund:
- (a) me pëlqimin e një të bashkakuzuari, ta thërrasë atë si dëshmitar; ose
 - (b) nëpërmjet Mbrojtësit të Specializuar, t'i bëjë çfarëdo pyetje të bashkakuzuarit që paraqitet si dëshmitar.
- (2) ¹Dëshmia e mëhershme e të bashkakuzuarit dhënë gjatë gjykimit mund të përdoret nga palët gjatë marrjes në pyetje të një akuzuari apo dëshmitari tjetër. ²Në qoftë se dëshmia e një të bashkakuzuari për të njëjtën temë ndryshon, trupi gjykues mund t'i bëjë atij të bashkakuzuari pyetje në lidhje me këtë temë. ³Gjithashtu, trupi gjykues mund të bëjë një ballafaqim midis të bashkakuzuarve.

Rregulla 151**Vetëfajësimi prej një dëshmitari**

- (1) ¹Një dëshmitar mund të kundërshtojë të japë dëshmi që priret ta fajësojë. ²Pala thirrëse, ose kur është e zbatueshme, trupi gjykues, e informon dëshmitarin për këtë të drejtë para dhënies së dëshmisë në një gjuhë që dëshmitari kupton dhe flet.
- (2) Trupi gjykues mund të detyrojë një dëshmitar të dëshmojë, pasi ka shqyrtuar:
- (a) rëndësinë e dëshmisë që pritet të jepet;
 - (b) nëse dëshmitari do të japë dëshmi unike në lidhje me çështjen;
 - (c) llojin e vetëfajësimit të mundshëm, në qoftë se bëhet i njohur; dhe
 - (d) mjaftueshmërinë e masave mbrojtëse për dëshmitarin në rrethanat përkatëse.
- (3) ¹Në qoftë se trupi gjykues vendos ta detyrojë dëshmitarin të dëshmojë, pasi të ketë kërkuar *ex parte* mendimin e Prokurorit të Specializuar, trupi gjykues mund të përcaktojë se para dhënies së dëshmisë, dëshmitarit i duhet dhënë garanci në lidhje me vetëfajësimin. ²Trupi gjykues e siguron dëshmitarin se dëshmia e dhënë në përgjigjet ndaj pyetjeve:
- (a) jepet *in camera* dhe nuk i bëhet në asnjë mënyrë e njohur publikut, Kosovës apo ndonjë shteti të tretë; dhe
 - (b) nuk do të përdoret as drejtpërsëdrejti, as tërthorazi, kundër atij personi në një procedim penal të mëvonshëm në Dhomat e Specializuara, përveç se në bazë të nenit 15(2) të Ligjit dhe rregullës 65.

³Zbatohet rregulla 206 (2).

- (4) Në qoftë se gjatë procesit lind problemi i vetëfajësimit, trupi gjykues pezullon marrjen e dëshmisë dhe i jep dëshmitarit mundësinë të marrë këshilla juridike në rast se dëshmitari kërkon një gjë të tillë në kuadër të zbatimit të kësaj rregulle.

- (5) Në qoftë se e gjykon të nevojshme, trupi gjykues mund të urdhërojë mosnxjerrjen e asnjë dokumenti të dëshmisë dhe çfarëdo mase mbrojtëse për dëshmitarin.
- (6) Në përputhje me rrethanat, trupi gjykues mund të urdhërojë Administratorin t'i caktojë dëshmitarit një Mbrojtës me qëllim që dëshmitari të mund të marrë këshilla juridike në lidhje me efektin e dëshmisë së tij.

Rregulla 152

Fajësimi nga anëtarët e familjes

- (1) ¹Para fillimit të dëshmisë, trupi gjykues informon dëshmitarin e dalë para trupit gjykues, që është bashkëshort ose bashkëshorte, apo i afërm i shkallës së parë në vijë të drejtë i të akuzuarit, se trupi gjykues nuk e detyron dëshmitarin të bëjë deklaratë që mund të fajësojnë të akuzuarin. ²Dëshmitari mund të vendosë të bëjë një deklaratë të tillë.
- (2) Në vlerësimin e dëshmisë së një dëshmitari, trupi gjykues mund të marrë parasysh se dëshmitari i përmendur në paragrafin (1), ka kundërshtuar që t'i përgjigjej një pyetjeje e cila synonte të hidhte poshtë një deklaratë të mëhershme të dëshmitarit, ose dëshmitari ka qenë përzgjedhës se cilës pyetje t'i përgjigjej.

Rregulla 153

Pranimi i deklaratave dhe transkripteve me shkrim në vend të dëshmive gojore

- (1) Në varësi të rregullës 155, në vend të dëshmisë gojore, trupi gjykues mund të pranojë deklaratën me shkrim të dëshmitarit, ose transkriptin me shkrim të dëshmisë së dhënë nga dëshmitari në procedura të Dhomave të Specializuara, që është për vërtetimin e një çështjeje dhe jo për veprimet dhe sjelljen e të akuzuarit për të cilat akuzohet në aktakuzë.
 - (a) Ndër faktorët në favor të pranimit të një deklaratë ose transkripti me shkrim në vend të një dëshmie gojore përfshihen faktorët në lidhje me rrethanat në të cilat dëshmia në fjalë:
 - (i) është përsëritëse, në kuptimin që dëshmitarë të tjerë kanë dëshmuar, ose do të dëshmojnë gojarisht për fakte të ngjashme;
 - (ii) konfirmohet nga dëshmi të cilat i akuzuari mund t'i ballafaqojë efektivisht, ndër të tjera edhe përmes pyetjeve drejtuar dëshmitarit;
 - (iii) ka të bëjë me rrethanat historike, politike ose ushtarake;
 - (iv) përmban një analizë të përgjithshme ose statistikore në lidhje me përbërjen e popullatës në vendet që përmenden në aktakuzë;
 - (v) ka të bëjë me pasojat e veprave penale mbi viktimat;
 - (vi) ka lidhje me karakterin e të akuzuarit;
 - (vii) ka të bëjë me faktorët që do të merren parasysh në përcaktimin e dënimit; ose
 - (viii) është dhënë nga dëshmitari në praninë e palëve që kanë pasur mundësi ta pyesin.

- (b) Faktorët kundër pranimit të një deklaratë ose transkripti me shkrim në vend të një dëshmie gojore përfshijnë raste kur:
- (i) një palë, ose kur është e zbatueshme, Mbrojtësi i Viktimave, kundërshton pranimin e dëshmisë së dëshmitarit me shkrim dhe provon se lloji dhe burimi i dëshmisë e bëjnë jo të besueshme, apo se efekti dëmtues zhbën vlerën provuese të dëshmisë;
 - (ii) dëshmia është fajësuese ose ka lidhje me një pikë thelbësore të aktakuzës së Prokurorit të Specializuar;
 - (iii) ekzistojnë faktorë të tjerë të përshtatshëm për paraqitjen e dëshmitarit për pyetje nga pala kundërshtare; ose
 - (iv) ekziston një interes madhor publik për dhënien e dëshmisë gojarisht.
- (2) ¹Deklarata nënshkruhet nga personi që mban procesverbal dhe bën pyetjet dhe nga personi që pyetet dhe mbrojtësi i vet në qoftë se është i pranishëm, si edhe, kur është e zbatueshme, nga Prokurori i Specializuar ose gjykatësi që është i pranishëm. ²Në procesverbal shënohen, data, ora dhe vendi i marrjes në pyetje dhe të gjithë personat e pranishëm gjatë marrjes në pyetje. ³Në qoftë se në rrethana të veçanta, personi nuk e ka nënshkruar procesverbalin, në të shënohen arsyet e mosnënshkrimit.
- (3) ¹Pasi të ketë dëgjuar palët, trupi gjykues vendos nëse t'i kërkojë dëshmitarit të paraqitet për pyetje nga pala kundërshtare. ²Trupi gjykues mund të marrë një vendim duke dhënë edhe arsyet se kriteret për një gjykim të drejtë e të shpejtë përligjin domosdoshmërisht pranimin e deklaratës ose të transkriptit, tërësisht ose pjesërisht, pa u ballafaquar me pyetje nga pala kundërshtare. ³Në qoftë se trupi gjykues merr vendim që dëshmitari të paraqitet për pyetje nga pala kundërshtare, atëherë zbatohet rregulla 154.

Rregulla 154

Pranimi i deklaratave dhe transkripteve me shkrim në vend të pyetjeve të drejtpërdrejta

Në varësi të rregullës 155, trupi gjykues mund të pranojë deklaratë me shkrim të një dëshmitari, ose transkriptin me shkrim të dëshmisë së dhënë në procedura të Dhomave të Specializuara, dëshmi që është për vërtetimin e veprimeve dhe sjelljes së të akuzuarit që akuzohen në aktakuzë, në qoftë se përmbushen kushtet e mëposhtme:

- (a) dëshmitari është i pranishëm në gjykatë;
- (b) dëshmitari është në dispozicion për pyetje nga pala kundërshtare dhe pyetje të mundshme nga trupi gjykues; dhe
- (c) dëshmitari konfirmon se deklarata ose transkripti me shkrim pasqyron saktësisht çfarë ka thënë dhe çfarë do të thoshte po të pyetej.

Rregulla 155**Pranimi i deklaratave me shkrim të personave të padisponueshëm dhe personave ndaj të cilëve ka ndërhyrje**

- (1) Mund të pranohen dëshmi në formën e deklaratave me shkrim, të dokumenteve të tjera me shkrim, ose të shprehura ndryshe, të thënieve të një personi, apo transkripti i deklaratës së një personi që ka vdekur, ose që nuk mund të gjendet duke vepruar me zell të arsyeshëm, apo për shkak të dëmtimeve fizike apo mendore nuk është në gjendje të dëshmojë gojarisht, pavarësisht nëse deklarata me shkrim është apo nuk është në formën e përcaktuar në Rregullore, në qoftë se trupi gjykues bindet se:
- (a) personi është i padisponueshëm, ose i paaftë për të dëshmuar gojarisht; dhe
 - (b) deklarata, regjistrimi ose transkripti është *prima facie* i besueshëm, duke marrë parasysh rrethanat në cilat është bërë, regjistruar dhe ruajtur.
- (2) Trupi gjykues mund të pranojë dëshmi në formën e deklaratës me shkrim, të çdo regjistrimi, apo transkripti *prima facie* të besueshëm të deklaratës së një personi, në qoftë se bindet se:
- (a) personi nuk është paraqitur në gjyq si dëshmitar, ose megjithëse ka qenë i pranishëm si dëshmitar, nuk ka dëshmuar aspak, ose nuk ka dëshmuar në lidhje me një pikë juridikisht thelbësore;
 - (b) mungesa e personit ose mosdhënia e dëshmisë është ndikuar thelbësisht nga ndërhyrje të palejueshme, ndër të cilat kërcënim, frikësim, lëndim, ofrim parash, ose shtrëngim;
 - (c) në varësi të rrethanave, janë bërë përpjekje të arsyeshme sipas rregullës 100 dhe rregullës 121 për të siguruar praninë e personit si dëshmitar, ose në qoftë se është i pranishëm, nga dëshmitari të merren të gjitha faktet thelbësore për të cilat dëshmitari ka dijeni;
 - (d) dëshmia e propozuar ose dëshmia në lidhje me të njëjtën gjë nuk mund të merret ndryshe; dhe
 - (e) është në interes të drejtësisë.
- (3) Në kontekst të paragrafit (2):
- (a) ndërhyrja e palejueshme ndër të tjera mund të ketë lidhje me interesa fizikë, psikologjikë, ekonomikë, pronësorë ose interesa të tjerë të atij personi ose të një personi tjetër;
 - (b) ndër interesa të drejtësisë përfshihen:
 - (i) besueshmëria e deklaratës ose transkriptit duke marrë parasysh rrethanat në të cilat është dhënë dhe dokumentuar;
 - (ii) roli i perceptuar i ndërhyrjes së palejueshme të një pale ose të dikujt që vepron në emër të një pale në procedura; dhe
 - (iii) nëse për të njëjtën gjë ekzistojnë dëshmi të tjera dhe nëse dëshmia e propozuar konfirmohet tërësisht ose pjesërisht.
- (4) Trupi gjykues mund të marrë parasysh çfarëdo provash që kanë lidhje, përfshirë edhe dëshmi me shkrim, në funksion të zbatimit të kësaj rregulle.

- (5) Një faktor kundër pranimi të një dëshmie tërësisht ose pjesërisht mund të jetë në qoftë se dëshmia është për vërtetimin e veprimeve dhe sjelljes së të akuzuarit që pretendohen në aktakuzë.

Rregulla 156

Fakte të pranuar nga palët

Në qoftë se palët kanë parashtruar pika për të cilat pajtohen sipas rregullës 95(3) dhe kryetari i trupit gjykues ka shënuar konstatim të tyre sipas rregullës 118(4), trupi gjykues mund t'i konsiderojë këto pretendime faktike si fakte të vërtetuara, përveçse kur ka mendimin se në lidhje me pretendimet faktike nevojitet një paraqitje më e plotë e provave.

Rregulla 157

Konstatimi gjyqësor

- (1) Trupi gjykues nuk kërkon vërtetimin e fakteve të njohura nga gjithkush, por bën konstatim gjyqësor të tyre.
- (2) Me kërkesë të një pale, ose *proprio motu*, pasi të ketë dëgjuar palët dhe kur është e zbatueshme, Mbrojtësin e Viktimave, për hir të një gjykimi të drejtë e të shpejtë trupi gjykues mund të bëjë konstatim gjyqësor të fakteve të shqyrtuara në procese të tjera të Dhomave të Specializuara, ose në procedura përfundimtare të gjykatave të tjera në Kosovë, apo në sisteme gjyqësore të tjera që kanë lidhje me pika që kontestohen në procedurat aktuale, në qoftë se nuk kanë lidhje me veprimet dhe sjelljen e të akuzuarit që përmenden si akuza në aktakuzë.

Pjesa IV: Vendimi i gjykimit

Rregulla 158

Kuvendimet në lidhje me vendimin e gjykimit

- (1) ¹Pas mbylljes së çështjes, trupi gjykues tërhiqet për të kuvenduar *in camera*, për shqiptimin e vendimit të gjykimit në lidhje me akuzat në aktakuzë. ²Kuvendimet janë rreptësisht konfidenciale.
- (2) ¹Trupi gjykues vendos veçazi për secilën akuzë, përfshirë edhe secilën formë përkatëse të përgjegjësisë penale. ²Në rastin e gjykimeve të përbashkëta, për çdo të akuzuar nxirren përfundime më vete.
- (3) Përfundimi i fajësisë nxirret vetëm në qoftë se shumica e trupit gjykues bindet se fajësia është vërtetuar jashtë dyshimit të arsyeshëm.

Rregulla 159**Shqiptimi i vendimit të gjykimit**

- (1) ¹Vendimi i gjykimit shqiptohet brenda nëntëdhjetë (90) ditësh pas mbylljes së çështjes gjyqësore sipas rregullës 136, dhe në të mund të përfshihet edhe një vendim sipas nenit 22(7) të Ligjit. ²Në qoftë se rrethanat e çështjes kërkojnë zgjatje të mëtejshme të afatit, kjo nuk shkon më shumë se gjashtëdhjetë (60) ditë përveçse kur është absolutisht e nevojshme. ³Vendimi për zgjatjen e afatit është publik dhe palët e Mbrojtësi i Viktimave informohen në lidhje me të. ⁴Për zgjatjen e afatit jepen arsyet përkatëse.
- (2) Vendimi i gjykimit, ose një përmbledhje e këtij vendimi, shqiptohet publikisht në emër të popullit të Kosovës dhe në praninë e të akuzuarit, përveçse kur rrethana të posaçme përlligjin mungesën e të akuzuarit.
- (3) ¹Vendimi i gjykimit dorëzohet në formën e një aktgjykimi dhe përmban një arsyetim të përfundimeve të trupit gjykues. ²Në rast se shpallet pafajësi, vendimi shqiptohet gojarisht e sa më shpejt që është e mundshme pasohet nga arsyetimi me shkrim.
- (4) Sa më shpejt që është e mundshme, të akuzuarit i dorëzohet një kopje e legalizuar e aktgjykimit dhe në qoftë se ka, edhe mendimet e gjykatësve në një gjuhë që i akuzuari kupton dhe flet. Mbrojtjes i jepen kopje të tilla në atë gjuhë dhe në gjuhën në të cilën është shqiptuar aktgjykimi.
- (5) Në qoftë se e shpall të akuzuarin fajtor, trupi gjykues mund të nxjerrë urdhra sipas nenit 22(8-11) dhe nenit 44(6) të Ligjit.
- (6) Në qoftë i akuzuari shpallet fajtor për një ose më shumë vepra penale, trupi gjykues përcakton dënimin e duhur për të akuzuarin që shqiptohet në vendimin e gjykimit, përveç se pasi të ketë dëgjuar palët, trupi gjykues vendos të procedojë në përputhje me rregullën 162 dhe rregullën 164.

Rregulla 160**Statusi i personit të shpallur fajtor**

Në rast se një i akuzuar që është në gjendje të lirë shpallet fajtor, trupi gjykues mund të lëshojë një fletarrestim dhe të urdhërojë paraburgimin e të akuzuarit.

Rregulla 161**Statusi i personit të shpallur të pafajshëm**

Kur një i akuzuar i paraburgosur shpallet i pafajshëm, ai lirohet menjëherë, përveç se kur mbahet në paraburgim në mënyrë të ligjshme, ose vuan një dënim për vepra penale të ndryshme nga ato në lidhje me të cilat është shpallur i pafajshëm. Lirimi kryhet në përputhje me nenin 41(11) të Ligjit

Pjesa V: Përcaktimi i dënimit**Rregulla 162****Procedura e përcaktimit të dënimit**

- (1) Në qoftë se trupi gjykues e shpall të akuzuarin fajtor për një ose më shumë vepra penale, përveçse kur dënimi është shqiptuar në bazë të rregullës 159(6), Prokurori i Specializuar dhe Mbrojtja mund të paraqesin çfarëdo informacioni me rëndësi për përcaktimin e dënimit, i cili mund të ndihmojë trupin gjykues në përcaktimin e dënimit të duhur brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh pas shqiptimit të vendimit të trupit gjykues.
- (2) Në varësi të autorizimit prej trupit gjykues, Mbrojtësi i Viktimave mund të ushtrojë të gjitha të drejtat përkatëse të parapara në rregullën 114.
- (3) Procedura e përcaktuar në paragrafin (1) dhe paragrafin (2), zbatohet edhe në rastin e pranimit të fajësisë sipas rregullës 93.
- (4) Dënimi përcaktohet duke u bazuar në parashtrime me shkrim, përveç nëse trupi gjykues ka vendosur ndryshe.
- (5) Për përcaktimin e dënimit, trupi gjykues bazohet në provat e paraqitura dhe, me kërkesë të palëve e kur është e zbatueshme, të Mbrojtësit të Viktimave, mund të dëgjojë dëshmi shtesë në qoftë se është e nevojshme.

Rregulla 163**Përcaktimi i dënimit**

- (1) ¹Në përcaktimin e dënimit në përputhje me nenin 44(1-4) të Ligjit, trupi gjykues merr parasysh dhe peshon faktorët e përmendur në nenin 44(5) të Ligjit. ²Trupi gjykues merr parasysh veçanërisht:
 - (a) rrethana lehtësuese të tilla si:
 - (i) rrethana që nuk janë të mjaftueshme si arsye për përjashtimin e përgjegjësisë penale, si ato që përmenden në rregullën 95(5); dhe
 - (ii) veprimet e personit të shpallur fajtor pas kryerjes së veprës penale, përfshirë çfarëdo përpjekje të personit për të zhdëmtuar viktimat, dorëzimin vullnetar dhe bashkëpunimin me Prokurorin e Specializuar dhe Dhomat e Specializuara;
 - (b) rrethana rënduese, nëse ekzistojnë të tilla si:
 - (i) çfarëdo fajësie penale përkatëse të mëhershme për vepra penale brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara ose të ngjashme;
 - (ii) shpërdorimi i pushtetit apo i detyrës zyrtare;
 - (iii) kryerje ose pjesëmarrje në kryerjen e veprës penale ku viktimat janë veçanërisht e cenueshme ose e pambrojtur; dhe

- (iv) kryerje ose pjesëmarrje në kryerjen e veprës penale në një mënyrë veçanërisht mizore, ose kur ka pasur disa viktime.
- (2) ¹Dënimi ulet nëse bëhet pranim i fajësisë sipas rregullës 93, ose marrëveshje për pranimin e fajësisë sipas rregullës 94. ²Merret parasysh edhe koha e pranimit të fajësisë, ose e marrëveshjes për pranimin e fajësisë.
- (3) Në përcaktimin e dënimit të një personi të shpallur fajtor, merren parasysh dosja penale si edhe precedentë të mëhershëm penalë të kryerjes së veprave penale nga ky person, të cilat i paraqet Prokurori i Specializuar.
- (4) ¹Trupi gjykues përcakton dënim në lidhje me çdo akuzë të aktakuzës për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor dhe jep një dënim të njësuar që pasqyron tërësinë e veprimtarisë kriminale të të akuzuarit, që kryhet njëkohësisht me çfarëdo dënimi tjetër me burgim që është dhënë më parë nga një gjykatë në Kosovë, në qoftë se një dënim i tillë është dhënë dhe në qoftë se nuk urdhërohet ndryshe. ²Dënimi i njësuar nuk është më pak i rëndë se dënimi më i rëndë individual i përcaktuar për cilëndo akuzë.
- (5) Dënimi me burgim të përjetshëm mund të jepet në qoftë se përligjet nga pesha e skajshme e kriminit dhe rrethanat personale të personit të shpallur fajtor, evidentuar prej një ose më shumë rrethanash rënduese.
- (6) Në përcaktimin e kohëzgjatjes së dënimit me burgim, trupi gjykues zbret kohën që i akuzuari është mbajtur në paraburgim në rast se është mbajtur, në përputhje me Kapitullin 4.

Rregulla 164**Shqiptimi i vendimit të dënimit prej trupit gjykues**

- (1) ¹Në qoftë se trupi gjykues e shpall të akuzuarin fajtor për një ose më shumë vepra penale, përveç rastit kur dënimi shqiptohet sipas rregullës 159(6), vendimi i dënimit shqiptohet brenda tridhjetë (30) ditësh pas dorëzimit të parashtrimit të fundit nga palët, ose kur është e zbatueshme, Mbrojtësi i Viktimave, ose pasi të jenë dëgjuar dëshmi shtesë. ²Në rast se për shkak të rrethanave nevojitet zgjatje e këtij afati, kjo nuk shkon më shumë se tridhjetë (30) ditë. ³Vendimi për zgjatjen e afatit është publik dhe palët e Mbrojtësi i Viktimave informohen në lidhje me të. ⁴Për zgjatjen e afatit jepen arsyet përkatëse.
- (2) Rregulla 159(2-4) zbatohet *mutatis mutandis*.

Rregulla 165**Gjobat**

- (1) Një person i shpallur fajtor për një shkelje sipas nenit 15(2) të Ligjit dhe i dënuar me gjobë, gjobën ia paguan Administratorit.
- (2) ¹Pas dhënies së dënimit me gjobë, trupi gjykues i lejon personit të dënuar një periudhë kohore të arsyeshme për pagimin e gjobës. ²Trupi gjykues mund të përcaktojë mënyrën e pagimit, ose në formën e shumës së vetme, ose me anë të kësteve që paguhet gjatë periudhës së lartpërmendur.

- (3) ¹Në rast se personi i dënuar nuk e paguan gjobën brenda afatit të përcaktuar, trupi gjykues mund të nxjerrë një urdhër për paraqitjen e atij personi para trupit gjykues. ²Ndryshe, trupi gjykues mund t'i kërkojë personit të dënuar shpjegim me shkrim ku të arsyetohet mospagimi i gjobës.
- (4) Pasi t'i ketë dhënë personit të dënuar mundësinë e parashtrimit, trupi gjykues mund të urdhërojë marrjen e masave të duhura, ndër të cilat:
- (a) zgjatja e afatit për pagimin e gjobës;
- (b) urdhër për sekuestrimin e pronës, fitimeve dhe kapitaleve të personit të dënuar në masën e nevojshme për shlyerjen e gjobës;
- (c) konvertimi i tërë gjobës ose një pjese të saj në dënim me burgim që nuk tejkalon dënimin më të rëndë në fuqi në Kodin Penal të Kosovës për atë shkelje; dhe
- (d) në qoftë se bashkë me gjobën është dhënë edhe dënim me burgim, zgjatje e dënimit me burgim që nuk shkon më shumë se një e katërta e këtij dënimi ose pesë (5) vjet, cilado zgjatje dënimi që është më e shkurtër. Një zgjatje e tillë nuk mund të rezultojë në një periudhë të gjithsejtë të burgimit më të gjatë se dënimin më afatgjatë në fuqi në Kodin Penal të Kosovës për atë shkelje.

Rregulla 166**Vendi i burgimit**

- (1) ¹Në përputhje me nenin 50(1) të Ligjit, pasi të ketë dëgjuar të akuzuarin, Kryetari vendos në cilin shtet i akuzuari do të kryejë dënimin nga një listë e shteteve që janë pajtuar të pranojnë personat e dënuar. ²Ky vendim nuk i nënshtrohet rishikimit gjyqësor.
- (2) Transferimi i personit të dënuar në atë shtet bëhet sa më shpejt që të jetë e mundur pasi të ketë kaluar afati për dorëzimin e një apeli, apo pasi vendimi i dënimit të ketë marrë formë të prerë.
- (3) Deri në finalizimin e përgatitjeve prej Administratorit për transferimin në shtetin ku do të kryhet dënimin, i dënuari mbahet në paraburgimin e Dhomave të Specializuara.

Pjesa VI: Zhdëmtimi**Rregulla 167****Referim në padi civile**

- (1) Në qoftë se në aktgjykimin e vet, trupi gjykues ka përfshirë edhe një vendim mbi viktimat bazuar në nenin 22(9-10) të Ligjit, dhe me kërkesë të Mbrojtësit të Viktimave sipas nenit 22(10) të Ligjit, Administratori mund t'u përcjellë një kopje të legalizuar të këtij vendimi dhe të aktgjykimit autoriteteve kompetente të shtetit të tretë përkatës, ose vetë viktimave.
- (2) Në funksion të kërkesave për dëmshpërblim të paraqitura në gjykatat vendore, aktgjykimi i përcjellë sipas paragrafit (1) është i formës së prerë dhe detyruar në lidhje me përgjegjësinë penale të personit të dënuar për dëmin e shkaktuar.

Rregulla 168**Urdhër për zhdëmtim kundër personit të shpallur fajtor**

¹Në qoftë se trupi gjykues nxjerr një urdhër sipas nenit 22(8) të Ligjit kundër personit të shpallur fajtor, në bazë të një kërkesë të Mbrojtësit të Viktimave, të personit të shpallur fajtor, ose *proprio motu*, trupi gjykues mund të emërojë ekspertë për ta ndihmuar në përcaktimin e masës së dëmit shkaktuar viktimave, ose në lidhje me viktimat, dhe për sugjerime në lidhje me zhdëmtim individual ose kolektiv prej personit të shpallur fajtor. ²Trupi gjykues mund të ftojë Mbrojtësin e Viktimave dhe personin e shpallur fajtor që të paraqesin vërejtjet e tyre në lidhje me aktekspertizat.

Kapitulli 10

Procedura e apelit

Pjesa I: Procedura e apelit të shkallës së dytë

Nënpjesa 1: Apelet e ndërmjetme

Rregulla 169**Caktimi i panelit të Gjykatës së Apelit për apelet e ndërmjetme**

Në bazë të nenit 33(1)(c) të Ligjit, Kryetari cakton një panel të Gjykatës së Apelit pas dorëzimit të kërkesës për apel të ndërmjetëm të dorëzuar në bazë të së drejtës së vetvetishme, ose pas autorizimit të dhënë sipas rregullës 77(3), ose sikurse mund ta lypë nevoja.

Rregulla 170**Dorëzimi i apeleve të ndërmjetme**

- (1) ¹Nëse e drejta e apelit është e vetvetishme, apeluesi mund të dorëzojë apelin brenda dhjetë (10) ditësh nga vendimi i kontestuar. ²Pala kundërshtare mund të dorëzojë një përgjigje brenda dhjetë (10) ditësh nga apelimi. ³Apeluesi mund të dorëzojë një kundërpërgjigje brenda pesë (5) ditësh nga përgjigjja.
- (2) ¹Nëse është dhënë autorizimi sipas rregullës 77(3), apeluesi mund ta dorëzojë apelin brenda dhjetë (10) ditësh nga dhënia e autorizimit. ²Apeli paraqitet vetëm në lidhje me pikat a autorizuara nga paneli. ³Pala përgjigjëse mund të dorëzojë një përgjigje brenda dhjetë (10) ditësh nga apeli. ⁴Apeluesi mund të dorëzojë një kundërpërgjigje brenda pesë (5) ditësh nga përgjigjja.
- (3) Përveç nëse paneli i Gjykatës së Apelit ka vendosur ndryshe, vendimet për apelet e ndërmjetme merren mbi bazën e parashtrimeve me shkrim.

Rregulla 171**Efekt i pezullues i apelit të ndërmjetëm**

¹Në varësi të rregullës 58(4), apelet e ndërmjetme nuk kanë efekt pezullues, përveç nëse është urdhëruar ndryshe në vendimin që autorizon apelin, ose nga paneli i Gjykatës së Apelit, në lidhje me një kërkesë të dorëzuar përpara paraqitjes së apelit ose me apelin. ²Efekt i pezullues miratohet vetëm si masë e posaçme nëse apeluesi provon se zbatimi i vendimit të apeluar ka gjasë të bjerë ndesh me qëllimin e apelit, ose do të çonte në pasoja që mund të jenë të pakthyeshme.

Nënpjesa 2: Apelet kundër aktgjykimeve**Rregulla 172****Kaktimi i panelit të Gjykatës së Apelit për apelet kundër aktgjykimeve**

Në bazë të nenit 33(1)(c) të Ligjit, Kryetari cakton një panel të Gjykatës së Apelit sapo të jetë dorëzuar njoftimi për apel sipas rregullës 176, ose sikurse mund ta lypë nevoja.

Rregulla 173**Dispozita të përgjithshme**

- (1) Një person i shpallur fajtor, ose Prokurori i Specializuar, mund të apelojë një aktgjykim të trupit gjykues mbi bazën e arsyeve të parapara në nenin 46(1) të Ligjit.
- (2) Mbrojtësi i Viktimave mund të apelojë aktgjykimin e trupit gjykues brenda kufijve të nenit 46(9) të Ligjit.
- (3) Rregullat e procedurës së gjykimit zbatohen *mutatis mutandis* për procedurën përpara panelit të Gjykatës së Apelit.

Rregulla 174**Statusi i personave në pritje të apelit**

Me përjashtim të rregullës 58, rregulla 56 deri tek rregulla 60 zbatohen *mutatis mutandis* lidhur me personin në pritje të apelit.

Rregulla 175**Dokumentacioni i apelit**

¹Administratori legalizon dosjen e çështjes gjyqësore dhe i mundëson panelit të Gjykatës së Apelit qasje në të. ²Dosja e çështjes gjyqësore përbën dokumentacionin e apelit.

Rregulla 176**Njoftimi për apel**

- (1) Pas një vendimi pafajësie sipas rregullës 159, Prokurori i Specializuar, brenda tridhjetë (30) ditësh nga dalja e aktgjykimit, mund të bëjë njoftim për apel ku parashtron arsyet e apelit.
- (2) Pas një vendimi fajësie sipas rregullës 159, pala që kërkon të apelojë ose vendimin e gjykimit, ose vendimin e dënimit, ose të dy, dorëzon njoftimin për apel ku parashtron arsyet e apelit brenda tridhjetë (30) ditësh nga aktgjykimi i dënimit.
- (3) ¹Nëse i parashtrohen arsye të vlefshme, paneli i Gjykatës së Apelit mund të autorizojë ndryshimin e arsyeve për apel. ²Kërkesa për ndryshim dorëzohet sapo arsyet për këtë bëhen të njohura.

Rregulla 177**Gjykatësi raportues në procedurën e apelit**

- (1) Në pajtim me rregullën 17, pas dorëzimit të njoftimit për apel dhe në këshillim me gjykatësit e panelit, kryetari i panelit të Gjykatës së Apelit mund të caktojë një prej gjykatësve të panelit si gjykatës raportues përgjegjës për procedurën paraapeluese.
- (2) Gjykatësi raportues siguron që të mos ketë vonesa të papërligjura të procedurës dhe merr çdo masë lidhur me aspektet procedurale, ndër të cilat lëshimin e vendimeve, urdhrave, dhe udhëzimeve në emër të panelit, me qëllim përgatitjen e çështjes për një shqyrtim të drejtë dhe të shpejtë.
- (3) Gjykatësi raportues e informon rregullisht panelin e Gjykatës së Apelit, veçanërisht në rast kontestimi lidhur me çështje procedurale dhe mund t'ia referojë këto kontestime panelit të Gjykatës së Apelit.
- (4) Paneli i Gjykatës së Apelit mund të ushtrojë cilëndo prej funksioneve të gjykatësit raportues.

Rregulla 178**Konferenca para apelit**

Brenda njëzet e një (21) ditësh nga njoftimi për apel, dhe kur çmohet e nevojshme pas kësaj, kryetari i panelit ose gjykatësi raportues nëse është caktuar, thërret një konferencë për t'i mundësuar çdo personi të paraburgosur në pritje të apelit të ngrejë çështje lidhur me apelin, përfshirë edhe lidhur me gjendjen mendore dhe fizike të personit.

Rregulla 179**Dosjet apeluase**

- (1) Apeluesi dorëzon dosjen e apelit ku parashtron të gjitha argumentet dhe burimet ligjore në mbështetje të arsyeve për apel brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh, ose, nëse apeli lidhet vetëm me dënimin, brenda tridhjetë (30) ditësh nga njoftimi për apel.

- (2) Pala përgjigjëse mund të dorëzojë dosjen e përgjigjes, ku parashtron të gjitha argumentet dhe burimet ligjore brenda tridhjetë (30) ditësh, ose, nëse apeli lidhet vetëm me dënimin, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dorëzimi i dosjes së apelit.
- (3) Apeluesi mund të dorëzojë një dosje kundërpërgjigjëse brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, ose, nëse apeli lidhet vetëm me dënimin, brenda dhjetë (10) ditësh nga dorëzimi i dosjes së përgjigjes.
- (4) Në rast se Prokurori i Specializuar apelon një vendim pafajësie, personi i shpallur i pafajshëm, me lejen e panelit të Gjykatës së Apelit, mund të dorëzojë një dosje kundërpërgjigjëse brenda dhjetë (10) ditësh, ose, nëse apeli lidhet vetëm me dënimin, brenda pesë (5) ditësh nga vendimi për miratimin e lejes.
- (5) Prokurori i Specializuar bën një deklaratë në dosjen e apelit ose dosjen e përgjigjes, sipas rastit, që nxjerrja e materialit nën ruajtjen dhe kontrollin e tij është kryer plotësisht në kohën e dorëzimit të asaj dosjeje.
- (6) ¹Përveçse kur paneli i Gjykatës së Apelit urdhëron ndryshe, nëse Prokurori i Specializuar apelon një aktgjykim lidhur me disa persona të shpallur të pafajshëm ose fajtorë, ai dorëzon dosje përmbledhëse të apelit. ²Afati kohor për dorëzimin e dosjes përmbledhëse llogaritet prej datës së dorëzimit të dosjes së fundit të apelit, apo të dosjes së përgjigjes të personave të shpallur të pafajshëm ose fajtorë, sipas rrethanave.

Rregulla 180

Data e seancës së apelit

Pas përfundimit të afateve kohore për dorëzimin e dosjeve parashikuar në rregullën 179, paneli i Gjykatës së Apelit mund të caktojë datën e seancës së apelit, nëse është e nevojshme.

Rregulla 181

Provat shtesë

- (1) ¹Një palë, ose, brenda kufijve të nenit 46(9) të Ligjit, Mbrojtësi i Viktimave, mund të bëjë kërkesë përmes një mocioni për paraqitjen e provave shtesë para panelit të Gjykatës së Apelit, duke identifikuar me saktësi se me cilin përfundim faktik konkret të trupit gjykues lidhen provat shtesë. ²Këto mocione dorëzohen brenda tridhjetë (30) ditësh nga dosja kundërpërgjigjëse, përveç nëse vonesa përlligjet duke dhënë arsye të vlefshme.
- (2) ¹Pala kundërshtare, ose një i bashkakuzuar me të cilët ka lidhje kërkesa, mund të dorëzojnë një përgjigje brenda tridhjetë (30) ditësh nga dorëzimi i mocionit. ²Pala që kërkon pranimin e provave shtesë mund të dorëzojë një kundërpërgjigje brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e përgjigjes.
- (3) ¹Nëse paneli i Gjykatës së Apelit arrin në përfundimin se provat shtesë nuk ishin të disponueshme në kohën e gjykimit dhe se nuk mund të ishin zbuluar përmes ushtrimit të zellit të duhur, paneli përcakton nëse provat në fjalë mund të kishin qenë faktor vendimtar në marrjen e vendimit në gjyq dhe jep një vendim. ²Rregulla 138 zbatohet *mutatis mutandis*.

- (4) ¹Paneli i Gjykatës së Apelit bën çdo përpjekje që të marrë vendim lidhur me mocionin për provat shtesë përpara seancës të apelit nëse do të mbahet, dhe mund t'i paraqesë arsyet në aktgjykimin e apelit. ²Paneli vendos për mocionin vetëm mbi bazën e parashtrimeve me shkrim.
- (5) Nëse paneli i Gjykatës së Apelit pranon prova shtesë:
- (a) pala kundërshtare mund të bëjë kërkesë përmes një mocioni për paraqitjen e kundërprovave brenda afatit kohor të përcaktuar nga paneli në vendimin për pranimin e provave shtesë; dhe
- (b) palët, ose kur është e zbatueshme, Mbrojtësi i Viktimave, mund të dorëzojnë dosje plotësuese lidhur me ndikimin e provave shtesë mbi përfundimin konkret faktik brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh prej:
- (i) përfundimit të afatit kohor të caktuar për dorëzimin e kundërprovave, në qoftë se nuk janë dorëzuar; ose
- (ii) vendimit mbi pranimin e kundërprovave.
- (6) Në aktgjykimin e apelit, paneli i Gjykatës së Apelit shqyrton çdo provë shtesë të pranuar, së bashku me provat që tashmë janë pjesë e dokumentacionit.
- (7) Nëse në apel janë palë disa persona të shpallur të pafajshëm ose fajtorë, provat e pranuar për secilin prej tyre shqyrtohen në lidhje me të gjithë, në qoftë se kanë lidhje me ta dhe në varësi të rregullës 182(4).

Rregulla 182**Kuvendimet për vendimin mbi apelet**

- (1) Pas parashtrimit të fundit nga palët, paneli i Gjykatës së Apelit mblidhet për të kuvenduar *in camera*.
- (2) Paneli i Gjykatës së Apelit nxjerr aktgjykimin e apelit mbi bazën e dokumentacionit të apelit, së bashku me çdo provë shtesë të pranuar sipas rregullës 181.
- (3) ¹Paneli i Gjykatës së Apelit mund t'i lërë në fuqi, prapësojë, ose ndryshojë aktgjykimet e trupit gjykues. ²Në rrethana të përshtatshme, paneli i Gjykatës së Apelit mund të urdhërojë që personi i shpallur i pafajshëm ose fajtor, të rigjykohet nga trupi gjykues sipas nenit 46(4) të Ligjit.
- (4) ¹Nëse kërkesa për apel bëhet vetëm nga personi i shpallur fajtor, aktgjykimi nuk mund të rrëzohet ose ndryshohet në dëm të atij personi të shpallur fajtor. ²E njëjta vlen edhe në rast rigjykimi sipas paragrafit (3).

Rregulla 183**Shqiptimi i aktgjykimit të apelit**

- (1) ¹Aktgjykimi i apelit shqiptohet brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh nga parashtrimi i fundit prej palëve. ²Nëse rrethanat e çështjes kërkojnë kohë shtesë, kjo nuk do jetë më shumë se tridhjetë (30) ditë, përveç nëse zgjatja e mëtejshme e afatit është absolutisht e domosdoshme.

³Vendimi për zgjatjen e afatit bëhet publik dhe u njoftohet palëve. ⁴Për zgjatjen e afatit jepen arsye.

- (2) Aktgjykimi i apelit, ose një përmbledhje e tij, shqiptohet publikisht në emër të popullit të Kosovës, në një datë që iu njoftohet palëve dhe ku palët kanë të drejtë të jenë të pranishme.
- (3) ¹Aktgjykimi i apelit shoqërohet nga arsyetimi me shkrim. ²Në rast vendimi pafajësie, aktgjykimi i apelit mund të shqiptohet me gojë, pasuar nga arsyetimi me shkrim sa më shpejt që të jetë e mundshme.
- (4) ¹Një kopje e aktgjykit të apelit dhe e mendimeve të gjykatësve në rast se ka, i jepet të akuzuarit sa më shpejt që të jetë e mundshme në një gjuhë që i akuzuari kupton dhe flet. ²Kopje të tilla i jepen Mbrojtjes në atë gjuhë, si dhe në gjuhën që është shqiptuar aktgjykimi.
- (5) ¹Nëse çështja i kthehet trupit gjykues për rishikimin e përfundimeve dhe provave mbi bazën e standardit të duhur ligjor në pajtim me nenin 46(4) të Ligjit, paneli i Gjykatës së Apelit identifikon përfundimet që kthehen për rishikim. ²Trupi gjykues shqyrton vetëm përfundime dhe prova që lidhen përpikmërisht vetëm me përfundimet e kthyer për rishikim.

Rregulla 184

Procedura e përcaktimit të dënimit

Nëse paneli i Gjykatës së Apelit rrëzon vendimin e pafajësisë dhe jep vendim fajësie, procedura e dënimit e paraparë në rregullën 162 deri në rregullën 164 zbatohet *mutatis mutandis*, nëse gjykohet e përshtatshme.

Rregulla 185

Statusi i personave të shpallur të pafajshëm, ose fajtorë pas aktgjykit të apelit

- (1) Vendimi i fajësisë ose dënimi i shqiptuar nga paneli i Gjykatës së Apelit hyn në fuqi menjëherë.
- (2) Nëse për çfarëdo arsye personi i shpallur i pafajshëm ose fajtor nuk është i pranishëm në shqiptimin e aktgjykit të apelit, gjithsesi paneli i Gjykatës së Apelit mund ta shqiptojë aktgjykimin në mungesë të personit dhe, nëse konfirmon ose shqipton një dënim me burgim ende të pavuajtur, lëshon fletarrestim dhe urdhër për paraburgimin e personit të shpallur fajtor.
- (3) ¹Nëse personi i paraburgosur shpallet i pafajshëm në apel, ai lirohet menjëherë, përveç nëse në ngarkim të këtij personi ka akuza të tjera. ²Lirimi kryhet në përputhje me nenin 41(11) të Ligjit.

Pjesa II: Procedura e apelit të shkallës së tretë

Rregulla 186

Dispozitë e përgjithshme

- (1) Personi i shpallur fajtor mund ta apelojë aktgjykimin e panelit të Gjykatës së Apelit brenda kufijve të paraparë në nenin 47(1) të Ligjit.

- (2) Sipas nenit 33(1)(d) të ligjit, Kryetari cakton një panel të Gjykatës Supreme sapo dorëzohet njoftimi për apel kundër aktgjykimit të panelit të Gjykatës së Apelit, ose si të jetë e nevojshme.
- (3) Rregulla 173(3) deri në rregullën 185 zbatohen *mutatis mutandis* për procedurën e apelit përpara panelit të Gjykatës Supreme.

Kapitulli 11

Mjetet juridike të jashtëzakonshme

Pjesa I: Rihapja e procedurës penale

Rregulla 187

Kërkesa për rihapjen e procedurës

- (1) ¹Një palë mund të bëjë kërkesë për rihapjen e procedurës penale që është mbyllur me një aktgjykim të formës së prerë në përputhje me nenin 48 të Ligjit. ²Çdo kërkesë për këtë qëllim i dorëzohet Kryetarit, ose një paneli *ad hoc* të caktuar nga një Mekanizëm i Mbetur, nëse një i tillë është krijuar në bazë të nenit 60 të Ligjit.
- (2) Sipas nenit 33(1)(d) të Ligjit, pas dorëzimit të një kërkesë të tillë, Kryetari cakton një panel të Gjykatës Supreme.
- (3) ¹Pala kundërshtarë mund të dorëzojë një përgjigje brenda tridhjetë (30) ditësh nga dorëzimi i kërkesës. Pala që kërkon rihapjen e procedurës mund të dorëzojë një kundërpërgjigje brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga përgjigja. ²Nëse është e zbatueshme, paneli i Gjykatës Supreme mund të kërkojë mendimin e Mbrojtësit të Viktimave.

Rregulla 188

Shqyrtimi paraprak i kërkesës për rihapjen e procedurës

¹Në bazë të nenit 48(4) të Ligjit, paneli i Gjykatës Supreme bën shqyrtim paraprak për të verifikuar që kërkesa nuk është qëllimkeqe ose keqpërdorim i procesit, për të përcaktuar nëse kërkesa është dorëzuar nga një person që gëzon të drejtë ligjore për këtë dhe nëse faktet dhe provat e paraqitura në mbështetje të kërkesës nuk janë shqyrtuar tashmë në procedura të mëparshme para Dhomave të Specializuara. ²Kërkesa e dorëzuar nga një person që nuk gëzon të drejtë ligjore për këtë, ose që mbështetet në fakte dhe prova të shqyrtuara më parë, është e papranueshme.

Rregulla 189

Vendim mbi kërkesën për rihapjen e procedurës

Paneli i Gjykatës Supreme mund të urdhërojë rihapjen e procedurës vetëm në pajtim me nenin 48(4)(b) të Ligjit, nëse plotësohen kushtet e parapara në nenin 48(2-3) të Ligjit.

Rregulla 190

Apelimi i aktgjykimit pas rihapjes së procedurës

Kur paneli i Gjykatës Supreme vendos të mbledhë një trup gjykues për rihapjen e procedurës sipas nenit 48(4) të Ligjit, aktgjykimi i shqiptuar nga ai trup gjykues mund të apelohe në përputhje me Kapitullin 10, Pjesa I, Nën pjesa 2.

Pjesa II: Zbutja e jashtëzakonshme e dënimit**Rregulla 191****Kërkesa për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit**

- (1) ¹Një palë mund të kërkojë zbutje të jashtëzakonshme të dënimit në pajtim me nenin 48(5) të Ligjit. ²Çdo kërkesë për këtë qëllim i dorëzohet Kryetarit ose një paneli *ad hoc* të caktuar nga Mekanizmi i Mbetur, nëse është krijuar një i tillë, sipas nenit 60 të Ligjit.
- (2) Pas dorëzimit të një kërkesë të tillë, Kryetari cakton një panel të Gjykatës Supreme në përputhje me nenin 33(1)(d) të Ligjit.
- (3) Nëse e gjykon të nevojshme për marrjen e vendimit mbi kërkesën, paneli i Gjykatës Supreme mund të dëgjojë parashtrimet e Prokurorit të Specializuar dhe të Mbrojtësit të Viktimave.
- (4) Një kërkesë e tillë miratohet nëse, pasi aktgjykimi ka marrë formë të prerë, janë krijuar rrethana lidhur me çështjen që nuk ekzistonin në kohën e shqiptimit të aktgjykimit, ose, ndonëse këto rrethana ekzistonin në atë kohë, ato ishin të panjohura dhe do të kishin çuar në një dënim më të lehtë.
- (5) Kërkesa për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit nuk pezullon zbatimin e dënimit.

Rregulla 192**Aktgjykim në lidhje me kërkesën për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit**

Nëse miraton kërkesën për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit, paneli i Gjykatës Supreme modifikon dënimin e personit të shpallur fajtor.

Pjesa III: Mbrojtja e ligjshmërisë**Rregulla 193****Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë**

- (1) ¹Një palë mund të kërkojë mbrojtjen e ligjshmërisë vetëm në përputhje me nenin 48(6-8) të Ligjit. ²Çdo kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë i dorëzohet Kryetarit, ose një paneli *ad hoc* të caktuar nga Mekanizmi i Mbetur, në qoftë se ka një të tillë, sipas nenit 60 të Ligjit, brenda nëntëdhjetë (90) ditësh nga aktvendimi ose aktgjykimi i formës së prerë kundrejt të cilit kërkohet mbrojtje e ligjshmërisë.
- (2) Sipas nenit 33(1)(d) të Ligjit, pas dorëzimit të një kërkesë të tillë Kryetari cakton një panel të Gjykatës Supreme.
- (3) ¹Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë plotëson kushtet e nenit 48(7) të Ligjit dhe nuk mund të paraqitet mbi bazën e një përcaktimi të gabuar ose të paplotë lidhur me faktet e çështjes. ²Paneli i Gjykatës Supreme trajton vetëm shkeljet e ligjit të pretenduara në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë.

Rregulla 194**Vendimi mbi kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë**

- (1) Nëse paneli i Gjykatës Supreme miraton kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, në varësi të llojit të shkeljes, paneli:
 - (a) modifikon aktvendimin ose aktgjykimin e kontestuar;
 - (b) anulon tërësisht ose pjesërisht aktvendimin ose aktgjykimin e kontestuar dhe ia kthen çështjen për vendim të ri ose rigjykim panelit kompetent; ose
 - (c) kufizohet vetëm në konfirmimin e ekzistencës së një shkeljeje ligjore.
- (2) Nëse arrin në përfundimin se kërkesa e dorëzuar për mbrojtjen e ligjshmërisë që është në dëm të të akuzuarit, është e themeltë, paneli i Gjykatës Supreme konstaton vetëm që ligji është shkelur, por nuk ndërhyr në aktvendimin apo aktgjykimin e kontestuar.

Kapitulli 12

Ulja e dënimit

Rregulla 195

Njoftimi nga shtetet

Sipas nenit 51(2) të Ligjit, Dhomat e Specializuara, ose Mekanizmi i Mbetur nëse ekziston, kërkojnë njoftim nga shteti ku bëhet vuajtja e burgimit nëse sipas ligjit në fuqi të atij shteti, personi i dënuar i plotëson kushtet për uljen e dënimit.

Rregulla 196

Kriteret e përgjithshme për uljen e dënimit

- (1) Kryetari ka të drejtë të japë ulje të dënimit dhe merr vendim për çështjen pasi të ketë dëgjuar personin që vuan dënimin me burgim dhe pas këshillimit me gjykatësit.
- (2) ¹Pasi personi i burgosur të ketë vuajtur dy të tretat (2/3) e dënimit, ose 25 vjet në rastin e burgimit të përjetshëm, Kryetari e rishikon dënimin për të vendosur nëse duhet të ulet. ²Ky rishikim nuk bëhet para afateve të lartpërmendura.
- (3) Në këtë rishikim, Kryetari merr në shqyrtim:
 - (a) nëse sjellja e personit të burgosur gjatë kohës së burgimit tregon një shpirt të vërtetë nga vepra penale që ka kryer;
 - (b) nëse personi i burgosur ka treguar shenja rehabilitimi;
 - (c) gjasat e rishoqëzimit dhe riintegrit të suksesshëm të personit të burgosur;
 - (d) peshën e veprës penale ose të veprave penale për të cilat është shpallur fajtor personi i dënuar;
 - (e) trajtimin e të burgosurve të tjerë në rrethana të ngjashme;
 - (f) nëse lirimi i personit të burgosur do të shkaktoje pastabilitet shoqëror të konsiderueshëm;
 - (g) çdo bashkëpunim thelbësor të personit të burgosur me Prokurorin e Specializuar;
 - (h) ndihmën e dhënë vullnetarisht nga personi i burgosur për të mundësuar zbatimin e aktgjykimeve dhe urdhrave të Dhomave të Specializuara për çështje të tjera dhe veçanërisht dhënien e ndihmës për gjetjen e pasurive objekt i urdhrave për pagim gjobe, konfiskim ose zhdëmtim dhe që mund të përdoren në të mirë të viktimave;
 - (i) çfarëdo veprimi të rëndësishëm të ndërmarrë nga i burgosuri në të mirë të viktimave, si dhe çfarëdo pasoje për viktimat dhe familjet e tyre si rezultat i uljes së dënimit;
 - (j) rrethanat personale të personit të burgosur, ndër të cilat përkeqësimi i gjendjes fizike ose mendore apo mosha e thyer; ose

- (k) faktorë të tjerë që vërtetojnë një ndryshim të qartë dhe të konsiderueshëm të rrethanave, të mjaftueshme për të përligjur uljen e dënimit.
- (4) Kryetari mund të vendosë kushte për uljen e dënimit që i gjykon të përshtatshme, në përputhje me Udhëzimin Praktik për Ulje të Dënimit të lëshuar nga Kryetari.
- (5) ¹Në qoftë se pas rishikimit sipas paragrafit (3), Kryetari vendos se nuk është e përshtatshme të ulet dënimi, ai e rishikon çështjen e uljes së dënimit çdo tre (3) vjet, përveç nëse ka përcaktuar një interval më të shkurtër në vendimin e arsyetuar të dhënë sipas paragrafit (3). ²Në rast të një ndryshimi të konsiderueshëm të rrethanave, Kryetari mund t'i lejojë personit të burgosur të bëjë kërkesë për rishikim brenda periudhës trevjeçare, ose brenda një periudhe më të shkurtër të caktuar nga Kryetari.

Rregulla 197

Procedura e uljes së dënimit

- (1) ¹Për zbatimin e rregullës 196(3) dhe për çdo rishikim sipas rregullës 196(5), Kryetari mund të mbajë një seancë dëgjimore. ²Kryetari dëgjon personin e burgosur dhe Mbrojtësin e tij të Specializuar, Prokurorin e Specializuar, shtetin ku i burgosuri vuan dënimin, dhe, kur është e zbatueshme, Mbrojtësin e Viktimave. ³Seanca mund të kryhet me anë të videokonferencës ose, në rrethana të veçanta dhe në varësi të Rregullores, në shtetin ku i burgosuri vuan dënimin, nga një gjykatës i autorizuar nga Kryetari.
- (2) Kryetari u komunikon vendimin e arsyetuar sipas paragrafit (1) të gjithë pjesëmarrësve në procedurë sa më shpejt që të jetë e mundshme.

Kapitulli 13

Parësia, bashkëpunimi dhe ndihma gjyqësore

Pjesa I: Dispozita të përgjithshme të bashkëpunimit

Rregulla 198

Dërgimi dhe marrja e komunikimeve lidhur me bashkëpunimin dhe ndihmën gjyqësore

- (1) ¹Administratori dërgon të gjitha komunikimet dalëse, përfshirë urdhrat, fletarrestimet, fletëthirrjet dhe kërkesat për ndihmë dhe bashkëpunim të lëshuara nga Dhomat e Specializuara.
²Administratori merr të gjitha komunikimet hyrëse, përfshirë përgjigjet, dokumentet dhe informacionet e tjera nga autoritetet e Kosovës dhe shtetet e treta për Dhomat e Specializuara.
- (2) Zyra e Prokurorit të Specializuar dërgon të gjitha komunikimet dalëse, përfshirë urdhrat, fletëthirrjet dhe kërkesat për ndihmë dhe bashkëpunim të lëshuara nga Zyra e Prokurorit të Specializuar dhe merr të gjitha komunikimet hyrëse, përfshirë përgjigjet, dokumentet dhe informacione të tjera nga autoritetet e Kosovës dhe shtetet e treta për Zyrën e Prokurorit të Specializuar.
- (3) Çdo kërkesë nga autoritetet e Kosovës drejtuar Zyrës së Prokurorit të Specializuar ose Kryetarit, sipas nenit 54(9) të Ligjit, i dërgohet Administratorit i cili ia kalon kërkesën ose Zyrës së Prokurorit të Specializuar, ose Kryetarit, ose të dyve, sipas rrethanave.
- (4) Kjo rregull zbatohet *mutatis mutandis* për kërkesat që bëhen nga organizata ndërkombëtare, apo ndonjë subjekt apo person tjetër, ose që u drejtohen atyre.

Rregulla 199

Kërkesa për dëshminë e një personi në paraburgim të Dhomave të Specializuara

- (1) Një gjykatës ose gjykatë në Kosovë, ose në një shtet të tretë, ose palët e një procedure penale në Kosovë ose në një shtet të tretë të autorizuar nga një autoritet gjyqësor përkatës ('Kërkuesi'), mund të kërkojnë ndihmën e Dhomave të Specializuara për marrjen e dëshmisë së një personi në paraburgim të Dhomave të Specializuara ('personi i paraburgosur'), në funksion të një hetimi ose ndjekjeje penale në kryerje e sipër brenda juridiksionit të Kërkuesit.
- (2) Kërkesa të tilla i dorëzohen Kryetarit i cili ia referon kërkesën një gjykatësi të vetëm.
- (3) Pasi të ketë dëgjuar Prokurorin e Specializuar dhe Mbrojtësin e Specializuar të personit të paraburgosur, gjykatësi i vetëm mund ta miratojë kërkesën pasi të ketë verifikuar që:
 - (a) miratimi i kërkesës nuk dëmton të drejtat e personit të paraburgosur;
 - (b) miratimi i kërkesës nuk mund të dëmtojë hetimet ekzistuese të Prokurorit të Specializuar ose procedurat ekzistuese të Dhomave të Specializuara;
 - (c) ekzistojnë dispozita dhe garanci që sigurojnë respektimin e çdo mase mbrojtëse të miratuar nga Dhomat e Specializuara;
 - (d) miratimi i kërkesës nuk përbën rrezik për asnjë viktimë, dëshmitar, ose person tjetër; dhe

- (e) nuk ekzistojnë arsye madhore kundër miratimit të kërkesës.
- (4) ¹Ndihma jepet nëpërmjet videokonferencës. ²Me dhënien e urdhrit nga gjykatësi i vetëm, Administratori bashkërendon përgatitjet për organizimin e videokonferencës dhe është i pranishëm gjatë seancës.
- (5) Në qoftë se në juridiksionin e Kërkuesit ekzistojnë dispozita ligjore që nuk lejojnë marrjen e dëshmisë nëpërmjet videokonferencës, gjykatësi i vetëm mund të miratojë që Kërkuesi të ketë qasje tek personi për t'u marrë në pyetje në mjediset e Dhomave të Specializuara.
- (6) Në secilin rast, gjykatësi i vetëm është i pranishëm gjatë seancës dhe siguron respektimin e pikave (a-e) të paragrafit (3).
- (7) Marrja në pyetje e personit të paraburgosur kryhet drejtpërsëdrejti nga Kërkuesi, ose sipas udhëzimeve të Kërkuesit, në përputhje me ligjet e juridiksionit të Kërkuesit, në qoftë se ato ligje nuk bien ndesh me Kushtetutën ose me Ligjin.
- (8) Vendimet e marra sipas kësaj rregulle nuk i nënshtrohen rishikimit gjyqësor.

Pjesa II: Bashkëpunimi dhe ndihma gjyqësore me Kosovën

Rregulla 200

Dispozita të përgjithshme

Vendimet, urdhrat apo kërkesat nga çdo organ i Dhomave të Specializuara drejtuar çdo subjekti apo personi në Kosovë zbatohen në pajtim me nenin 53 të Ligjit.

Rregulla 201

Kërkesa për urdhër për informacion, bashkëpunim dhe ndihmë

- (1) Prokurori i Specializuar mund t'i bëjë kërkesë një paneli për lëshimin e një urdhri drejtuar cilitdo autoriteti në Kosovë për informacion, bashkëpunim, ose ndihmë, përfshirë edhe për kontrollime dhe sekuestrime, veçanërisht në rast mospërbushjeje të urdhrit apo në raste urgjente.
- (2) Edhe Mbrojtësi i Specializuar, ose Mbrojtësi i Viktimave mund t'i paraqesë kërkesë një paneli për një urdhër drejtuar cilitdo autoriteti të Kosovës për informacion, bashkëpunim ose ndihmë, në qoftë se mund të provojë se:
- (a) kërkesa e bërë nga Mbrojtësi i Specializuar, apo Mbrojtësi i Viktimave është refuzuar apo shpërfillur; dhe
- (b) informacioni, bashkëpunimi ose ndihma është thelbësore për argumentet e tyre.

Rregulla 202**Urdhri për informacion, bashkëpunim dhe ndihmë**

- (1) Me kërkesën e Prokurorit të Specializuar, Mbrojtësit të Specializuar, Mbrojtësit të Viktimave, ose *proprio motu*, një panel mund të lëshojë një urdhër drejtuar cilitdo autoriteti në Kosovë lidhur me çdo formë të ndihmës së parashikuar në nenin 53(1) të Ligjit.
- (2) Paneli mund të përcaktojë çfarëdo kushtesh që i gjykon të nevojshme, ndër të cilat edhe kushtet për konfidencialitetin dhe masat mbrojtëse.
- (3) Çdo urdhër i tillë respektohet pa vonesë të papërligjur, në pajtim me nenin 53(1) të Ligjit.
- (4) ¹Ky urdhër nuk është i apelueshëm para gjykatave të tjera të Kosovës dhe zbatimi i tij nuk mund të kushtëzohet nga miratimi i cilitdo autoriteti tjetër gjyqësor në Kosovë. ²Çdo urdhër i tillë është detyrues dhe nuk i nënshtrohet asnjë kushti që nuk është përcaktuar shprehimisht në urdhër.

Rregulla 203**Urdhri për transferimin e çështjeve gjyqësore nga gjykata të tjera të Kosovës**

- (1) Pas dorëzimit të kërkesës për transferimin e një çështjeje gjyqësore tek Dhomat e Specializuara, Kryetari cakton një gjykatës të vetëm për marrjen e vendimit mbi kërkesën në përputhje me nenin 10 të Ligjit.
- (2) Nëse gjykatësi i vetëm çmon se transferimi i çështjes gjyqësore është i përshtatshëm, ai lëshon urdhër për gjykatën, prokurorinë ose subjektin hetimor përkatës që ta transferojnë çështjen te Dhomat e Specializuara.
- (3) ¹Urdhri për transferim mund të përfshijë një kërkesë që çfarëdo dosje dhe të gjitha dosjet, përfshirë rezultatet e hetimit dhe dokumentacionin e gjykatës, si dhe një kopje e legalizuar e aktgjykimit nëse është shpallur, t'i dërgohen Prokurorit të Specializuar. ²Procedurat që janë objekt i urdhrorit të transferimit të çështjes gjyqësore pezullohen deri në marrjen e vendimit nga gjykatësi i vetëm.
- (4) Nëse autoriteteve të Kosovës u dorëzohet urdhri për transferimin e çështjes gjyqësore, ato e zbatojnë urdhrin në pajtim me nenin 53 të Ligjit, pa vonesë të papërligjur dhe në përputhje me afatet kohore dhe kushtet, përfshirë konfidencialitetin dhe masat mbrojtëse, të përcaktuara në urdhër.

Rregulla 204**Mospërmbushja e urdhrorit për informacion, bashkëpunim dhe ndihmë, ose për transferim të një çështjeje gjyqësore**

- (1) ¹Në qoftë se pas tridhjetë (30) ditësh nga dhënia e një urdhri sipas rregullës 202 ose rregullës 203, autoriteti kompetent i Kosovës nuk e ka përmbushur urdhrin, ose nuk ka provuar se janë ndërmarrë, ose po ndërmerren hapat e duhur për përmbushjen e urdhrorit, paneli mund të bëjë një konstatim gjyqësor për mosbashkëpunim. ²Në lidhje me këtë, paneli informon Kryetarin për ndërmarrjen e veprimeve të mëtejshme.

- (2) ¹Kryetari mund të këshillohet me autoritetet e Kosovës me qëllim sigurimin e përmbushjes së urdhrit. ²Nëse pavarësisht nga kjo, veprimi i kërkuar nuk kryhet ose shpërfillet, Kryetari mund të ndërmarrë çdo veprim që e gjykon të përshtatshëm.

Rregulla 205***Non Bis In Idem***

Nëse Kryetari apo një panel marrin informacion të besueshëm se është filluar procedim penal kundër një personi para një gjykate në Kosovë për një sjellje në lidhje me të cilën ky person është shpallur i pafajshëm ose fajtor nga Dhomat e Specializuara, bazuar në nenin 17 të Ligjit, Kryetari ose paneli e shqyrton çështjen dhe, nëse është e përshtatshme, jep një vendim të arsyetuar që procedura e filluar të ndërpritet përgjithmonë.

Rregulla 206**Kërkesat nga autoritetet e Kosovës për ndihmë dhe bashkëpunim**

- (1) Kërkesat e bëra nga autoritetet e Kosovës sipas nenit 54(9) të Ligjit mund të miratohen në varësi të masave mbrojtëse apo të çfarëdo kushti tjetër të nevojshëm për mbrojtjen e dëshmitarëve, viktimave pjesëmarrëse në procedura, apo personave të tjerë të rrezikuar për shkak të dëshmitarëve të dhëna nga dëshmitarët, ose në interes të drejtësisë.
- (2) Kërkesa mund të refuzohet me arsyetimin se miratimi i saj mund të dëmtojë hetimet në kryerje e sipër nga Prokurori i Specializuar ose procedurat para Dhomave të Specializuara, ose mund të përbëjë kërcënim për sigurinë dhe mbrojtjen e një personi, ose logjikisht mund të parashihet se dëmton në mënyra të tjera pjesëmarrësit, Dhomat e Specializuara, ose interesat e drejtësisë.

Rregulla 207**Efekti jodetyrues i vendimeve të gjykatave të tjera**

Urdhrat ose vendimet e gjykatave të tjera të Kosovës nuk janë detyruese për Dhomat e Specializuara ose Prokurorin e Specializuar, në përputhje me nenin 10(1) të Ligjit.

Pjesa III: Bashkëpunimi ndërkombëtar**Rregulla 208****Marrëveshje me shtete të treta, organizata ndërkombëtare dhe subjekte të tjera**

- (1) Dhomat e Specializuara, përmes Administratorit, mund të ftojnë një shtet të tretë, organizatë ndërkombëtare ose çfarëdo subjekti tjetër për të dhënë ndihmë:
- (a) mbi bazën e një marrëveshjeje të arritur sipas neneve 4(2) dhe 55(1) të Ligjit; ose

- (b) mbi çfarëdo baze tjetër të përshtatshme, përfshirë marrëveshjet për ndihmë juridike reciproke në të cilat është palë Kosova, ose kërkesat për ndihmë të mbështetura në parimin e reciprocitetit, siç parashihet në nenin 55(2) të Ligjit.
- (2) Mbrojtja dhe Mbrojtësi i Viktimave mund t'i bëjnë trupit gjykues kërkesë për ndihmë dhe bashkëpunim nga një shtet i tretë, organizatë ndërkombëtare, ose çdo subjekt tjetër.
- (3) Nëse hetimet ose procedurat penale nën juridiksionin e Dhomave të Specializuara të kryera në një shtet të tretë, mund të ndikojnë negativisht në punën e Prokurorit të Specializuar, ose në procedurat para Dhomave të Specializuara, në bazë të paragrafit (1), paneli mund ta ftojë shtetin e tretë t'i transferojë këto hetime ose procedura në juridiksionin e Dhomave të Specializuara.

Rregulla 209

Mosrespektimi i marrëveshjeve

- (1) Në qoftë se një shtet i tretë, organizatë ndërkombëtare, ose çdo subjekt tjetër që ka detyrimin të bashkëpunojë me Dhomat e Specializuara ose me Zyrën e Prokurorit të Specializuar sipas një marrëveshjeje në bazë të nenit 4 të Ligjit, nuk i përgjigjet një kërkesë për ndihmë dhe bashkëpunim, ose nuk e respekton atë, zbatohet mekanizmi për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve i paraparë në atë marrëveshje.
- (2) Nëse Dhomat e Specializuara ose Zyra e Prokurorit të Specializuar kërkojnë ndihmën e një shteti të tretë në bazë të një marrëveshjeje për ndihmë juridike reciproke ndërmjet atij shteti dhe Kosovës sipas nenit 55(2) të Ligjit, zbatohet mekanizmi për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve i paraparë në atë marrëveshje.
- (3) Kur një shtet i tretë, organizatë ndërkombëtare apo ndonjë subjekt tjetër që nuk ka detyrim të bashkëpunojë, nuk i përgjigjet kërkesës për ndihmë dhe bashkëpunim, ose e refuzon kërkesën, Kryetari, Prokurori i Specializuar ose Administratori, sipas rrethanave të përshtatshme, mund të këshillohet me autoritetet kompetente me qëllim sigurimin e bashkëpunimit të kërkuar.

Rregulla 210

Kërkesa për ndihmë e shteteve të treta, organizatave ndërkombëtare dhe subjekteve të tjera

- (1) Një shtet i tretë, organizatë ndërkombëtare ose çdo subjekt tjetër, mund t'i parashtojë Dhomave të Specializuara kërkesë për ndihmë dhe bashkëpunim.
- (2) Përveç nëse është rënë dakord ndryshe përmes një marrëveshjeje për bashkëpunim dhe ndihmë sipas nenit 4 të Ligjit, çdo kërkesë e tillë për Dhomat e Specializuara bëhet në një prej gjuhëve zyrtare të Dhomave të Specializuara, ose shoqërohet me përkthimin në një prej këtyre gjuhëve.
- (3) Rregulla 206 zbatohet *mutatis mutandis*.

Rregulla 211**Kërkesa për mbrojtjen e përfaqësuesve dhe informacionit**

- (1) Shtetet e treta ose organizatat ndërkombëtare mund të ndërmarrin të gjithë hapat e arsyeshëm, duke vepruar në bashkëpunim me Zyrën e Prokurorit të Specializuar, Mbrojtjen, ose Mbrojtësin e Viktimave, sipas rastit, për të siguruar mbrojtjen e punonjësve, përfaqësuesve dhe informacionit konfidencial ose të ndjeshëm të tyre.
- (2) Në qoftë se, në çfarëdo faze të procedurës, një shtet i tretë ose organizatë ndërkombëtare mëson se, me gjithë masat e marra sipas paragrafit (1), po nxirret, ose ka gjasa të nxirret informacion i përcaktuar në nenin 58 të Ligjit, shteti ose organizata në fjalë mund t'i bëjë kërkesë Kryetarit për zgjidhjen e çështjes, i cili ia kalon kërkesën panelit kompetent.
- (3) Paneli mund të ofrojë masa mbrojtëse të barasvlershme me ato të parashikuara në rregullën 80(4)(a)(i) dhe (ii) ose, ku është e përshtatshme, të zbatojë rregullën 107 *mutatis mutandis*.